REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I PUNËS DHE POLITIKAVE SOCIALE

DISERTACION

TEMA: "VLERËSIMI I CILËSISË SË JETËS TE PERSONAT QË JETOJNË ME HIV/AIDS NË SHQIPËRI"

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore "Doktor"
nga Besjana Xhani

Udhëhequr nga Prof. Dr. Edmond Dragoti

TIRANË, 2015

DEKLARATË STATUORE

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar ndonjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

© 2015 Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI I PUNËS DHE POLITIKAVE SOCIALE
Bulevardi " Gjergj Fishta'',
tel +3554223036, email :fshf.it@unitir.edu.al

PROGRAM I DOKTORATËS

Tema: VLERËSIMI I CILËSISË SË JETËS TE PERSONAT QË JETOJNË ME HIV/AIDS NË SHQIPËRI

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore "Doktor"

nga Besjana Xhani

Udhëhequr nga Prof. Dr. Edmond Dragoti

MIRATOHET MË DATË…./….2015 PARA JURISË

Juria e vlerësimit:

1._____Kryetar /e jurie

2._____Anëtar /e (oponent/e)

3._____Anëtar /e (oponent/e)

4._____Anëtar/e

5._____Anëtar/e

TIRANË, 2015

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është për të vlerësuar cilësinë e jetës së personave që jetojnë me HIV dhe AIDS (PJHA) në Shqipëri. Asnjë studim mbi cilësinë e jetës së PJHA-së në Shqipëri nuk është realizuar deri më tani. Ky studim është i natyrës *cross–sectional*, përshkrues dhe instrumenti WHOQOL-HIV-BREF u përdor për vlerësimin e cilësisë së jetës të PJHA-së. Në këtë studim morën pjesë 199 persona që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri dhe përzgjedhja e tyre ishte rastësore. Studimi u realizua në Klinikën Ambulatore HIV/AIDS, Spitali Sëmundjeve Infektive, QSUT-të, e vetmja qendër spitalore që ofron shërbim të specializuar mjekësor dhe psiko-social. Instrumenti i përdorur është hartuar nga OBSH-ja dhe përdorimi i tij në popullatën HIV shqiptare tregoi një konsistencë dhe besueshmëri të lartë, Crombah alfa ishte në vlerën 0.83. Vlerësimi i cilësisë së jetës së PJHA-së u arrit duke vlerësuar 6 domene të përcaktuara nga OBSh-ja: fizik, social, psikologjik, autonomisë, mjedisit dhe besimet personale/shpirtërore/fetare. Rezultatet treguan se cilësia e jetës së PJHA-së në Shqipëri është mbi mestaren sipas udhëzimeve të OBSH-së dhe se domeni mjedisit ka vlerën më të ulët (11.3) dhe domeni besimeve personale/shpirtërore/fetare ka vlerën më të lartë (15.9) krahasuar me domenet e tjerë. Si përfundim, mund të themi se PJHA-të kanë një cilësi jete mbi mesataren, por të ulët krahasuar me vendet e Bashkimit Europian. Nuk ka ndryshime në cilësinë e jetës midis dy gjinive dhe subjekteve nën terapi ose jo.

Fjalë Kyçe: Cilësia e Jetës, HIV/AIDS, Shqipëri, Domene, WHOQOL-HIV-BREF.

FUSHA E STUDIMIT: SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

FJALË KYÇE: CILËSIA E JETËS, HIV/AIDS, DOMENE, PUNË SOCIALE, WHOQOL-BREF-SHQIPTARË

ABSTRACT

The purpose of this study is to assess the quality of life in people living with HIV and AIDS in Albania. Until now no study on QOL in PLWHA has been done before. This is a cross -sectional and descriptive study. The WHOQOL-HIV-BREF instrument was used for the assessment of QOL of PLHA for the first time in Albania. Data was collected from 199 people living with HIV / AIDS in Albania, their selection was random. The study was conducted at the Outpatient Clinic, Infectious Diseases Hospital, University Hospital Center in Tirana, the only hospital that offers specialized medical and psychosocial care. The instrument used was developed by WHO and its use in HIV Albanian population showed a high consistence and reliability, Crombah alpha value was 0.83. Assessment of quality of life on PLWHA was achieved by assessing 6 domains defined by the WHO; physical, social, psychological, autonomy, environmental and personal beliefs / spiritual / religious. The results showed that the quality of life of PLWHA in Albania is above the average value according to the WHO guidelines, the environmental domain has the lowest value (11.3) and personal beliefs / spiritual / religious has the highest value (15.9) compared to the other domains. In conclusion we can say that PLWHA have a quality of life above average but still low compared to the European Union countries. There are no differences in the QOL between the two genders and the subjects that are or are not on therapy.

Key Words: Quality of Life, HIV / AIDS, Albania, Domains, WHOQOL-HIV-BREF-Albanian

FIELD OF STUDY: HEALTH AND SOCIAL WELFARE

KEYWORDS: QUALITY OF LIFE, HIV / AIDS, DOMAINS, SOCIAL WORK, WHOQOL-HIV-BREF ALBANIAN

TABELA E PËRMBAJTJES

VLERËSIMI I CILËSISË SË JETËS TE PERSONAT QË JETOJNË ME HIV/AIDS NË SHQIPËRI
Abstrakt v

Abstract vi

MIRËNJOHJE xiii

LISTA E SHKURTIMEVE/SHKURTESA xvi

KAPITULLI 1 ORIENTIM MBI STUDIMIN 1
1.1 HYRJE 1
1.2 NGRITJA E PROBLEMIT 6
1.3 RËNDËSIA E STUDIMIT 7
1.4 KUADRI KONCEPTUAL I STUDIMIT 9
1.4.1 Domeni fizik 11
1.4.2 Domeni psikologjik 11
1.4.3 Domeni autonomisë 12
1.4.4 Domeni marrëdhënieve sociale 12
1.4.5 Domeni mjedisit 12
1.4.6 Domeni besimeve personale, shpirtërore dhe fetare 12
1.4.7 Karakteristikat individuale dhe klinike 13
1.4.8 Përkufizimi i variablave të studimit 13
1.5 PËRMBLEDHJE 14

KAPITULLI 2 RISHIKIMI I LITERATURËS 15
2.1 HYRJE 15
2.2 HIV/AIDS NË SHQIPËRI 16
2.2.1 Kujdesi dhe mbështetja ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS 17
2.2.2 Aktet ligjore 18
2.3 ANALIZA E KONCEPTIT TË CILËSISË SË JETËS 18
2.3.1 Përkufizimi i cilësisë së jetës 19
2.3.2 Mirëqenia 22
2.3.3 Shëndeti – Lidhur me Cilësinë e Jetës (HRQOL) 22
2.3.4 Cilësia e jetës 24
2.3.5 Vlerësimi i cilësisë së jetës 25
2.3.6 Cilësia e jetës dhe HIV/AIDS 26

2.3.7 Metodat e përdorura në studimin e cilësisë së jetës në HIV/AIDS 27
2.3.8 Qasjet teorike dhe konceptuale në kërkimin e cilësisë së jetës 29
2.3.9 Modeli i cilësisë së jetës - Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHOQOL) 29
2.4 MATJA E CILËSISË SË JETËS **32**
2.4.1 Në praktikat mjekësore 32
2.4.2 Promovimin e marrëdhënieve mjek-pacient 32
2.4.3 Në vlerësimin e efektivitetit dhe meritave të trajtimeve të ndryshme 32
2.4.4 Vlerësimin e shërbimeve shëndetësore 33
2.4.5 Kërkim shkencor 33
2.4.6 Politikbërje 33
2.5 LLOJET E INSTRUMENTAVE QË MASIN CILËSINË E JETËS **33**
2.5.1 Hyrje 33
2.5.2 Kërkesat për instrumente QOL në hulumtimet klinike 35
2.6 SHËNDETI–LIDHUR ME CILËSINË E JETËS DHE INFEKSIONIN HIV (HRQOL) **36**
2.7 PËRMBLEDHJE **38**

KAPITULLI 3 METODOLOGJIA E KËRKIMIT **40**
3.1 HYRJE **40**
3.2 DISAJNI I STUDIMIT DHE LITERATURA MBËSHTETËSE **40**
3.3 VENDI I REALIZIMIT TË STUDIMIT **41**
3.4 POPULLSIA DHE KAMPIONIMI **42**
3.4.1 Kriteret e marrjes së kampionëve 42
3.4.2 Koha e realizimit të studimit 43
3.5 PROCESI I PËRKTHIMIT TË INSTRUMENTIT NË STUDIM **43**
3.6 PËRKUFIZIMET E STUDIMIT DHE KONTROLLIT TË VARIABLAVE **43**
3.7 INSTRUMENTI WHOQOL HIV-BREF **47**
3.7.1 Procedurat e grumbullimit të të dhënave 50
3.8 ANALIZA STATISTIKORE **50**
3.9 ÇËSHTJET ETIKE DHE LIGJORE **53**
3.10 KONFIDENCIALITETI DHE ANONIMATI **54**
3.10.1 Integriteti i studiuesit 55
3.11 SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT **56**
3.12 KUFIZIMET E STUDIMIT **56**

KAPITULLI 4 REZULTATE **57**
4.1 PASTRIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE **57**
4.2 KARAKTERISTIKAT EPIDEMIOLOGJIKE TË HIV/AIDS NË SHQIPËRI **57**
4.2.1 Aktiviteti klinik në lidhje me HIV/AIDS 60
4.2. 3 Karakteristikat individuale të kampionimit 62

4.2.4 Paraqitja grafike e karakteristikave të përgjithshme 64
4.2.5 Karakteristikat klinike të të intervistuarve 65
4.3 PARAQITJA GRAFIKE DHE TABELARE E VARIABLAVE SOCIODEMOGRAFIK MIDIS DY GJINIVE NË STUDIM **67**
4.4 REZULTATET E PYETJEVE **86**
4.4.1 Analiza e pyetjeve me përgjigje që kanë tendencë pozitive dhe atyre me tendencë negative. *88*
4.5 REZULTATET E DOMENEVE **90**
4.6 GJETJE TË TJERA **97**
4.6.1 Teknika e Binary Logistic Regression *97*
4.6.2 Analiza e korrespondencës së shumëfishtë *96*

KAPITULLI 5 DISKUTIME **102**
5.1 HYRJE **102**
5.2 STUDIMI I KAMPIONIMIT NË STUDIM **102**
5.2.1 Karakteristikat individuale të kampionimit *103*
5.2.2 Karakteristikat klinike të kampionimit *105*
5.3 INSTRUMENTI WHOQOL-HIV SHQIPTAR **107**
5.4 CILËSIA E JETËS NË POPULLATËN NË STUDIM **108**
5.4.1 Faktori gjini në cilësinë e jetës *109*
5.4.2 Faktorët sociodemografik, klinik dhe ndikimi në cilësinë e jetës *111*
5.4.3 Rezultatet e domeneve në studim *113*
5.4.4 Përshkrimi përgjigjeve të lidhura me WHOQOL-BREF me predominim pozitiv *116*
5.4.5 Përshkrimi përgjigjeve të lidhura me WHOQOL-BREF me predominim negativ *117*
5.4.6 Cilësia e jetës në popullatën e përgjishme në Evropë *117*
5.5 DOMETHËNIA E STUDIMIT **119**
5.6 IMPLIKIMET DHE SUGJERIME PËR KËRKIME NË TË ARDHMEN **121**
5.7 PËRFUNDIME **122**
5.8 REKOMANDIME **123**
5.8.1 Për ofruesit e kujdesit shëndetësor: *123*
5.8.2 Për politikbërësit: *124*
5.8.3 Për punonjësin social: *124*
5.8.4 Për personat që jetojnë me HIV/AIDS *125*

BIBLIOGRAFI **126**

SHTOJCA **157**
1. Forma e miratimit për zhvillimin e kërkimit shkencor në spitalin e sëmundjeve infektive **157**
2. Formulari mbi miratimin e pëlqimit për të marrë pjesë në studim **157**
3. Instrumenti i plotë WHOQOIL-HIV-BREF **158**

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1 Modeli konceptual i përshtatur sipas modelit të WHOQOL-së. 14

Figura 2.2 Calvert Henderson- Indikatorët e Cilësisë së Jetës. 24

Figura 4.5 Indikatorët e cilësisë së jetës sipas EQOL/WHOQOL-HIV-BREF. 118

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1 Vendet fillestare ku u realizua projekti zhvillimor i (WHOQOL) 10

Tabela 2.3 Përkufizimet operacionale dhe konceptuale të variablave 44

Tabela 3.3 Udhëzime për llogaritjen e pikëve të 26 pyetjeve. 49

Tabela 4.3 Ndryshimi në drejtim negativ i pyetjeve të formuluara. 49

Tabela 5.3 Llogaritja e pikëve të domeneve. 49

Tabela 6.4 Shpërndarja e të sëmurëve me HIV/AIDS sipas shtrimeve në QSUT dhe studimit tonë. 58

Tabela 7.4 Shtrimet e të sëmurëve me HIV/AIDS, QSUT, 2005-2013. 60

Tabela 8.4 Karakteristikat individuale të të intervistuarve. 62

Tabela 9.4 Karakteristika klinike të të intervistuarve. 66

Tabela 10.4 Shpërndarja e arsimit sipas gjinisë. 67

Tabela 11.4 Shpërndarja çift brenda studimit sipas gjinisë. 68

Tabela 12.4 Shpërndarja e grup-moshave sipas gjinisë. 69

Tabela 13.4 Statusi i emigracionit sipas gjinisë. 70

Tabela 14.4 Partneri HIV pozitiv sipas gjinisë. 70

Tabela 15.4 Merr TAR sipas gjinisë. 71

Tabela 16.4 Ka ndërprerë TAR-in sipas gjinisë. 72

Tabela 17.4 Ka treguar statusin sipas gjinisë. 73

Tabela 18.4 Gjendja civile sipas gjinisë. 74

Tabela 19.4 Statusi i punësimit sipas gjinisë. 74

Tabela 20.4 Statusi i gjendjes shëndetësore sipas gjinisë. 75

Tabela 21.4 Arsimi sipas etnisë. 76

Tabela 22.4 Çift sipas etnisë. 77
Tabela 23.4 Gjinia sipas etnisë. 77
Tabela 24.4 Grup-mosha sipas etnisë. 78
Tabela 25. Statusi i emigracionit sipas etnisë. 79
Tabela 26.4 Partneri HIV + sipas etnisë. 80
Tabela 27.4 Merr TAR sipas etnisë. 81
Tabela 28.4 Ka ndërprerë TAR-in të paktën një herë sipas etnisë. 81
Tabela 29.4 Ka treguar statusin sipas etnisë. 82
Tabela 30.4 Statusi i punësimi sipas etnisë. 83
Tabela 31.4 Gjendja civile sipas etnisë. 84
Tabela 32.4 Gjendja shëndetësore sipas etnisë. 85
Tabela 33.4 Perceptimi i shëndetit sipas gjinisë. 86
Tabela 34.4 Përmbledhje e përgjigjeve të pyetësorit. 87
Tabela 35.4 Shpërndarja e pyetjeve të WHOQOL-HIV-BREF me predominim pozitiv. 89
Tabela 36.4 Shpërndarja e pyetjeve të WHOQOL-HIV-BREF me predominim negativ. 89
Tabela 37.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve. 90
Tabela 38.4 Inter-Item Correlation Matrix. 91
Tabela 39.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve. 93
Tabela 40.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve sipas gjinisë. 94
Tabela 41.4 Krahasimi i vlerave mesatare të matjeve të cilësisë së jetës sipas karakteristikave demografike dhe klinike (N = 199) 96

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1.4 Shpërndarja e të sëmurëve me HIV/AIDS sipas rretheve në %. 58
Grafiku 2.4 Shpërndarja e të sëmurëve me HIV/AIDS sipas shtrimeve në QSUT dhe studimit tonë. 58
Grafiku 3.4 Shtrimet e të sëmurëve me HIV/AIDS, QSUT, 2005-2013. 60
Grafiku 4.4 Shpërndarja e moshës sipas gjinisë. 61
Grafiku 5.4 Piramida e popullatës së studimit sipas moshës dhe gjinisë. 62
Grafiku 6.4 Shpërndarja sipas gjinisë 64
Grafiku 7.4 Shpërndarja sipas etnisë 64
Grafiku 8.4 Pacientë çift brenda studimit 64
Grafiku 9.4 Statusi emigrimit gjatë jetës 64
Grafiku 10.4 Shpërndarja sipas arsimit 64
Grafiku 11.4 Shteti ku ka emigruar 64
Grafiku 12.4 Shpërndarja sipas gjendjes civile. 65
Grafiku 13.4 Shpërndarja e arsimit sipas gjinisë. 67
Grafiku 14.4 Shpërndarja çift brenda studimit sipas gjinisë. 68
Grafiku 15.4 Shpërndarja e grup-moshave sipas gjinisë. 69
Grafiku 16.4 Statusi i emigracionit sipas gjinisë. 70
Grafiku 17.4 Partneri HIV pozitiv sipas gjinisë. 71
Grafiku 18.4 Merr TAR sipas gjinisë. 71
Grafiku 19.4 Ka ndërprerë TAR-in sipas gjinisë. 72
Grafiku 20.4 Ka treguar statusin sipas gjinisë. 73
Grafiku 21.4 Gjendja civile sipas gjinisë. 74
Grafiku 22.4 Statusi i punësimit sipas gjinisë. 75
Grafiku 23.4 Statusi i gjendjes shëndetësore sipas gjinisë. 75
Grafiku 24. Arsimi sipas etnisë. 76
Grafiku 25.4 Çift sipas etnisë. 77
Grafiku 26.4 Gjinia sipas etnisë. 78
Grafiku 27.4 Grup-mosha sipas etnisë. 79
Grafiku 28.4 Statusi i emigracionit sipas etnisë. 79
Grafiku 29.4 Partneri HIV + sipas etnisë. 80

Grafiku 30.4 Merr TAR sipas etnisë. 81

Grafiku 31.4 Ka ndërprerë TAR-in sipas etnisë. 82

Grafiku 32.4 Ka treguar statusin sipas etnisë. 82

Grafiku 33.4 Statusi i punësimi sipas etnisë. 83

Grafiku 34.4 Gjendja civile sipas etnisë. 84

Grafiku 35.4 Gjendja shëndetësore sipas etnisë. 85

Grafiku 36.4 Vlerat mesatare të përgjigjeve. 88

Grafik 37.4 Paraqitje grafike e lidhjeve korrelative midis domeneve. 92

Grafik 38.4 Paraqitje grafike e parametrave të domeneve. 93

Grafik 39.4 Paraqitje grafike e vlerave mesatare të domeneve sipas gjinisë 94

Grafik 40.4 Paraqitje grafike e vlerave mesatare të domeneve, merr apo jo TAR. 95

Grafik 41.4 Paraqitje e vendosjes së rasteve sipas faktorëve sociodemografik bazuar në analizën e korrespondencës së shumëfishtë. 98

Grafiku 42.4 Paraqitje e vendosjes së faktorëve sociodemografik ndaj njëri-tjetrit, bazuar në analizën e korrespondencës së shumëfishtë. 99

Grafiku 43.4 Paraqitje e vendosjes së rasteve sipas përgjigjeve të pyetjeve bazuar në analizëne korrespondencës së shumëfishtë. 100

Grafiku 44.4 Paraqitje e vendosjes së përgjigjeve të pyetjeve ndaj njëra-tjetrës, bazuar në analizëne korrespondencës së shumëfishtë. 100

MIRËNJOHJE

Realizimi i këtij punimi ka qenë një rrugëtim i gjatë, i cili nuk do të kishte përfunduar pa mbështetjen e atyre që më ndihmuan në përfundimin e tij.

Ju shpreh mirënjohje dhe falenderoj:

- Udhëheqësin Shkencor Prof.Dr.Edmond Dragoti për mbështetjen dhe supervizimin hap pas hapi në realizimin e këtij punimi dhe këshillat e vlefshme për ta përfunduar sa më me suksese këtë tezë.
- Infektologun As.Prof. Arben Pilaca, që më ka mbështetur dhe udhëhequr në dijen për të kuptuar sëmundjen e HIV/AIDS, klinikën dhe se "një person që jeton me HIV/AIDS nuk ka nevojë për mëshirë, por për besim".
- Miqtë dhe kolegët e Spitalit të Sëmundjeve Infektive, për mbështetjen në rritjen profesionale si punonjëse sociale dhe kalimin e sfidave gjatë këtij procesi.
- Së fundi, por jo të fundit për nga rëndësia, të gjithë ata që me dinjitet e forcë jetojnë çdo ditë me sëmundjen e HIV/AIDS-it në Shqipëri, por në veçanti ata që pranuan të bëhen pjesë e studimit dhe të ndajnë me mua ndjesitë e tyre më të thella.

DEDIKUAR

Prindërve dhe vëllait tim, për gjithë dashurinë dhe mbështetjen e pakufijshme që më kanë dhënë gjatë gjithë jetës time.

"Ne duhet ta përcaktojmë vlerën më të lartë të jetës
jo për të jetuar gjatë, por për të jetuar më mirë!"

Sokrati

SHKURTESA

AIDS	Sindroma e Pamjaftueshmërisë Imunitare të Fituar
ARV	Antiretroviral
BPSHF	Besimet Personale, Shpirtërore, Fetare
EQOL	Cilësia e Jetës në Europë (Europian Quality of Life)
DQM	Ditë Qëndrimi Mesatar
DSM-V	Manuali Statistikor i Çrregullimeve Mendore- V
GDP	Produkti i Brendshëm Bruto
HIV	Virusi i Pamjaftueshmërisë Imunitare të Njeriut
HRQOL	Shëndeti lidhur me Cilësinë e Jetës
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ICD-10	Manuali Statistikor i Klasifikimit të Sëmundjeve dhe Problemeve të Lidhura me Shëndetin-10
KEMP	Komisioni i Ekspertimit Mjekësor për Paaftësinë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
PJHA	Persona që jetojnë me HIV/AIDS
QSUT	Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë
TAR	Terapi Antiretrovirale
UN	Kombet e Bashkuara
UNAIDS	Kombet e Bashkuara kundër AIDS-it
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara Ndërkombëtare të Fëmijëve
VCT	Këshillim dhe Testim Vullnetar
QOL	Cilësia e Jetës (Quality of life)
WHOQOL- HIV- BREF	Organizata Botërore e Shëndetësisë Cilësia e Jetës- HIV- Shkurtuar (World Health Organization Quality Of Life- HIV-BREF)

KAPITULLI

1 HYRJE

1.1 HYRJE

Pandemia e Virusit të Pamjaftueshmërisë Imunitare Njerëzore/Sindromi i Fituar i Deficencës (HIV/AIDS) është një problem shëndetësor dhe ekonomik shumë serioz që ka prekur 35.0 milionë (33.2-37.2) njerëz në gjithë botën deri në fund të vitit 2014 (OBSH, 2014). E konsideruar një sëmundje terminale, HIV/AIDS është kthyer në një sëmundje kronike, nga e cila personat e infektuar janë duke jetuar gjatë. Përparimet në zhvillimin e terapive antiretrovirale (TAR) kanë rritur nivelin e pritshmërisë së jetës në personat që jetojnë me HIV/AIDS (PJHA).

Duke patur parasysh jetëgjatësinë e arritur me anë të strategjive aktuale profilaktike dhe terapeutike për PJHA-në, cilësia e jetës është shfaqur si një masë e rendësishme e rezultatit të shëndetit dhe cilësisë së përmirësimit të jetës (Bachman, 2006; Douaihy & Singh, 2001). Përmirësimi i cilësisë së jetës në PJHA është një zonë gjithnjë e më e rëndësishme e ndërhyrjeve terapeutike tek pacientët të cilët mund të refuzojnë trajtimet nëse do të kenë rënie të cilësisë së jetës. Njerëzit preferojnë të jetojnë më pak, por me cilësi jete të lartë (Leplege, Rude, Ecosse, Ceinos & Dohin,1997; Zimple & Fleck, 2007).

Koncepti i cilësisë së jetës e ka origjinën në vitin 1947 dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e ka përmendur në përkufizimin e shëndetit (Grossman, Sullivan & Wu, 2003). Organizata Botërore e Shëndetit e ka përkufizuar cilësinë e jetës si "perceptim individual i pozitës së jetës së tyre në kontekstin e kulturës dhe sistemit të vlerave në të cilën ata jetojnë dhe në raport me qëllimet, pritshmëritë, standardet dhe shqetësimet e tyre" (WHOQOL Group, 1995b, p. 1405).

Edhe pse ky përkufizim ende nuk është përqafuar plotësisht nga studiuesit e cilësisë së jetës, ata bien përgjithësisht dakord me fushat. Interesi në matjen e cilësisë së jetesës është rritur gjatë tre dekadave të fundit, por fatkeqësisht ende nuk është rënë dakord për përkufizimin.

Sëmundja HIV/AIDS ka ndikuar në mënyrën individuale të të jetuarit dhe si rrjedhojë ka ndikuar edhe në cilësinë e jetës. Evidencat empirike tregojnë se si sëmundja HIV përparon dhe cilësia e jetës përkeqësohet (Bourgoyne & Saunders, 2001; Holzemer, Spicer, Wilson, Kemppainen & Coleman, 1999; Keimppainen,

2001; Penedo et al., 2003). PJHA përballen me probleme fiziologjike, fizike, psikologjike dhe socio-kulturore që shkaktohen nga katër faktorë, të cilët ndikojnë në cilësinë e jetës. Këta katër faktorë janë (a) simptomat e virusit, (b) rritja e disponueshmërisë së barnave që zgjatin jetën, (c) efektet anësore të terapisë antiretrovirale, dhe (d) infeksionet oportune (Cook et al., 2004; Corless, Nikollws, Davis dhe McGibbon, 2005; Portillo et al., 2005; Reynolds, 2004). HIV/AIDS shkakton vuajtje personale, ndërhyn në funksionimin e përditshëm dhe ndikon në marrëdhëniet personale dhe vendimmarrjen. Rëndësia për të gjetur mënyra për të zbutur pasojat e HIV/AIDS e bën cilësinë e jetës në PJHA një çështje të spikatur të kujdesit shëndetësor (Maguire, 1997; Penedo et al., 2003).

HIV dhe AIDS është sot një nga shqetësimet më të mëdha me të cilin përballen ofruesit e shëndetit në gjithë botën. Ende sot nuk ka një kurë për HIV-in. Kjo do të thotë që, nëse dikush infektohet, do të jetë gjithmonë i tillë. HIV-i njihet sot si një sëmundje kronike dhe e menaxhueshme.

Në krahasim me vendet e tjera të Europës, si rezultat i izolimit social dhe sistemit komunist që pengonte lëvizjen e lirë të qytetarëve, Shqipëria qëndroi "imune" ndaj HIV/AIDS-it deri në vitin 1990. Pasi sistemi komunist ra, filloi lëvizja e lirë dhe kjo është njëra anë e medaljes, shqiptarët u ekspozuan ndaj shumë sjelljve seksuale me faktorë risku HIV/AIDS-in.

Në Shqipëri, rasti i parë me HIV/AIDS është identifikuar në 1993, dhe që atëherë numri i rasteve me HIV/AIDS është rritur vit pas viti. Në dhjetor të vitit 2013 kishim 672 raste në total dhe 90% e tyre janë infektuar në rrugë seksuale (hetero) përfshirë meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM). Grup-mosha më e prekur e popullatës është midis moshës 25-44 vjeç. Shqipëria ende konsiderohet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV, 0,1% (1 për 1.000 sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Por, referuar tre studimeve të bio-survejancës (2005, 2008 dhe 2011), rezultatet treguan se kemi prezent një nivel të lartë të sjelljeve me risk midis popullatës më të rrezikuar, si përdorues të drogës dhe MSM-të.

Gjatë periudhës së parë të ecurisë së epidemisë së HIV në Shqipëri (1993-2000), numri mesatar i rasteve të diagnostikuara e të raportuara të PJHA-së ishte 6-7 persona në vit. Pas vitit 2000, janë diagnostikuar mbi 20 raste në vit, për të arritur një numër rekord prej 30 rastesh gjatë vitit 2004 dhe 72 raste të reja për 2013. Për më tepër, ka të dhëna të sigurta të transmetimit të HIV brenda vendit krahasuar me rastet e "importuara" të periudhës së parë.

Nëpërmjet programit SPECTRUM, i përgatitur bashkarisht nga OBSH-ja dhe UNAIDS, specialistët shqiptarë vlerësuan se "përmasat e vërteta" të epidemisë HIV në Shqipëri, luhaten nga 400–700 raste PJHA. James Chin (2002) bashkëpunoi me specialistët shqiptarë për të hartuar tre skenarë të mundshëm

për të ardhmen e epidemisë HIV në vend. Sipas skenarit më të keq të mundshëm, në Shqipëri mund të ketë 10-15.000 PJHA deri në vitin 2015.

Klinicistët, kërkuesit shkencor, politikbërësit, kompanitë farmaceutike dhe pacientët, të gjithë bien dakort për rëndësinë e cilësisë së jetës (Cleary, 1995). Studiuesit e cilësisë së jetës kanë udhëhequr njohjen e rëndësisë së cilësisë së jetës në praktikat e kujdesit shëndetësor (Grossman, Sullivan & Wu 2003).

Që nga viti 2004 e në vazhdim, Terapia Antiretrovirale (TAR) u ofrohet falas personave që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri. Ky trajtim ofrohet ne Qendrën Spitalore Universitare "NËNË TEREZA", Tiranë (QSUT), Spitali i Sëmundjeve Infektive. Me mbështetjen e Global Found, në fund të 2007-ës u hap edhe Klinika Ambulatore për PJHA-në. Aktualisht, në këtë klinikë marrin terapi me ARV 325 persona nga gjithë Shqipëria.

Numri i personave që marrin terapi (TAR) në vendet e zhvilluara është më shumë se i dyfishuar, nga 400 000 në dhjetor 2003, në 1 milionë në qershor 2005, referuar raporteve të OBSH-së (2006) dhe UNAIDS-it (2006). Në vendet me të ardhura të ulëta dhe me mesatare rreth 97 milionë njerëz deri në fund të vitit 2012 dhe 28.6 milionë njerëz kanë marrë mjekim deri në fund të 2013-ës (UNAIDS, 2013).

Edhe pse TAR-i mund të konsiderohet si një shpëtimtar nga shumë njerëz, QOL-ja e njerëzve nën TAR mbetet një shqetësim. Sipas Carr, Gibson dhe Robinson (2001), kujdesi shëndetësor është duke ndryshuar, dhe dy faktorët që udhëheqin këtë ndryshim janë njohja e rëndësisë së pasojave sociale të sëmundjes dhe pranimi se qëllimi i trajtimit mjekësor është rritja e gjatësisë dhe cilësisë së jetës të të mbijetuarve nga sëmundja. Rrjedhimisht, që të rrisim gjatësinë dhe cilësinë e jetës së PJHA-së, që janë ose jo nën terapi me TAR-in, është e rëndësishme të vlerësojmë si fillim QOL-në, sepse në shumë situata, gjatë sëmundshmërisë QOL, bëhet më e rëndësishme sesa jetëgjatësia.

Për më tepër, në lidhje me ndërhyrje të kujdesit shëndetësor, Addington, Hall dhe Kalra (2001) theksojnë se një nga arsyet pas zhvillimit të shpejtë të matjes së QOL-së në kujdesin shëndetësor ka qenë rritja e njohjes së rëndësisë së të kuptuarit e ndikimit të ndërhyrjeve të kujdesit shëndetësor tek pacientët jo vetëm fizikisht. Duket, pra, se është e rëndësishme që të kuptojnë se TAR-i është për përmirësimin tërësor të PJHA-së, jo vetëm në aspektin fizik të personit të infektuar. Përmirësimi holistik kërkon marrjen në konsideratë të komponentëve themelorë të QOL-së.

Sipas Cella (1992), si të cituar në Kinghorn dhe Gamlin (2002), ka dy komponentë themelorë të QOL-së. Këta janë subjektivizmi dhe shumëdimensionaliteti. Subjektivizmi, sipas Cella (1992), i referohet faktit se QOL mund të përcaktohet vetëm nga pacienti, dhe vetëm duke pyetur pacientin drejtpërdrejt

mund të vlerësohet komponenti subjektiv. Është e rëndësishme që, për këtë arsye, QOL-ja vjen nga përgjigjet subjektive të PJHA-së, pasi janë ata të vetmit që kanë "ecur me të vërtetën" dhe ata konsiderohen të jenë "zotër të fateve të tyre".

Në çështjen e shumëdimensionalitetit të QOL-së, Cella (1992), siç citohet në Kinghorn dhe Gamlin (2002), thekson se "shumëdimensionaliteti i referohet traditës psikometrike të matjes së statusit shëndetësor, që përfshin atë: fizik, funksional, emocional dhe mirëqenien sociale". Sipas Njësisë së Kërkimeve në Cilësinë e Jetës, në Universitetin e Torontos (1994), një qenie njerëzore është e përbërë nga tre fusha, secila ka tre nëndomene: "të jesh domen", "ti përkasësh një domeni", dhe "të bëhesh domen". Duke qenë se domeni është i ndarë në fizik, psikologjik, dhe fushat shpirtërore. Domeni i përkatësisë është i ndarë në përkatësi fizike, përkatësi sociale, dhe të komunitetit që i përket. Domeni të bëhesh, është i përbërë nga të bërit praktik, koha e lirë dhe të rriturit duke u bërë. Prandaj del se, në vlerësimin e QOL-së e PJHA-së, që janë nën TAR, statusi i tyre shëndetësor duhet të matet në përputhje me fushat përkatëse.

OBSH-ja (1948) e përkufizoi shëndetin si "mirëqenia e plotë fizike, mendore, shpirtërore dhe sociale dhe jo vetëm mungesa e sëmundjes". Pra, nisur nga ky përkufizim duhen patur parasysh aspektet kryesore gjatë vlerësimit të QOL-së në PJHV, që janë ato fizike, mendore, shpirtërore dhe koncepti emocional.

Sipas Calles dhe Schwrzwld (2001), shumica e njerëzve që marrin TAR do të jetojnë më gjatë sesa ata pa këtë mjekim. Duke ndarë të njëjtat qëndrime në lidhje me TAR-in dhe zgjatjen e jetës, Shernoff (2002), pohon se llojet e terapisë së kombinuar, që janë aktualisht duke u administruar, kanë sjellë individë të shumtë prapa nga pragu i vdekjes. TAR-ët janë përshkruar si "Droga Lazarus", të cilat prodhojnë "Lazarus Sindrom", e thënë ndryshe të "ringjallurit". Kjo ndodh për shkak se terapitë antiretrovirale ngadalësojnë shumimin e virusit HIV në atë masë saqë ngarkesa virale në gjak është reduktuar në nivele shumë të ulëta dhe madje të padedektueshme (Calles & Schwrdald, 2001). Kjo zvogëlon shanset e sulmimit nga infeksionet oportune dhe kanceri. PJHA-të, të cilët janë në TAR, mund të jetojnë një jetë afër normales.

Edhe pse TAR-i ka sjellë përfitime të konsiderueshme në kontrollin e virusit HIV dhe zgjatjen e jetës, shumë studiues mendojnë se ART-të kanë efekte anësore të pakëndshme që mund të dëmtojnë QOL-në (Roberts & Dennilk, 2006). Shumë ofrues të kujdesit shëndetësor janë ballafaquar me dilemën "rritja e jetëgjatësisë" kundrejt "përmirësimit të jetës". Në marrëveshje me çështjen e kësaj dileme, Burgoyne dhe Tan (2008) pohojnë se kohëzgjatja e jetës dhe QOL-së në një moshë shumë aktive me terapi antiretrovirale (HAART) është një sistem delikat i vështirë për ta mbajtur në një ekuilibër.

Sipas Shernoff (2002), të jesh nën TAR, do të thotë të jesh duke marrë pjesë në atë që ai e quan "gjykimin klinik më të pakontrolluar në historinë e shkencës mjekësore", sepse, sipas tij, askush nuk mund të thotë me siguri se cilat do të jenë efektet afatgjata të ilaçeve. Në sfondin e mësipërm, një është i detyruar të vendosë në pikëpyetje çështjen e cilësisë së jetës në PJHA, të cilët janë nën TAR.

Dudgeon (1992) thekson se qëllimi përfundimtar i mjekësisë (në sëmundjet kronike) është përmirësimi i QOL-së të pacientit. Megjithatë, Mitchell (2002) thekson se avancimi në shkencën mjekësore duket se ka çuar në një rënie në artin e shkencës mjekësore dhe që ndërhyrja mjekësore në kushtet e jetës që ata janë, sipas mendimit të saj, është më keq se vdekja. Mitchell (2002), gjithashtu, sugjeron se trajtimi i kancerit, i cili është gjithashtu një sëmundje kronike, mund të jetë më e keqe sesa sëmundja, dhe se nuk ka siguri se i sëmuri do të gëzojë një jetë më të gjatë. Kjo autore ka sugjeruar se trajtiminuk mund të garantojë një QOL të mirë. Duke marrë këto medikamente nuk është thjesht një çështje e marrjes disa herë në ditë. Përkundrazi, sipas Shernoff (2002), këto regjime të ilaçeve kanë efekte direkte, të cilat thellësisht kanë ndikuar në të ngrënin, gjumin dhe oraret e punës, si dhe ndërveprimet me njerëzit e tjerë çdo ditë. Të gjithë këta faktorë kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës së një personi. Kjo është ajo që duhet të marrin parasysh të gjithë profesionistët e shëndetit. TAR-ët mund të zgjatin jetën vërtetë, por edhe mund të veprojnë me një kosto të konsiderueshme për cilësinë e jetës në PJHA. Punonjësit e shëndetësisë duhet të jenë të shqetësuar më shumë në lidhje me cilësinë sesa me sasinë.

Në vend që të kemi sa më shumë njerëz nën TAR, shqetësimi duhet të jetë QOL-ja e këtyre njerëzve. QOL-ja duhet të merret si një tregues i rëndësishëm i efikasitetit të TAR-it, në krahasim me treguesit e tjerë, të tillë si: periudha spitalore, kohëzgjatjen e pushimit mjekësor, efektet anësore të barnave dhe vdekshmërisë.

Që nga fillimi i epidemisë AIDS, OBSH-ja e përkufizoi HIV/AIDS "jo vetëm si një problem mjekësor, por edhe si një problem social, ekonomik, etnik, ligjor dhe politik". QOL-ja sfidon të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor, farmaceutikën, politikbërësit që të shikojnë përtej TAR-it dhe të miratojnë një qasje holistike që përfshin të gjitha aspektet e jetës në përmirësimin e QOL-së së njerëzve.

1.2 NGRITJA E PROBLEMIT

Edhe pse TAR-i ta zgjat jetën duke vonuar përparimin e sëmundjes, kjo nuk do të thotë që infeksioni HIV do të zhduket. AIDS konsiderohet tani si një sëmundje kronike në Shqipëri. PJHA-të, për të menaxhuar sëmundjen e tyre kronike HIV, duhet të marrin TAR-in për pjesën tjetër të jetës së tyre, në mënyrë që ta zgjatin jetën. Kjo pra do të thotë se cilësia e jetës është bërë një e dhënë matëse e rëndësishme e rezultatit. Më parë, rezultatet e TAR-it janë matur në termat e kohës së mbijetesës dhe të vlerësimit të toksicitetit nga mjeku. Sot, cilësia e jetës është shfaqur si një vlerësim i rëndësishëm i ndikimit të TAR-it.

Ky studim doli për shkak të shqetësimit të studiueses që asnjë kërkim nuk është bërë për të vlerësuar QOL-në e PJHV-së në Shqipëri, të cilët janë ose jo nën TAR (që nga futja e TAR-it në vitin 2004). Është pranuar botërisht se AIDS është një problem social, madhor dhe prek individin në të gjitha aspektet e jetës. Ka qenë e supozuar se, për shkak të terapisë, ngarkesa virale është zvogëluar duke përmirësuar numërimin e qelizave CD4, gjë e cila ka sjellë përmirësimin e jetës. Është supozuar se ngarkesa virale dhe leximi i qelizave CD4 mund të reflektohet në ndjenjat e personit ditë pas dite.

Për më tepër, studiuesja gjithashtu ka vërejtur se QOL-ja e shumë njerëzve që marrin TAR-in matet nga prania ose mungesa e efekteve anësore të TAR-it dhe adherencës me mjekimin. Për këtë arsye besohet se prania e simptomave të pakëndshme me siguri do të ulë QOL-në e pacientit. Për të patur një QOL-ë të përmirësuar është supozuar të kemi një mungesë të simptomave. Studiuesja është e mendimit se QOL-ja e PJHA-së duhet të vlerësohet nga perspektiva e njerëzve që jetojnë me HIV dhe jo nëpërmjet supozimeve.

Prandaj qëllimi i këtij studimi është që të vlerësojë cilësinë e jetës së pacientëve të infektuar me HIV, të cilët vizitojnë Klinikën Ambulatore (QSUT), të vetmen qendër kombëtare që ofron shërbime mjekësore dhe psiko-sociale për PJHA-në në Shqipëri, për t'i lidhur këto rezultate me popullatën e përgjithshme. Ata janë pacientë me karakteristika të ndryshme, si në aspektin klinik dhe atë social. Si konkluzion, kjo tezë do të vlerësojë zbatueshmërinë e instrumentit të hartuar nga OBSH-ja, që vlerëson cilësinë e jetës, forma e shkurtuar (WHOQOL-HIV-BREEF), në popullatën HIV pozitiv të Shqipërisë. WHOQOL-BREF ka treguar nga studimet e kryera tashmë saktësi, besueshmëri dhe vlefshmëri të lartë.

Qëllimi studimit

Një qëllim apo propozim tregon ëndrrën, ndërsa objektivat tregojnë hapat për aktualizimin e ëndrrës (De Vos, 2002). Qëllimi kryesor i studimit është

vlerësimi i cilësisë së jetës së PJHA-së në Shqipëri nga perceptimi personal i PJHA-së.

Pyetjet kërkimore të studimit

Studimi ngre një sërë pyetjesh kërkimore, që kërkojnë shtjellimin dhe argumentimin e përgjigjeve përkatëse, dhe konkretisht:

- Si është cilësia e jetës së PJHA-së në Shqipëri?
- Si është cilësia e jetës së personave që janë nën terapi krahasuar me atë të atyre që nuk janë në terapi?
- Si është cilësia e jetës së femrave krahasuar me atë të meshkujve në PJHA?
- Si ndikon perceptimit i sëmundjes në cilësinë e jetës në PJHA?

Objektivat e studimit

- Validimi i pyetësorit WHOQOL-HIV-BREF për popullatën Shqiptare.
- Analizimi i konceptit të cilësisë së jetës në PJHA.
- Analizimi i karakteristikave individuale dhe klinike që ndikojnë në cilësinë e jetës së PJHA-së.

1.3 RËNDËSIA E STUDIMIT

Në këtë seksion diskutohet rëndësia e studimit. Diskutimi i përgjigjet pyetjeve të mëposhtme: Pse duhet që profesionistët e kujdesit shëndetësor të jenë të shqetësuar për QOL-në në përgjithësi dhe në veçanti për QOL-në e PJHA-së? Pse ky studim është i rëndësishëm për individët e infektuar dhe të prekur nga HIV, gjithashtu, për familjet dhe organizatat që janë të përfshira në kujdesin e PJHA-së?

Snoek (2000) është i mendimit që studimi i cilësisë së jetës të kryhet kryesisht për dy arsye. Së pari, për të vlerësuar funksionimin psiko-social të grupeve dhe pacientëve, për të identifikuar problemet dhe nevojat e tyre specifike në faza të ndryshme të procesit të sëmundjes. Së dyti, studimet e cilësisë së jetës janë kryer për të krahasuar ndikimin e regjimeve të ndryshme të trajtimit në mirëqenien dhe kënaqësinë e pacientit gjatë trajtimit. Është shumë e rëndësishme që, gjatë trajtimit, pacienti duhet parë në sistemin bio-psiko-social të tij.

Objektivat botërore në lidhje me luftën kundër sëmundjes HIV/AIDS nuk janë vetëm infektimi zero, reduktimi i vdekshmërisë së lidhur me HIV-in, por për të krijuar kujdesin dhe mbështetjen ndaj PJHA-së, dhe përmirësuar cilësinë e jetës së tyre (UNAIDS/ WHO, 2002). Për të realizuar këtë synim, nuk ka nevojë për të matur dhe monitoruar kujdesin klinik përmes cilësisë së jetës së PJHA-së (Skevington & O'Connell, 2003; Skevington, Bradshaw & Saxena, 1999).

HIV/AIDS në Shqipëri nuk është në kushtet e një pandemie, por kjo nuk do të thotë që ndaj PJHA-së të mjaftohemi vetëm duke u siguruar mjekimin me TAR. Është e rëndësishme të identifikojmë dhe vlerësojmë faktorët që ndikojnë në cilësinë e jetës së PJHA-së. Matja e cilësisë së jetës do të na çojë në sigurimin e kujdesit që gjeneron shpresë dhe besim (Skevington, 2002; Skevington & O'Connell, 2003).

Një nga arsyet kryesore që e bëri studiuesen për të kryer këtë studim ishte njohja që QOL-ja e shumë njerëzve që marrin ARV -matet me numërimin e qelizave CD4 dhe prania ose mungesa e efekteve anësore të trajtimit. Është supozuar se prania e simptomave të pakëndshme me siguri do të ulë cilësinë e jetës së pacientit, pra, mungesa e simptomave do të thotë një cilësi më e mirë e jetës. Kjo është në kontrast me një numër studimesh, të cilat tregojnë se përpjekja e trajtimi mjekësor është e lidhur më ngushtë me mënyrën se si ndjehen pacientët në raport me jetën e tyre dhe si ka ndikuar kjo gjendje në praninë e simptomave në vetvete.

Për më tepër, përputhshmëria me ndonjë trajtim varet se si ky trajtim ka prekur jetën e pacientëve. Duke patur parasysh faktin se ende nuk ka një kurë për HIV dhe AIDS, ofruesit e kujdesit shëndetësor duhet të zhvendosin vëmendjen e tyre nga kujdesi kurues në kujdes paliativ. Qëllimi i kujdesit paliativ, sipas Kirton et al. (2001), është për të adresuar nevojat fizike, psikologjike, sociale, shpirtërore dhe ekzistenciale të klientëve me sëmundje progresive të rrezikshme për jetën, me qëllimin e përgjithshëm të përmirësimit të QOL-së së individëve dhe familjeve. Kur një mjekim nuk është një opsion, i dashur bëhet objektiv primar (Mitchell, 2002). Kjo do të thotë të merresh me mirëqenien e klientëve në aspektin fizik, mendor, psiko-social dhe shpirtëror bazuar mbi përkufizimin e shëndetit nga OBSH-ja.

Përmirësimi i cilësisë së jetës është një çështje qendrore për kujdesin dhe mbështetjen e PJHA-së në vendet e zhvilluara, ku cilësia e jetës ka qenë e studiuar dhe konceptet e cilësisë së jetës janë njohur, promovuar dhe inkorporuar nga praktikat shëndetësore (Grossman, Sullivan dhe Wu, 2003). Cilësia e jetës së PJHA-së nuk është studiuar në Shqipëri, sepse prioritetet janë përqendruar

në njohuritë, ndryshimin e sjelljes dhe ofrimin e TAR-it, edhe pse Organizata Botërore e Shëndetësisë ka identifikuar rëndësinë e studimeve të cilësisë së jetës në HIV/AIDS (WHOQOL,1996; WHOQOL-HIV Group, 2003a).

Në realizimin e këtij studimi është përdorur instrumenti për matjen e cilësisë së jetës, i konceptuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Cilësia e Jetës (WHOQOL). Modeli konceptual dhe instrumenti janë zhvilluar dhe testuar në një mënyrë unike. Modeli WHOQOL dhe pyetësori janë zhvilluar në kultura të shumta në vende të ndryshme të botës, por jo në Shqipëri. Me anë të këtij studimi, përveçse analizojmë mirëqenien e një personi që jeton me HIV në kulturën Shqiptare, por testojmë edhe vlefshmërinë, edhe besueshmërinë e instrumentit WHOQOL-HIV-BREEF në kontekstin Shqiptar.

Së fundi, QOL-ja e vë pacientin në qendër të studimit dhe i jep peshën e duhur për mendimet e tyre. Siç u vu në dukje nga Orley, Sazena dhe Herman (1998), në Berlin dhe Fleck (2003), "ajo i përgjigjet shqetësimit të pacientëve duke mos u trajtuar si raste, por si qenie njerëzore që kanë një jetë me shumë aspekte që nuk kanë të bëjnë me sëmundjen e tyre". Kjo korrespondon me ndjenjat e Higginson dhe Carr (2001), të cilët janë të mendimit se vlerësimi QOL-së duhet të përqendrohet në trajtimin dhe vlerësimin e pacientit më shumë sesa vetë sëmundjes.

Përveç kësaj, rezultatet mund të përdoren si informacion bazë për të matur ndryshimet në cilësinë e jetës mbi rrjedhën, progresin e sëmundjes dhe trajtimin. Rezultatet ofrojnë një shtesë në vlerësimin aktual të shërbimeve shëndetësore. Hartuesit e politikave mund të përdorin rezultatet e studimit për t'u dhënë një vlerësim të zgjeruar të dy akseseve ndaj kujdesit shëndetësor dhe efektet e ndryshimeve të politikave të zbatuara në shërbimet shëndetësore për PJHA-në.

1.4 KUADRI KONCEPTUAL I STUDIMIT

Kuadri konceptual për studimin e propozuar është i bazuar në përkufizimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Cilësinë e Jetës (WHOQOL). Modeli WHOQOL (1995) është një model që u zhvillua nga një seri hapash. Pesëmbëdhjetë vende (shih tabelën 1) kanë ndjekur të njëjtin protokoll, kanë hartuar të njëjtën metodologji që përfshin katër hapa për të zhvilluar modelin WHOQOL (Skevington & O'Connell, 2003). Modeli është zgjedhur në studimin e tanishëm, sepse ai thekson rëndësinë e ndjeshmërisë kulturore dhe të natyrës subjektive të cilësisë së jetës.

Hapi fillestar ishte sqarimi i konceptit të cilësisë së jetës nga një grup i ekspertëve ndërkombëtarë. Kjo çoi në zhvillimin e një përkufizimi të cilësisë

së jetës dhe një protokoll studimi. Hapi i dytë ishte zhvillimi i një "pishine" të prodhuar me sende globale, duke përdorur informacionin e përfituar nga diskutime me fokus grupe të mbajtura në çdo qendër në terren.

Hapi i tretë ishte përcaktimi i sferave të cilësisë së jetës dhe përcaktimin e aspektve për secilën nga gjashtë fushat e cilësisë së jetës. Hapi i katërt ishte testimi dhe sqarimi i kuadrit WHOQOL nëpërmjet administrimit të një forme pilot WHOQOL për 250 njerëzit me sëmundje kronike dhe 50 të anketuarve të shëndetshme, në secilin prej 15 vendeve në terren në vende të ndryshme.

Rezultatet e hapit të katërt çuan në zhvillimin e një instrumenti të standardizuar WHOQOL. Pesëmbëdhjetë studime të vogla ndërkulturore janë realizuar nga grupi WHOQOL, duke përdorur pyetësorin WHOQOL, 300 pika për të vendosur pronat psikometrike të instrumentit (WHOQOL Group, 1998a). Rezultatet nga këto studime më të vogla janë përdorur për të zhvilluar një instrument të rafinuar të standardizuar WHOQOL me 100 objekte dhe peshore ekuivalente në përgjigje të intervalit. Modeli i kushtoi një rëndësi perceptimit të individit në të gjithë procesin e zhvillimit (WHOQOL Group, 1998a).

Tabela 1.1 Vendet fillestare ku u realizua projekti zhvillimor i (WHOQOL)

1	Bankok, Tajland
2	Barcelonë, Spanjë
3	Bath, Mbretëria e Bashkuar
4	Beer Sheva, Izrael
5	Harare, Zimbave
6	Qendra Kremlin, Francë
7	Madras, Indi
8	Melburn, Australi
9	Nju Delhi, Indi
10	Panama, Panama
11	Siatëll, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
12	Shën Petersburg, Rusi
13	Tilburg, Holland
14	Tokio, Japoni
15	Zagreb, Kroaci

Ky përkufizim i OBSH-ës mbi cilësinë e jetës thekson qëndrimin se cilësia e jetës është subjektive, përfshin aspektet pozitive dhe negative të jetës dhe është shumëdimensionale (WHOQOL Group, 1995a). Cilësia e jetës është një koncept i gjerë i lidhur në një mënyrë komplekse me: shëndetin fizik, psikologjik, nivelin e pavarësisë, marrëdhëniet sociale, bindjet personale dhe veçoritë në

marrëdhëniet me mjedisin e tyre (WHOQOL, 1998b). Nëpërmjet këtij hetimi sistematik, WHOQOL (1995b) identifikoi gjashtë fushat e cilësisë së jetës: (1) fizike, (2) psikologjike, (3) të nivelit të pavarësisë, (4) marrëdhëniet shoqërore, (5) të mjedisit dhe (6) spiritualiteti, feja dhe besimet personale (BPSHF). Modeli është gjithëpërfshirës i shumës totale të gjashtë fushave të cilësisë së jetesës.

Gjashtë domenet janë të ndërlidhura: kur njëri është i prekur, efekti do të përhapet në fusha të tjera (shih figurën 1). Mendohet gjithashtu se individët lëvizin në një vazhdimësi të cilësisë së jetës. Ka ende informacion të pakët në ndërlidhjen që ekziston midis sferave të cilësisë së jetës dhe nevojës për kërkime të mëtejshme për të qartësuar marrëdhëniet mes fushave të cilësisë së jetës (WHOQOL, 1995a). Detajet e modelit janë eksploruar më plotësisht në Kapitullin II, por një pasqyrë e secilit domen është dhënë më poshtë.

1.4.1 Domeni fizik

Domeni fizik është aftësia e një individi për të siguruar dhe përmbushur nevojat e jetës, duke përfshirë aktivitetet që bëjnë njerëzit në rrjedhën e tyre, duke përmbushur role të zakonshme dhe përballuar dhimbjen për të ruajtur mirëqenien (Phaladze et al., 2005.; WHOQOL, 1995b; WHOQOL Group, 1998b: WHOQOL-HIV Group, 2003b; Wilson & Clear, 1995; Sousa, 1996; Sousa, Holzemer, Henry and Slaugheter 1999). Shëndeti fizik i jep një individi aftësinë për të bërë gjëra dhe për t'u përshtatur me mjedisin.
Shëndeti fizik është vlerësuar nga perceptimet e një individi mbi energjinë dhe lodhjen, dhimbjen dhe parehatinë, gjumin dhe pushimin. Domeni shëndetësor fizik ka treguar një marrëdhënie pozitive me cilësinë e përgjithshme të jetës. Kur statusi fizik i dikujt është raportuar si i lartë, perceptimet mbi shëndetin fizik dhe cilësinë e jetës rezultonin më pozitive (Sousa et al., 1999).

1.4.2 Domeni psikologjik

Domeni psikologjik është perceptimi që një individ i bën imazhit të tij të trupit, funksioneve konjitive (të menduarit, të mësuarit, kujtesës dhe përqendrimit), vetërespektit, ndjenjave rreth vetes, dhe perceptimeve se si njerëzit e tjerë ndiehen me këtë person (WHOQOL, 1998a, WHOQOL-HIV, 2003a). Psikologjikja dhe mirëqenia është në qendër të vëmendjes intensive kërkimore dhe është e rëndësishme për përvojën e individit (WHOQOL-HIV, 2003b). Është reagimi vlerësues për personin, për jetën e tij ose të saj; qoftë në aspektin e kënaqësisë me jetën (vlerësimeve njohëse) ose në aspektin e afeksionit (reagime të vazhdueshme emocionale). Psikologjikja dhe mirëqenia është gjetur të jenë një burim i elasticitetit kundër stresit dhe duke u bërë të sëmurë. Gjendja e mirë psikologjike e një individi ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës (OBSH, 1995;

WHOQOL-HIV, 2003b).

1.4.3 Domeni autonomisë

Domeni i nivelit të pavarësisë është perceptimi që individi i bën aftësisë për punë, për të lëvizur përreth, varësisë nga ilaçet apo trajtimet, dhe aftësisë për të kryer aktivitetet e përditshme të jetesës. Domeni i nivelit të pavarësisë përfshin pavarësinë fizike dhe psikologjike (WHOQOL, 1998a, WHOQOL-HIV, 2003a). Pavarësia fizike dhe psikologjike janë të ndërvarura. Njerëzit në përgjithësi duan të jenë qenie të pavarura dhe të jenë nën kontrollin e jetës së tyre. Kur individët bëhen më pak të aftë për të qenë të pavarur dhe të kryejnë aktivitetet e të jetuarit në kohën e tyre, cilësia e tyre e jetës ka të ngjarë të jetë më e ulët. Niveli i ulët i pavarësisë ka një efekt negativ në sferën psikologjike dhe kjo do të çojë në përkeqësimin e cilësisë së jetës (OBSH, 1995; WHOQOL-HIV, 2003b).

1.4.4 Domeni marrëdhënieve sociale

Domeni marrëdhënieve sociale është perceptimi i një individi të marrëdhënieve me veten, familjen, miqtë dhe aftësinë për të kryer rolin e tij/saj. Ky domen përfshin perceptimet e një individi mbi mbështetjen sociale, aktivitetit seksual dhe përfshirjen sociale. Njerëzit vlerësojnë marrëdhëniet e tyre me veten dhe të tjerët (WHOQOL,1998b; WHOQOL-HIV, 2003a), duke pasur një ndjenjë përkatësimi dhe pranimi, ata kanë nevojë për t'u dashur në të dyja aspektet, si seksuale dhe joseksuale. Në mungesë të një ndjenje të tillë, individët bëhen të ndjeshëm ndaj vetmisë, ankthit dhe depresionit. Kur një individ nuk është më në gjendje të mirë fizike, emocionale ose seksuale për veten dhe të tjerët, cilësia e jetës shpesh është prekur negativisht (WHO, 1995; WHOQOL-HIV, 2003a).

1.4.5 Domeni mjedisit

Domeni mjedisit është aftësia e perceptimit të një individi të gjendjes financiare, sigurisë së mjedisit fizik dhe shtëpisë, qasjes ndaj të dyja shërbimeve: shëndetësore dhe sociale. Njerëzit do të donin që të kenë burimet financiare për të cilat kanë nevojë të përmbushin nevojat e tyre të përditshme (WHOQOL, 1998b, WHOQOL-HIV, 2003a). Mirëqenia fizike dhe siguria janë aspekte të rëndësishme të mjedisit, sepse ato japin lirinë emocionale dhe individuale. Është gjithashtu me rëndësi jetike që të kenë një qasje me shëndet të mirë, duhet të kenë cilësi të mirë dhe kujdes social në ofrimin e mundësive për marrjen e informacioneve (1995; WHOQOL-HIV, 2003b).

1.4.6 Domeni besimeve personale, shpirtërore dhe fetare

Domeni i besimeve personale, shpirtërore dhe fetare (BPSHF) ka të bëjë me perceptimin e një individi për masën në të cilën besimet personale i sigurojnë

kuptimin dhe udhëzimin për t'u marrë me situata të ndryshme në jetë. Ai përfshin perceptimet e faljes dhe fajit, shqetësimeve për të ardhmen, të vdekjes dhe vdekjen (WHOQOL, 1998a; WHOQOL-HIV, 2003a). Ka dëshmi në rritje se përvojat shpirtërore apo fetare të një personi janë kontribues të rëndësishëm për cilësinë e jetës (Ferrans, 2005; Ferrans, Zerwic, Wilbur dhe Larson, 2004; Pennington, 2006). Besimet shpirtërore, fetare dhe personale janë të rëndësishme për përballimin e diagnozës së sëmundjes dhe me përvojat gjatë progresit të saj (WHOQOL SRPB Group, 2005).

1.4.7 Karakteristikat individuale dhe klinike

Studimi i tanishëm përzgjedh karakteristikat individuale dhe klinike nga modeli WHOQOL. Karakteristikat individuale të përfshira janë: mosha, gjinia, statusi martesor, arsimi, profesioni dhe të ardhurat. Karakteristikat klinike janë: HIV serostatus, viti kur keni rezultuar pozitiv, viti kur mendoni se jeni infektuar, rruga e infektimit, marrja ose jo e terapisë antiretrovirale dhe kohëzgjatjen e terapisë antiretrovirale (shih tabelën 2, fq. 55).

Studimet fillestare të Grupit WHOQOL (1998a) zbuluan ndikimin e kufizuar të karakteristikave individuale dhe klinike mbi cilësinë e jetës. Rezultatet zbuluan se (a) gratë raportuan cilësi jete në mënyrë të konsiderueshme më të dobët për shumicën aspekteve të domenve të cilësisë së jetës, (b) të rriturit më të vjetër raportuan cilësi më të mirë të jetës me diferencë më të madhe të gjetur në domenin besimet personale, feja, shpirtërore dhe (c) pjesëmarrësit më pak të arsimuar raportuan cilësi më të dobët jete, veçanërisht në lidhje me aftësinë për të marrë informacion (WHOQOL-HIV Group, 2003b).

1.4.8 Përkufizimi i variablave të studimit

Variablat e studimit janë specifikuar sipas modelit konceptual të studimit dhe u adaptuan nga korniza WHOQOL (tabela 2, fq. 55) në qëllim të studimit. Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizoi cilësinë e jetës si "perceptimet e pozitës së jetës së individit në kontekstin e sistemeve të kulturës dhe të vlerave në të cilat ata jetojnë dhe në raport me qëllimet, pritjet, standardet dhe shqetësimet e tyre" (WHOQOL, 1995; WHOQOL- HIV, 2003a).

Shpjegime më të hollësishme të përkufizimeve të variablave të varura, variablave të pavarura, cilësisë së jetës, gjinisë dhe vendbanimit, të ardhurave ekonomike, janë ose jo në punë, marrin ose jo TAR etj., janë të përshkruara në tabelën 2 në kapitullin III.

1.5 PËRMBLEDHJE

Një numër i instrumenteve të ndryshme mbi QOL-në janë duke u provuar në studimet klinike (Bergner. M, Rothman. Ml., 1987).

I. Profilet e përgjithshme shëndetësore

Këto instrumente janë gjithëpërfshirëse, kanë krijuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë, mund të përgjithësohen dhe mund të zbulojnë efektet e paparashikuara. Nga ana tjetër, ato nuk mund të fokusohen në mënyrë adekuate dhe, nisur nga kjo, mund të mos jenë të përgjegjshme ndaj dallimeve të vogla, por klinikisht kuptimplota. Ato janë gjithashtu të shpeshta dhe të gjata në kohë. Përveç kësaj, një efekt mund të jetë i vështirë për t'u interpretuar.

II. Matjet e Shërbimeve të Përgjithshme

Këto instrumente mund të përdoren në çdo popullsi. Ato përgjithësisht mbulojnë perceptimet mbi shëndetin e përgjithshëm dhe gjithashtu pyetjet mbi funksionimin social, emocional, fizik, dhimbjes dhe vetëkujdesit. Standard Gamble (SG) ose Visual Analoge Scale (VAS) (Medina. Al, 2005.), janë shembuj. Ato bëjnë të pamundurën për të konstatuar një gjykim të vlerës dhe vlerën e jetës. Ato e perceptojnë shëndetin si një vazhdimësi dhe kështu analizat kosto-shërbime janë të mundshme. Ato mund të nxjerrin herë pas here rezultate të ndryshme midis pacientëve dhe mund të mos jenë përgjegjëse.

III. Sëmundja- Instrumentet Specifike

Këto instrumente fokusohen në objektivin, janë klinikisht të ndjeshëm, por nuk lejojnë krahasimet *cross-condition,* janë të ngushta në fushëveprim dhe të paorientuara në qëllim. Instrumentet-Studime-Specifike mund të jenë shumë të përqendruar për të hetuar efektet e ilaçeve të veçanta, por në përgjithësi nuk kanë vërtetuar në mënyrë adekuate se mund të zbulojnë efekte të papritura, dhe është firma farmaceutike ajo që vendos se kë dëshiron të pyesë dhe përcakton fushat. Ka edhe instrumente individuale, ku secili pacient, me udhëzimin përkatës, përcakton se cilat fusha të dëmtimit të tij/saj janë më të mundimshme. Format e individualizuara mund të rrisin përgjegjshmërinë, sepse ato theksojnë atë që ka rëndësi për pacientin, por ato janë të vështira për t'u analizuar, dhe krahasimi i subjekteve është i ndërlikuar pasi shqetësimet e tyre janë të ndryshme. Një metodë klinikisht e ndjeshme është që të na japë e një instrument të përgjithshëm dhe një instrument për sëmundje-specifike, i cili me anë të kombinimit bën një mbulim të gjerë, me përgjegjshmëri ndaj ndryshimeve të vogla në fusha të veçanta. Kjo mund të jetë humbje kohe dhe ndoshta mund të na çojë në rezultate kontradiktore.

2.5.2 Kërkesat për instrumente QOL në hulumtimet klinike

Ka një numër të kërkesave që çdo instrument duhet të përmbushë me qëllim që të mbledhë informacion nga pacientët (Lynda. Cd, David. Mm, Hanne. T. 2004; Fletcher. Rh, Fletcher. Sw, Wagner Eh. Williams and Wilkins, 1996). Këto kërkesa i referohen të dhënave psikometrike të instrumentit kryesor për vlefshmërinë e tij. Sigurisht, përveç derivimit të përmbajtjes dhe pranueshmërisë së të anketuarve, më poshtë do shpjegojmë kriteret e përmendura më shpesh për zgjedhjen e instrumenteve që vlerësojnë qëndrimet e njerëzve.

2.5.2.1 Vlefshmëria

Vlefshmëria e një instrumenti QOL është përcaktuar si masë për të cilën instrumenti i QOL-së mat atë për çfarë është projektuar për të matur. Paragjykimi i një instrumenti mund të reflektojë saktësinë e instrumentit. Ekzistojnë tri lloje themelore të vlefshmërisë, që janë gjendur më shumë në përdorim:

a) Vlefshmëria paraqet një vlerësim subjektiv nga një panel ekspertësh gjykues, përdoruesish apo zhvilluesish, që vlerësojnë nëse instrumenti mat atë që është ndërtuar për të matur.
b) Vlefshmëria e kampionimit konsiston në identifikimin e dimensioneve të rëndësishme të instrumentit, p.sh. shëndetin fizik ose social, duke përfshirë pikat që mbulojnë secilën nga kategoritë përkatëse brenda këtyre dimensioneve.

Vlefshmëria e konstruktit është e pranishme në atë masë që matja është në përputhje me matjet e tjera të të njëjtit fenomen, e cila është matëse e konstruktit të synuar. Tre parakushtet për këtë janë se instrumenti është i bazuar në një teori koherente ose përkufizim, se shkalla është njëdimensionale, dhe se ajo ka riprodhueshmërinë e mirë. Për shembull, studiuesi mund të tregojë se përgjigjet ndaj një shkalle matëse të dhimbjes janë të lidhura me manifestime të tjera të ashpërsisë së dhimbjes, si: djersitje, ankesa, dridhje dhe duke kërkuar medikamente për dhimbjen.

2.5.2.2 Besueshmëria

Besueshmëria e një instrumenti QOL referohet tek liria nga gabimet e rastit. Kjo është shkalla në të cilën përsëriten matjet e një fenomeni të qëndrueshëm nga njerëz dhe instrumente të ndryshme, në kohë të ndryshme, vende të ndryshme dhe rezultatet dalin të ngjashme (Fletcher Rh, Fletcher Sw, Wagner Eh).

2.5.2.3 Riprodhueshmëria

Riprodhueshmëria është përcaktuar si shkalla në të cilën përsëritja e një instrumenti QOL nga një administrator i ndryshëm të japë të njëjtin rezultat, duke supozuar se nuk kanë ndodhur ndryshime themelore. Vlerësimi i riprodhueshmërisë përfshin ndryshime të pritura dhe të papritura që mund të ndodhin në vlerësimin e QOL-së. Ajo përfshin pikën ndër-kohë dhe riprodhueshmërinë ndër-vlerësuese.

Për vlerësimin e riprodhueshmërisë, teknika e testimit ri-testim është përdorur shpesh. I njëjti instrument QOL administrohet në pacientë të cilët kanë arritur kushte të qëndrueshme në dy pika të ndryshme kohore. Këto dy pika kohore janë të ndara në përgjithësi në një gjatësi të mjaftueshme kohore, që është koha e mjaftueshme për të mbajtur mend vlerësimin e mëparshëm, por jo aq sa duhet për të lejuar ndonjë ndryshim në mjedis. Koeficienti Pearson, i dy rezultateve të përsëritura është studiuar më pas. Në praktikë, një korrelacion testim ri-testim prej 80% ose më i lartë është konsideruar i pranueshëm.

2.5.2.4 Përgjegjshmëria dhe ndjeshmëria

Reagimi i një instrumenti QOL ka të bëjë me aftësinë e instrumentit për të zbuluar një diferencë me rëndësi klinike brenda një trajtimi.

Ndjeshmëria është aftësia e instrumentit për të zbuluar një ndryshim klinikisht domethënës në mes të trajtimeve. Një instrument i vërtetuar QOL duhet të jetë në gjendje për të zbuluar një ndryshim në qoftë se ka me të vërtetë një ndryshim, dhe nuk duhet të zbulojë gabimisht një ndryshim në qoftë se nuk ekziston. Chow dhe Ki propozuan me saktësi pushtetin e indekseve për të vlerësuar reagimin dhe ndjeshmërinë e një instrumenti QOL kur krahasojmë efektin e drogës në QOL-në midis trajtimeve. Saktësia e indeksit mat probabilitetin e moszbulimit të ndonjë ndryshimi të rremë dhe indeksi energjisë pasqyron probabilitetin e zbulimit të një ndryshim kuptimplotë.

2.6 SHËNDETI-LIDHUR ME CILËSINË E JETËS DHE INFEKSIONIN HIV (HRQOL)

Përparimet në terapitë e medikamenteve dhe përdorimin e HAART kanë rritur në mënyrë dramatike pritshmëritë mbi jetëgjatësinë tek pacientët me infeksion HIV (Van Sighem Ai, Van De Wiel Ma, Ghani Ac et al., 2003) dhe adherenca me terapinë antiretrovirale efektive është gjithashtu e nevojshme për të vonuar përparimin e sëmundjes (Ickovics. Jr., Meade. Cs., 2002). HRQOL-ja për pacientët që jetojnë me sëmundjen e HIV-it është bërë gjithnjë e më e rëndësishme, objektivat e terapisë tani përfshijnë përmirësimin e HRQOL-së,

përveç reduktimit të simptomave, mbajtjen e virusit nën kontroll dhe zgjajtjen e jetës (Murdaugh. C., 1998). Megjithatë, efektet anësore të terapive të fuqishme antiretrovirale mund të përkeqësojnë HRQOL-në (Douaihy. A, Singh. N., 2011). Përveç kësaj, simptomat e lidhura me infeksionin HIV dhe efektet anësore të ilaçeve kundër këtij infeksioni (vjellje, ankth, konfuzion, probleme vizive, mosfunksionim seksual, anoreksi, pagjumësi, shtrembërim i shijeve) mund të ulin adherencën me terapinë, përveç zvogëlimit HRQOL (Ammassari. A., Murri. R., Pezzotti. P. et al., 2001; Gallant. Je., 2000).

Çështje mjekësore që lidhen me infeksionin HIV gjithashtu ndikojnë negativisht në HRQOL. Kequshqyerja shkakton ulje të imunitetit lidhur kjo me uljen e funksionalitetit të lidhur me punën (Kotler. Dp.,1997); kequshqyerja progresive është e lidhur fort me rrezikun e vdekjes (Babameto. G, Kotler. Dp., 1997). Diarrea kronike ndikon deri në 50% të personave të infektuar me HIV (Wilcox. Cm, Rabeneck. L, Friedman. S. 1996) dhe mund të rezultojë në përkeqësim të rëndësishëm në aktivitetin shoqëror, aktivitetet e përditshme të jetës, energjinë dhe shëndetin e përgjithshëm (Douaihy. A, Singh. N.2001). Anemia, e cila ndodh në gati gjysmën e pacientëve të infektuar me HIV (Ferri. Rs, Adinolfi. A, Orsi. Aj. et al. 2001) është një shkak i zakonshëm i lodhjes (Sullivan. Ps, Dworkin. Ms, 2003). Është e parashikueshme që anemia dhe lodhja kanë demonstruar një korrelacion të fortë negativ me HRQOL (Eller. Ls, 2001; Revicki. Da, Brown Re, Henry. Dh. et al., 1994). Trajtimi i anemisë është i lidhur me përmirësimin e HRQOL-së dhe nivelet në rritje të hematokritit (Revicki. Da, Brown. Re, Henry. Dh. et al.,1994).

Lipodostrofia, mosfunksionimi seksual dhe shqetësimet e gjumit, si pasojë e dy faktorëve të sëmundjes dhe trajtimit, janë të zakonshme në pacientët e infektuar me HIV dhe mund të kenë pasoja në dy aspekte, si fizike dhe emocionale. Sindromi *lipodystrophy* përbëhet nga anomalia metabolike dhe rishpërndarja e organit yndyrë në pacientët e infektuar me HIV. Kjo e fundit zakonisht përfshin humbjen e indit nënlëkuror dhjamor (lipoatrofinë) dhe akumulimin e indit dhjamor (lipohypertrophy) në organet e brendshme, duke rezultuar në një pamje që shihet në një sindromë gërryese. Kjo mund të kufizojë aktivitetet fizike dhe sociale, vetërespekt të ulët, dhe të çojë në depresion (Martednez. E, Garcia.Viejo Ma, Blanch. L., et al., 2001).

Mosfunksionimi seksual është raportuar se ndikon në më shumë se 50% të meshkujve gay në stadin simptomatik-HIV (Catalan. J, Klimes. I, Day A, et al.1992; Tindall. B, Forde. S, Goldstein. D, et al ,1994) dhe nuk është surprizë që kjo ndikon negativisht në HRQOL. Interesante është se mosfunksionimi seksual mund të ketë një shkak psikogjenik dy herë më shpesh se një shkak organik në këtë popullatë (Catalan. J, Meadows. J., 2000). Shqetësimet e gjumit

të raportuara shpesh në personat që jetojnë me infeksionin HIV përfshijnë vështirësi në të dyja format: në rënien në gjum dhe duke qëndruar gjatë në gjumë. Kjo mund të shkaktohet nga faktorë psikologjik (ankthi dhe depresioni), si dhe nga simptoma fizike (dhimbje, diarre, ethe, djersitje natën dhe kollë) (Lashley.F.,1999).

Përveç kësaj, faktorët psiko-social, sociodemografik dhe psikologjik mund të ndikojnë tek HRQOL në pacientët e infektuar me HIV. Diagnoza e infeksionit HIV, në vetvete, mund të ketë pasoja të dëmshme, duke përfshirë ndërprerjen e punës, kufizime në aktivitetin shoqëror dhe të varësisë nga të tjerët. Mbështetja e kufizuar sociale dhe aftësitë e dobëta të mbijetesës gjithashtu mund të ndikojnë negativisht HRQOL (Douaihy.A.,Singh.N.,2001,Eller.Ls.,2001). Faktorët sociodemografik, të tillë si: mosha më e vjetër, gjinia femërore, papunësia dhe të ardhura të ulëta kanë qenë të lidhura me HRQOL-në e dobët (Eller.Ls., 2001;Hays.Rd.,Cunningham.We.,Sherbourne.Cd., et al.,2000). Mbështetja e kufizuar sociale, papunësia, CD4 + qelizave të ulëta, simptomat HIV janë të lidhura me depresionin në personat që jetojnë me infeksionin HIV (Katz.Mh., Douglas.Jm Jr.,Bolan.Ga., et al., 1998). Interesante është se shkalla e kufizimeve fizike duket se e parashikon depresionin më mirë sesa e bën ashpërsia e sëmundjes (Griffin et al.,1998). Stresorë të tjerë që lidhen me infeksionin HIV përfshijnë ato të deklarimit të statusit HIVpozitiv, vendimmarrjes në lidhje me çështjet e privatësisë, negociatat mbi seksin e sigurt dhe frikën e dhunës (reale ose të perceptuar), që rezulton nga deklarimi i statusit HIV pozitiv (Nilsson Schonnesson. L., 2002).

2.7 PËRMBLEDHJE

Shqipëria është një nga vendet e Europës që vazhdon të ketë një prevalencë të ulët të infeksionit HIV/AIDS në popullatë. Problematik është fakti se kemi një numër të madh të rasteve të diagnostikuara në stad AIDS (QSUT,2014).

Ka disa përkufizime për cilësinë e jetës, megjithatë, puna e bërë nga studiuesit e cilësisë së jetës ka rezultuar në marrëveshje, në dy fusha të cilësisë së jetës. Së pari, cilësia e jetës është një koncept shumëdimensional. Së dyti, cilësia e jetës duhet të matet në aspektin e përvojave subjektive pozitive dhe negative të individit. Kjo është jetike për studiuesit dhe klinicistët që të marrin në konsideratë dallimet kulturore në përcaktimin e cilësisë së jetës (WHOQOL Group, 1998b).

Ekziston nevoja për drejtimin e një studimi të tillë nga një kuadër teorik. Mjetet janë të zhvilluara dhe të vlefshme për të matur dimensione të ndryshme të cilësisë së jetës, që mund të përdoren në të dy studimet gjatësore

(longtidunale) dhe *cross-condition*. Megjithatë, shumica e modeleve dhe mjeteve janë zhvilluar në vendet e zhvilluara dhe nuk janë vërtetuar në vendet në zhvillim. WHOQOL-HIV është instrument i vetëm që është identifikuar duke u zhvilluar në aspektin kulturor dhe gjithashtu duke përfshirë vendet në zhvillim. Progres është bërë në përcaktimin e cilësisë së jetesës në vendet e zhvilluara që kanë çuar në zhvillimin e ndërhyrjeve për të përmirësuar cilësinë e jetës. Por, shumë pak është bërë për të përcaktuar cilësinë e jetës së PJHA-së në vendet në zhvillim. Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Grupi i Cilësisë së Jetës kanë përshkruar gjashtë fushat e cilësisë së jetës dhe zhvilluar një instrument që mund të vlerësojë të gjashta fushat. Metodat dhe instrumenti i përdorur në këtë studim janë përshkruar në kapitullin e metodologjisë.

KAPITULLI
3

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3.1 HYRJE

Ky kapitull jep detajet mbi projektimin e studimit, llojin e metodës së përdorur, të dhënat e studimit dhe të kampionimit, instrumentit dhe procedurat e grumbullimit të të dhënave që janë përdorur për studimin aktual.

3.2 DISAJNI I STUDIMIT DHE LITERATURA MBËSHTETËSE

Ky është një studim i natyrës përshkruese, që u realizua në Klinikën Ambulatore, Spitali i Sëmundjeve Infektive, QSUT, Tiranë. Në studim u përfshinë 199 persona që jetojnë me HIV/AIDS. *Qëllimi i studimit është*: Së pari, vlerësimi i cilësisë së jetës së PJHA-së në Shqipëri. Së dyti, kërkimi synon të kuptojë se si sëmundja e HIV/AIDS ndikon në QOL-në e PJHA-së. Së treti, për të shqyrtuar ndryshimet në cilësinë e jetës për personat që janë nën terapi, atyre që nuk janë nën terapi me TAR. Së katërti, për të analizuar ndryshimet në cilësinë e jetës midis meshkujve dhe femrave që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri.

Pse është zgjedhur metoda e kombinuar për analizimin e cilësisë së jetës?

Perceptimi i cilësisë së jetës nga pacientët me HIV/AIDS është një eksperiencë personale dhe e tillë mbetet. Ai mund të kërkojë ta ndajë atë me të tjerë si një qenie sociale apo si një person që kërkon ndihmë për problemin e tij/saj madhor shëndetësor. Mjeku/punonjësi social/psikologu nga ana tjetër është i interesuar të dijë, të njohë para se të shtrijë dorën për ndihmë. Marrëdhënia e të sëmurit me specialistët e ndihmon atë të artikulojë dhe të qartësojë imazhin e vetes në raport me gjendjen e tij të re. Megjithatë, të sëmurët ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri dhe marrëdhënia e secilit me specialistin është e pangjashme ndërmjet tyre.

Zakonisht, pyetjet që mund t'i bëjmë një specialisti janë: "Sa të sëmurë ke me HIV/AIDS?", "Sa lekë duhen për sigurimin e trajtimit me TAR?", "Sa e vuajnë të sëmurët faktin që janë HIV pozitiv?" etj.

Sintetizimi i eksperiencave të të sëmurëve kthehet në domosdoshmëri. Eksperiencat cilësore që përbëjnë cilësinë e jetës janë të vështira për t'u matur dhe për t'u kuantifikuar. Në fushën e psikiatrisë klinike mund të marrim shembull të ngjashëm kodifikimet e sëmundjeve mendore, DSM-V dhe ICD-

10. Të dyja këto kodifikime kanë për qëllim t'i kategorizojnë diagnozat e sëmundjeve mendore, duke u bazuar mbi simptomatologjinë dhe sindroma të caktuara. E njëjta iniciativë është edhe pyetësori WHOQOL-HIV-BREF. Kërkues të ndryshëm marrin rezultate të ndryshme, por duke folur të njëjtën gjuhë.

Duket një iniciativë e arsyeshme për të studiuar cilësinë e jetës në mënyrë të përmbledhur për të gjithë pacientët. Pjesa e dëshiruar e pyetësorëve është aftësia e tyre për të përmbledhur, por pa harruar që një punë e tillë na bën të humbim karakteristikat personale të pacientëve, aq të rëndësishme, sa edhe ndërhyrja profesionale në nivel individual. Megjithatë, pyetësori dhe kolaudimi i tij ka vlerë të pamohueshme në aspektin studimor të fenomenit dhe në marrjen e vendimeve në këtë komunitet.

Ashtu si në dy klasifikimet e përmendura më sipër, edhe pyetësori WHOQOL-HIV-BREF ka të domosdoshëm vlerësimin e aspektit të besueshmërisë. Në fushën e psikiatrisë klinike, DSM-V dhe ICD-10 e kanë të testuar vlefshmërinë në praktikë, ndërsa pyetësori e ka të nevojshëm të testohet edhe nga aspekti statistikor.

Aspekti tjetër i diskutuar është aspekti i vlefshmërisë së instrumentit, që ashtu si në fushën e psikiatrisë klinike nuk mund të ketë një masë të vetme matjeje që është një ndër pikat që e bën instrumentin relativisht të përdorshëm. Kjo meqenëse instrumenti ka për qëllim futjen e termave që përcaktojnë cilësinë e jetës në kategori, kallëpe të caktuara, ndërkohë që kjo praktikisht nuk është tërësisht e mundur nëse flasim për individë të veçantë. Një situatë e tillë kërkon edhe trajtimin e çështjes me mjetet tradicionale, karakteristike të shkencave sociale, madje duke e konsideruar si domosdoshmëri ose si anë tjetër të medaljes.

Validimi i rezultateve të pyetësorit mund të shërbejë si një parashikues i mirë, gjithmonë i kombinuar me metodologjinë e shkencave sociale.

3.3 VENDI I REALIZIMIT TË STUDIMIT

Ky studim është realizuar në Klinikën Ambulatore, e vetme e këtij lloji në Shqipëri që ofron shërbim mjekësor dhe shërbim psikosocial për PJHA-në. Shërbimi për personat që jetojnë me HIV/AIDS është i qendërzuar në Tiranë.

Klinika Ambulatore ofron shërbim për 520 persona nga këta 325 janë nën terapi me ARV. Ajo është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte, nga ora 8 : 00 - 15 : 00. Shërbimet e ofruara në klinikë përfshijnë: këshillimin para-testimit dhe post-testimit mbi HIV dhe ekzaminimet klinike, fillimin e terapisë antiretrovirale, monitorimin e pacientëve dhe ndjekjen e kujdesit shëndetësor dhe psikoemocional.

3.4 POPULLSIA DHE KAMPIONIMI

Popullsia dhe kampionimi janë dy koncepte mbi të cilët studiuesia ka diskutuar, pasi ata janë të rëndësishëm sepse nëpërmjet tyre ajo ka përshkruar qartë çfarë popullsie ka marrë për vlerësimin e QOL-së dhe se si janë përzgjedhur pjesëmarrësit. Të dy konceptet janë diskutuar më poshtë.

- **Popullsia**

Popullsia i referohet të gjithë grupit të individëve apo objekteve që kanë disa karakteristika të përbashkëta (Rrum & Beck, 2008). Popullsia e synuar për këtë studim ishin PJHA-në në Shqipëri, të cilët kanë qenë nën TAR për më shumë se një vit. Referuar edhe studimeve të ngjashme (PUBMED), kjo është një periudhë e mjaftueshme për të krijuar përvojën mbi TAR dhe për t'u bërë pjesë e studimit.

- **Kampionimi**

Kampionimi është një mostër në mesin e popullsisë, që është përzgjedhur për të marrë pjesë në studim (Rrum & Beck, 2008). Në hulumtimin cilësor, mjaftueshmëria e kampionit i referohet përshtatshmërisë së informacionit, që do të thotë se të dhënat e mbledhura, deri sa nuk ka informacion të ri, janë marrë nga pjesëmarrësit. Këto quhen të dhëna plotësuese (*data saturation*). Mjaftueshmëria e informacionit nuk është siguruar nga numri i pjesëmarrësve të intervistuarve, por nga cilësia e informacionit të mbledhur.

Popullata e përfshirë në këtë studim është jopropabilitare. Janë zgjedhur pacientë që janë paraqitur në mënyrë konsekutive pranë Klinikës Ambulatore, Shërbimit të Sëmundjeve Infektive QSU "Nënë Tereza", Tiranë. Subjektet në studim janë të rritur me serostatus të ndryshëm HIV, duke filluar nga asimptomatik, simptomatike apo AIDS. Nga 200 pacientët e zgjedhur, vetëm njëri prej tyre ka vdekur gjatë studimit.

3.4.1 Kriteret e marrjes së kampionëve

Kriteret për zgjedhjen e kampionimit janë një listë e karakteristikave thelbësore për anëtarësim në një popullatë të caktuar (Burns & Grove, 2005). Kriteret e kampionimit janë bazuar në problemin e kërkimit shkencor, qëllimin e kërkimit dhe disejnimin kërkimor. Kriteret e mostrave për këtë studim ishin si vijon:

(a) HIV pozitiv;
(b) mbi një vit që marrin TAR;
(b) 18 vjeç e lart;

(c) marrja e kujdesit shëndetësor në klinikën ambulatore;
(d) mendërisht dhe fizikisht në gjendje për të plotësuar pyetësorin

3.4.2 Koha e realizimit të studimit

Periudha e realizmit të studimit varion nga dhjetor 2012 deri në shtator 2013. Studimi është realizuar në ambientet e klinikës ambulatore, zyra e punonjëses sociale të këtij institucioni. Nga të gjithë subjektet e përfshirë në studim është marrë konsensusi dhe respektuar konfidencialiteti. Koha e plotësimit të pyetësorit zgjati nga 30 në 45 minuta. Në pjesën më të madhe të subjekteve, pyetësori është plotësuar nga studiuesja me kërkesë të vetë subjekteve.

3.5 PROCESI I PËRKTHIMIT TË INSTRUMENTIT NË STUDIM

Përkthimi i versionit nga anglisht në shqip i instrumentit kaloi në tre faza: përkthim, ripërkthim dhe harmonizim. Përkthimi në shqip u krye nga një subjekt me diplomë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, nën supervizimin e hulumtueses. Të gjithë elementët që treguan dallime midis versionit origjinal dhe versionit të ripërkthimit janë diskutuar tërësisht mes studiueses dhe përkthyeses. Pas disa ndryshimeve në versionin e parë të përkthimit, kemi marrë versionin final të WHOQOL-BREF shqiptarë, i cili është përdorur në studim.

3.6 PËRKUFIZIMET E STUDIMIT DHE KONTROLLIT TË VARIABLAVE

Përcaktimet konceptuale dhe operative të variablave të varur (cilësia e jetës dhe gjashtë fusha të saj), ndryshoret e pavarura (gjinore dhe qëndrimet) dhe variablave të kontrollit (individuale dhe karakteristikat klinike) janë dhënë në tabelën më poshtë.

Tabela 2.3 Përkufizimet operacionale dhe konceptuale të variablave

Variabli	Përkufizimi Konceptual	Përkufizimi Operacional
	Variabli Varur	
	Domenet e Cilësisë së Jetës	
Cilësia e Jetës	Perceptimet individuale mbi jetën në kontekstin e sistemeve të kulturës dhe të vlerave në të cilat ata jetojnë dhe në raport me qëllimet, prirjet, standardet dhe shqetësimet e individit (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).	Shuma e rezultateve të katër pikave të aspekteve të përgjithshme (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).
Domeni Fizik	Aftësia e individit për të siguruar nevojat e jetës, duke përfshirë aktivitetet e tyre në rrjedhën normale të jetës për të përmbushur nevojën themelore, rolet e zakonshme, përballur me dhimbjen, shqetësimet për të ruajtur mirëqenien (WHO, 1995; WHOQOL, 1996).	Rezultatet e shumës mesatare të 4 aspekteve të pjesëtuar me 4 (matjen e dhimbjes, parehati, energjia, lodhja, gjumi dhe pushim, simptomat e PJHA-së në Shqipëri (WHO, 1995; WHOQOL, 1996).
Domeni Psikologjik	Perceptimet e individit mbi imazhin fizik të trupit, funksionin konjitiv (të menduarit, të mësuarit, kujtesës dhe përqendrimit), ndjenjat për vetë-respektin për veten dhe perceptimet se si njerëzit e tjerë mendojnë për personin (WHO, 1995; WHOQOL, 1996).	Rezultatet e shumës mesatare të 5 aspekteve pjesëtuar për 5 (matjen e ndjenjave pozitive, të menduarit, të mësuarit, kujtesën dhe përqendrimin, vetë-respektin, imazhin trupor, paraqitjen dhe ndjenjat negative të PJHA-së në Shqipëri (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).
Domeni i Nivelit të Autonomisë	Perceptimet e një individi mbi aftësinë për të punuar, lëvizur përreth dhe të kryejë aktivitetet e përditshme të jetesës (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).	Shuma e rezultateve mesatare të 4 aspekteve të pjesëtuara për 4 (matja e lëvizshmërisë, aktivitetet e përditshme të jetesës, varësia nga medikamentet apo trajtimeve dhe kapaciteti për të punuar PJHA-në në Shqipëri) (WHO, 1995; WHOQOL, 1996).
Domeni i Marrëdhënieve Sociale	Perceptimi i individit mbi marrëdhëniet e tij/saj me veten, familjen, miqtë dhe aftësia për të kryer rolin e tij/saj (WHO, 1995; WHOQOL, 1996).	Shuma e rezultateve mesatare të 4 aspekteve pjesëtuar me 4 (matjen e marrëdhënieve personale, mbështetjen sociale, aktiviteti seksual dhe përfshirjes sociale të PJHA-së në Shqipëri) (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).

Domeni Mjedisit	Perceptimet e individit mbi të ardhurat e tij/saj financiare, sigurinë e mjedisit fizik dhe shtëpisë, dhe qasjen e tij/saj për shërbimet shëndetësore dhe sociale (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).	Shuma e rezultateve mesatare të 8 aspekteve pjesëtuar me 8 (matjen e burimeve financiare, lirinë, sigurinë fizike dhe sigurinë, shëndetin dhe kujdesin social: aksesin dhe cilësinë, mjedisi në shtëpi, mundësitë për marrjen e informacioneve dhe shkathtësive të reja, pjesëmarrja në aktivitete dhe mundësitë për aktivitete/kohën e lirë, mjedisin fizik dhe transportin në PJHA në Shqipëri) (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).
Domeni i Besimeve Personale/ Fetare/ Shpirtërore	Perceptimet e një individi mbi bindjet e tij/saj personale për t'u dhënë kuptim dhe udhëhequr në aftësinë për t'u marrë me situata të ndryshme në jetë (OBSH, 1995; WHOQOL, 1996).	Shuma e rezultateve mesatare të 3 aspekteve pjesëtuar për 3 (falja dhe faji, shqetësimet për të ardhmen, vdekjen dhe të vdekurit në PJHA në Shqipëri) (WHO, 1995; WHOQOL, 1996).

	Variabli	Definicioni Konceptual	Definicioni Operacional
1	**Etnia**	Që lidhet me një popull a me një komb të caktuar dhe me kulturën materiale e shpirtërore të tij.	Etnia: 1 = Shqiptarë, 2 = Egjiptian
2	**Çift**	Mashkulli dhe femra që jetojnë së bashku dhe ndajnë të drejtat dhe detyrimet.	Çift: Çift janë konsideruar personat që janë çift brenda studimit. 1 = Po, 2 = Jo.
3	**Gjinia**	Tërësia e tipareve natyrore, që dallojnë mashkullin nga femra dhe që i përcaktojnë secilit rolin e veçantë në riprodhimin e llojit; seksit.	Gjinia: Gjinia sipas vetëraportimit të subjektit. 1 = Po, 2 = Jo.
4	**Mosha**	Vitet e jetës që ka mbushur një njeri që nga lindja deri në një periudhë të caktuar.	Mosha: Mosha në vite e raportuar nga vetë subjekti.
5	**Grup-mosha**	Grup i moshave të caktuara, që kanë një ndryshim zakonisht deri në pesë vjet.	Grupmosha: 1 = 16-24 vjeç, 2 = 25-34 vjeç, 3 = 35-44 vjeç, 4 = 45-54 vjeç, 5 = 55-64 vjeç, 6 = > 65 vjeç.
6	**Arsimi**	Tërësia e njohurive dhe e shprehive që jepen me sistem e sipas një programi në shkolla e kurse të ndryshme për të mësuar e për të edukuar brezin e ri dhe masat e gjera punonjëse	Arsimi: 1 = fillore, 2 = 8-vjeçare, 3 = e mesme, 4 = e lartë.
7	**Qyteti**	Qendër e madhe banimi, me shumë shtëpi të ndara zakonisht në lagje, me rrugë e me sheshe të rregulluara, ku zhvillojnë veprimtarinë e tyre një varg institucionesh politike, shoqërore, administrative, kulturore etj. dhe ndërmarrjesh industriale, tregtare etj.	Qyteti: Vendbanimi në momentin e intervistës sipas ndarjes administrative me 36 rrethe.
8	**Komente**	Mendime e vërejtje që japim për një ngjarje, për një veprim, për një vendim etj.	Rubrikë komentesh e lirë për të intervistuarin.
9	**Emigrant**	Ai që është larguar nga atdheu i vet për shkaqe politike, ekonomike etj. dhe është vendosur përkohësisht a përgjithmonë në një vend të huaj.	Emigrant: 1 = Po, 2 = Jo.
10	**Shteti**	Shteti është shprehje e nevojës që ndien shoqëria për ekzistencën e një pushteti të organizuar, të pajisur me mjetet e duhura të shtrëngimit dhe të aftë për ta drejtuar vetë shoqërinë, duke i imponuar zgjidhjet që atij i duken të arsyeshme, nëpërmjet normave juridike.	Shteti: Shteti ku ka emigruar. Variabël tekst sipas vetë deklarimit të subjektit.
11	**Kemp**	Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Marrin një pagesë që jepet në formën e një kësti mujor, në lekë.	KEMP: 1 = Po, 2 = Jo
12	**Partneri/a HIV+**	Dy njerëz që kanë një lidhje intime ose që jo domosdoshmërisht janë në martesë.	Partneri HIV+: Serostatusi i provuar 1 = po, 2 = jo, 3 = nuk ka, 4 = pa testuar.

13	**Merre TAR**	Mjekimi që përdoret në trajtimin e infeksionit të shkaktuar nga retroviruset HIV.	Merr TAR: 1 = Po, 2 = Jo.
14	**Ka nderprerë TAR**	Pasi e ka filluar terapinë me antiretroviarle ka ndërprerë atë për arsye të ndryshme.	Ka ndërprerë TAR: 1 = Po, 2 = Jo.
15	**E ka treguar ose jo statusin HIV + jashtë familjes**	A e ka treguar diagnozën e sëmundjes edhe me persona që nuk ka lidhje gjaku.	A e ka treguar statusin jashtë familjes: 1 = Po, 2 = Jo.
16	**Punon**	Ai që mbahet me të ardhurat e veta, që punon në një ndërmarrje, institucion etj.	Punon: 1 = Po, 2 = Jo.
17	**Gj.Civile**	Është tërësia e të dhënave personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin, si dhe marrëdhëniet midis tyre (ligji 8950, neni 3, pika 1).	Gjendja civile sipas rekomandimit të pyetësorit: 1 = beqar, 2 = i martuar, 3 = i ve, 4 = i divorcuar, 5 = jeton si i martuar.
18	**Si është shëndeti juaj**	Perceptimi individual mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore.	Si është shëndeti juaj: Ordinal, 1-5.
19	**E konsideron veten të sëmurë**	Perceptimi subjektiv në raport me sëmundjen dhe të ndjerit i sëmurë ose jo.	A e konsideroni veten të sëmurë?: 1 = Po, 2 = Jo.
20	**Serostatus**	Serostatusi nuk tregon që i sëmuri është me AIDS, por tregon vetëm që ka qenë në kontakt me HIV-in dhe ka antikorpe ndaj tij.	Serostatusi: 1 = asimptomatik, 2 = simptomatik, 3 = nuk e di, 4 = i konvertuar në AIDS.
21	**Kur e keni bërë testin për herë të parë**	Viti i diagnostikimit të subjektit HIV pozitiv.	Viti sipas vetëdeklarimit të të intervistuarit.
22	**Kur mendoni se jeni infektuar**	Viti kur subjekti dyshon, mendon se mund të jetë infektuar.	Viti sipas vetëdeklarimit të intervistuarit.
23	**Rruga e infektimit**	Mënyra se si subjekti mendon se mund ta ketë marrë infeksionin.	Rruga e infektimit: 1 = seks me grua, 2 = seksme burrë, 3 = produkte gjaku, 4 = përdorim droge, 5 = tjetër.
24	**P1-P31**	Pyetjet e instrumentit të cilave duhet t'u përgjigjet subjekti, fillojnë nga 1 deri në 31.	Pyetje, P1-P31: (31 njësi) (Pyetja 1 (P.1) në instrument i korrespondon variablit me etiketë HBREF_1, etj.), shkallë ordinale me vlera ndërmjet 1-5.

3.7 INSTRUMENTI WHOQOL HIV-BREF

Fakti është që 95% e personave të infektuar me HIV nuk jetojnë në USA, por në vendet në zhvillim, si: Azia, Amerika Latine dhe Afrika Nën-Sahariane. Nisur nga ky fakt, OBSH-ja zhvilloi një instrument për të matur drejtpërdrejt cilësinë e jetës së këtyre njerëzve.

Instrumenti WHOQOL-HIV-BREF është i bazuar mbi WHOQOL-BREF, forma e shkurtuar e versionit WHOQOL-100. Ky instrument është përkthyer në më shumë se 50 vende, validizuar në mijëra studime dhe është i disponueshëm në 19 gjuhë të botës (WHOQOL, 2008).

WHOQOL-HIV-BREF prodhon gjashtë domene me pikët përkatëse. WHOQOL-100 ka katër pyetje për çdo aspekt, BREF WHOQOL-HIV ka vetëm një pyetje. Të përfshira në këto, janë dy pyetje që shqyrtojnë cilësinë e përgjithshme të jetës: Pyetja 1 pyet për perceptimin e përgjithshëm të një individi mbi cilësinë e jetës dhe pyetja 2 pyet për perceptimin e përgjithshëm të një indidvidi mbi shëndetin e tij/saj. Prandaj, ky instrument ka 31 pyetje që përfaqësojnë 30 aspekte. Pesë nga këto aspekte janë specifike për HIV/AIDS.

Ashtu si WHOQOL-100, pikat individuale janë renditur në një shkallë 5 pikësh Likert, ku 1 tregon vlerën më të ulët, perceptimet negative dhe 5 tregon perceptimin më të lartë, pozitiv. Për shembull, një pyetje që ka një ndjenjë aspekti pozitiv, pyet: "Sa e gëzoni ju jetën?" dhe përgjigjet në dispozicion janë 1 (aspak), 2 (pak) 3 (e moderuar), 4 (shumë) dhe 5 (një sasi ekstreme). Si e tillë, domeni dhe rezultati i aspektit (facet) janë shkallëzuar në një drejtim pozitiv, ku rezultatet më të larta tregojnë cilësinë më të lartë të jetës. Disa aspekte (dhimbje dhe parehati, ndjenjat negative, varësia nga ilaçet,vdekja) nuk janë të shkallëzuar në një drejtim pozitiv, që do të thotë se për këto aspekte rezultatet më të larta nuk kanë treguar cilësinë më të lartë të jetës. Këto duhet të rikodohen sepse kështu rezultatet e larta pasqyrojnë një QOL më të mirë. Pyetjet janë të organizuara nga shkalla e përgjigjeve (kapaciteti, frekuenca, intensiteti ose kënaqësia). Udhëzimet për llogaritjen e pikëve janë dhënë më poshtë. Këto janë sipas dosjes së sintaksës, e cila mund të merret nga Koordinatori WHOQOL-HIV, Shëndeti mendor: Evidenca dhe Kërkime, Departamenti i Shëndeti Mendor dhe Varësia e Substancave, CH-1211 Gjenevë 27, Zvicër.

Tabela 3.3 Udhëzime për llogaritjen e pikëve të 26 pyetjeve.

Hapat	Sintaksa e SPSS-it për kryerjen e kontrollimit të të dhënave, pastrimit dhe informatizimit të rezultateve totale.
Kontrolli i 26 pyetjeve nga vlerësimi kanë një sërë 1-5	Rikodet P1 P2 P3 P4 P5 P6 P7 P8 P9 P10 P11 P12 P13 P14 P15 P16 P17 P18 P19 P20 P21 P22 P23 P24 P25 P26 P27 P28 P29 P30 P31 (1=1) (2=2) (3=3) (4=4) (5=5) (ELSE=SYSMIS).

Në tabelën më poshtë janë dhënë udhëzimet për llogaritjen e pikëve të pyetjeve që transformohen në drejtim negativ.

Tabela 4.3 Ndryshimi në drejtim negativ i pyetjeve të formuluara.

Ndryshimi në drejtim negativ i 6 pyetjeve të formuluara	RIKODUAR P3 P4 P5 P8 P9 P10 P31 (1=5) (2=4) (3=3) (4=2) (5=1). (Kjo i transformon pyetjet e përshtatura negativisht në pyetje të përshtatura pozitivisht.)

Rezultati mesatar i pyetjes brenda secilës fushë është përdorur për të llogaritur rezultatin e domenit. Pikët mesatare atëherë janë shumëzuar me 4, në mënyrë që të nxjerrin rezultatet e domenit të krahasueshme me rezultatet e përdorura në WHOQOL-100, kështu që rezultatet variojnë midis 4 minimale dhe 20 maksimale.

Tabela 5.3 Llogaritja e pikëve të domeneve.

Llogaritja e pikëve të domeneve	Domeni 1 = (P3 + P4 + P14 + P21)/4 * 4 Domeni 2 = (P6 + P11 + P15 + P24 + P31)/5 *4 Domeni 3 = (P5 + P22 + P23 + P20)/4 * 4 Domeni 4 = (P27 +P26 + P25 + P17)/4*4 Domeni 5 = (P12 + P13 + P16 + P18 + P19 + P28 + P29 + P30)/8 *4 Domeni 6 = (P7 + P8 + P9+ P10)/4 *4 (Këto ekuacione llogarisin pikët e domeneve. Të gjitha pikët shumëzohen me 4, në mënyrë të tillë që të krahasohen direkt me pikët e nxjerra nga WHOQOL-100).

Instrumenti WHOQOL-BREF të jep mundësinë që procesi i mbledhjes së pikëve të domeneve të mund realizohet edhe me dorë. Për ta bërë këtë, pikët negative duhet të anulohen dhe prandaj është përdorur formula 6-x. Kjo do të sigurojë, për shembull, se në qoftë se dikush raporton "frika për të ardhmen" në një vlerë të maximale (5) zbritur rezultatin nga 6, do të rikodohet automatikisht pika në 1. Udhëzimet për këtë janë dhënë në faqe të parë të pyetësorit (shiko shtojca).

3.7.1 Procedurat e grumbullimit të të dhënave

Siç është përshkruar më parë, popullsia e studiuar përfshin personat e rritur që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri. Pjesëmarrësit janë pacientë në Klinikën Ambulatore, ku çdo muaj ata vijnë për të marrë terapinë dhe për të bërë ekzaminimet klinike. Mbledhja e të dhënave është bërë nga vetë studiuesia, pasi ajo ka një eksperiencë 8-vjeçare në këtë klinikë dhe e njeh shumë mirë fushën e HIV/AIDS-it.

Ata janë përzgjedhur ditën që kanë ardhur për të tërhequr medikamentet, është vlerësuar kartela e tyre mjekësore, janë sqaruar për qëllimin e studimit dhe është respektuar plotësisht e drejta e tyre për t'u bërë ose jo pjesë e studimit.

Për subjektet që pranuan të bëhen pjesë e studimit është marrë konsensusi pa nënshkruar një dokument (me zgjedhjen e tyre) edhe pse u prezantua formati i konsensusit. Pyetësorët janë kodifikuar në mënyrë që të ruhej konfidencialiteti.

Klinika ambulatore është një vend ku subjektet ndihen të sigurt me stafin. Pyetësorët janë realizuar në zyrën e punonjëses sociale të klinikës ambulatore. Rreth 80% e pjesëmarrësve kanë kërkuar që pyetësori të plotësohej nga studiuesia, ku ajo të lexonte pyetjen dhe ata të përgjigjeshin. Sipas tyre, kjo qe një zgjidhje më e përshtatshme dhe komode për ta.

3.8 ANALIZA STATISTIKORE

Metoda statistikore e përdorur gjatë studimit ka respektuar qëllimin dhe objektivat e vendosura gjatë disenjimit të tij. Të dhënat e marra nga pyetësori janë manipuluar sipas udhëzimeve të vendosura nga OBSH-ja.

Fillimisht kemi bërë paraqitjen e dimensionit HIV/AIDS në Shqipëri në formën e paraqitjes me harta. Hartat tregojnë fenomenin në tërësi, në paraqitjen e tij spitalore dhe ajo çfarë është arritur nëpërmjet studimit tonë. Si paraqitja tabelare dhe paraqitja me harta tregojnë që studimi ka mbuluar pothuajse të njëjtat zona me ato çfarë tregojnë hartat e mbulimit për gjithë Shqipërinë të ofruara nga ISHP-ja. Të dhënat spitalore për shpërndarjen gjeografike të fenomenit përdoren për herë të parë.

Pas kodifikimit të pyetjeve dhe agregimit të tyre në domene dhe vlerë totale të domeneve kemi marrë fillimisht në konsideratë praqitjen deskriptive të pyetjeve. Vlerat e diskutuara për çdo pyetje tregojnë vlerat minimale dhe maksimale të përgjigjeve duke mundësuar kështu përcaktimin e rangut. Për secilën pyetje është vlerësuar mesatarja dhe deviacioni standard, duke na dhënë një paraqitje të ndryshimit midis pyetjeve. Duke iu referuar literaturës, në vazhdim përgjigjet e pyetjeve janë ndarë në pyetje të konsideruara 'pozitive'

dhe 'negative'. Përgjigjet pozitive janë konsideruar kur vlerat e mesatareve të pyetjeve ishin≥ 3 (3, 4 dhe 5), ndërsa ato negativet janë konsideruar kur vlerat mesatare të pyetjeve ishin≤ 2 (1 dhe 2).

Paraqitja e të dhënave në formë të përgjithshme është treguar në tabelat që paraqesin karakteristika: 1. Demografike dhe 2. Klinike. Të gjitha këto janë realizuar duke mbajtur parasysh qëllimin që, në çdo moment, rezultatet e studimit të jenë të krahasueshme me studime të ngjashme. Në vazhdim janë përdorur tabela dhe paraqitje grafike në formë bar diagramesh, pie diagramesh dhe histogramesh për të dhënat shtesë jashtë pyetësorit, si: seksi, grupmosha, edukimi etj.

Fenomene karakteristike shqiptare, si përbërja etnike dhe statusi i emigracionit, janë paraqitur në mënyrë të veçantë. Këto fenomene janë vlerësuar në vazhdim nëpërmjet krostabulimeve, që konsistojnë në realizimin e shpërndarjes së karakteristikave, duke vlerësuar një variabël përballë një variabli tjetër. Rezultatet e konsideruara të rëndësishme dhe që kanë nevojë për investigim të mëtejshëm janë paraqitur edhe në formë bar diagramesh.

Një ndër pikat më të rëndësishme të studimit ka qenë vlerësimi i besueshmërisë së studimit. Për vlerësimin e besueshmërisë së konsistencës së brendshme të studimit është përdorur teknika e Cronbach, nëpërmjet koeficientit alfa. Kjo teknikë është masivisht e zgjedhur në të gjitha studimet e ngjashme dhe merret si një masë e besueshme për vlerësimin e besueshmërisë së konsistencës së brendshme, gjë e cila na lejon të vazhdojmë studimin më tej me vlerësimin e objektivave të përcaktuara. Konsistenca e jashtme mund të vlerësohet, por në mënyrë jo sasiore, e suksesshme duke marrë në konsideratë marrëdhëniet e zgjatura në kohë dhe të afërta të intervistuesit me të intervistuarit. Fakti i përgjigjes masive ndaj pyetësorit duke mos lënë asnjë pyetje pa përgjigje është një tregues. Kjo metodë na mundëson edhe ndërtimin e matriksit të korrelacioneve ndërmjet domeneve.

Kjo masë tregon konsistencën e një shkalle me shumë dimensione, domene. Secili prej domeneve është një shkallë e tipit Likert, të vlerësuar me pikë nga 1 në 5, ku variabli është i tipit ordinal. Nga 31 pyetjet e pyetësorit, 22 janë me vlerësim në shkallë rritëse nga 1 në 5, ndërsa 3, 4, 5, 8, 9, 10, 31 janë kodifikuar duke e përmbysur rezultatin, prandaj duhen rikodifikuar edhe një herë, meqenëse vlera më e madhe, konkretisht 5, tregon realisht vlerën më të ulët në raport me cilësinë e jetës, në ndryshim me pyetjet e tjera, ku vlera më e lartë tregon edhe gjendjen më të mirë. Ky kodifikim dhe rikodifikim është realizuar si kërkesë e pyetësorit standard dhe mënyrës së përpunimit të tij të ofruar nga OBSH-ja.

Pyetjet e konsideruara të përmbysura janë si vijon:

3. Në çfarë niveli mendoni që dhimbjet fizike të privojnë të kryeni detyra që duhet t'i kryeni?
4. Sa shumë ju bezdis fakti që keni probleme fizike që janë të lidhura drejtpërdrejt me infeksionin HIV?
5. Sa shumë keni nevojë për të përdorur ilaçe që të funksiononi më mirë në jetën tuaj të përditshme?
8. Sa mërziteni me njerëzit që ju fajësojnë juve që jeni me HIV?
9. Sa shumë ju frikëson e ardhmja?
10. Sa shumë i trembeni vdekjes?
31. Sa shpesh përjetoni ndjenja negative, rënie humori, dëshpërim, ankth, depresion?

3, 4, 5, 8, 9, 10 (p)

Koeficienti alfa është llogaritur nga korrelacionet e secilit domen me domenet e tjerë.

α Cronbach për të gjithë domenet së bashku është 0.83. Duhet sqaruar se një vlerë e α prej $0.7 \leq \alpha < 0.9$ konsiderohet si tregues shumë i mirë i konsistencës së brendshme të studimit, ku bien edhe vlerat e gjetura të studimit tonë. Vlerat ≥ 0.9 konsiderohen si të shkëlqyera, por jo efektive, gjë që tregon se studimi ka arritur vlera të larta besueshmërie, por me një çmim më të lartë, p.sh., është harxhuar në mënyrë të panevojshme: para, kohë e studiuesit dhe të intervistuarit etj. Vlera që rezulton në studimin tonë është ndër më të mirat e gjetura edhe në literaturën e botuar.

Studimi i domeneve si përmbledhje e rezultateve të studimit është bazuar në vlerësimin e tyre individual dhe krahasimin me njëri-tjetrin. Pastaj janë vlerësuar në raport me karakteristikat demografike dhe mjekësore të grupit në studim. Teknikat statistikore të zgjedhura ishin ANOVA (analiza e variancës) dhe testi i Studentit që është realizuar duke konsideruar që kemi shpërndarje normale të të dhënave, gjë që e heq kufizimin e përdorimit të këtij testi për mostra të mëdha. I njëjti fenomen haset edhe në literaturën së cilës i jemi referuar. Në fund të analizës është rubrika 'Gjetje të tjera', ku jemi përpjekur të tregojmë gjetje specifike vetëm për studimin tonë. Në një rast është përdorur Teknika e Regresionit Binomial dhe Analiza e Korrespondencës së Shumëfishtë.

3.9 ÇËSHTJET ETIKE DHE LIGJORE

Komitetet etike të kërkimit janë thelbësore për të mbrojtur të dhënat individuale të pacientëve, klientëve, si dhe të shëndetit publik (Van der Wal 2005). Çështjet etike janë të rëndësishme në kërkim dhe përfshijnë sjelljen etike kundrejt informacionit të pjesëmarrësve, si dhe raportimin e ndershëm të rezultateve. Kërkimi u miratua nga Komiteti Kombëtar i Etikës Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Spitali Semundjeve Infektive. Sipas Van der Wal (2005), kur të aplikohen parimet etike në kërkim, është e dobishme që të mbahen tri çështjet e mëposhtme. Këto janë: pjesëmarrësit, institucioni, si dhe integriteti i studiuesit. Studiuesia ka diskutuar se si më sipër u siguruan pjesëmarrësit në studim. Kërkimi është gjithmonë shqetësimi i parë i hulumtuesit (Van der Wal, 2005). Respektimi udhëzimeve të rrepta etike është edhe më e rëndësishme në këtë kërkim, sepse pjesëmarrësit janë shumë të prekshëm. PJHA-të janë të rrezikuar, së pari, sepse stigmatizimi drejton ata për këtë pozitë dhe së dyti, për shkak se ata i përmbushin të gjitha kriteret e parapara për grupet e cenueshme (Van der Wal, 2005). Këto kritere janë:

- zhvillimi ekonomik i kufizuar;
- mbrojtja e pamjaftueshme e të drejtave të njeriut;
- diskriminimin në bazë të statusit shëndetësor;
- të kuptuarit e pamjaftueshëm të kërkimit shkencor;
- disponueshmëria e kufizuar e kujdesit shëndetësor dhe trajtimit të opsioneve
- të dëmtuarit e aftësisë së individëve në komunitet për të dhënë pëlqimin e informuar.

Kodet formale, çështjet etike në kërkimet sociale janë të rëndësishme, shumica e shoqatave profesionale kanë krijuar dhe publikuar për të përshkruar se çfarë është sjellje profesionale e pranueshme dhe e papranueshme (Babbie & Mouton, 2003). Sipas Kodit Nuremberg (1949), siç citohet nga Burns dhe Grove (2005), pëlqimi i informuar do të thotë se "personi i përfshirë duhet të ketë zotësi juridike për të dhënë pëlqimin/marrëveshjen dhe i vendosur që të jetë në gjendje të ushtrojë fuqinë e lirë të zgjedhjes pa ndërhyrjen e ndonjë elementi të forcës, mashtrimit, detyrimit dhe duhet të ketë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar elemente të çështjeve në të cilat subjektet janë përfshirë, për t'u dhënë mundësinë atyre që të jenë më të qartë në vendime".

Bazuar në ato që u thanë më lart, mund të thuhet në mënyrë të sigurt se, parimi i pëlqimit të lirë dhe të informuar është një vlerë thelbësore në shëndetësi. Kjo nuk është vetëm për të dhënë leje, por është më tepër një proces

i vendimmarrjes, e cila është e ndjeshme ndaj kontekstit dhe përbëhet nga katër elemente, domethënie (1) shpalosje, (2) të kuptuarit, (3) kompetencë dhe (4) vullnetarizëm (Burns & Grove, 2005). Pjesëmarrësit për të dhënë pëlqimin morën shpjegimet e mëposhtme:

- Kërkimi, procedurat që do të ndiqen dhe qëllimi i çdo procedure.
- Rreziqet fizike, shqetësimet ose cenimi i intimitetit të pacientit, apo ndonjë kërcënim ndaj dinjitetit.
- Metodat që do të përdoren për të siguruar anonimitetin dhe konfidencialitetin.
- Detyrat që priten prej tyre, kështu që ata mund të bëjnë një zgjedhje për t'u informuar dhe për të marrë pjesë vullnetarisht në kërkim.
- Avantazhet e kërkimit të pjesëmarrësve, ose për shoqërinë.
- Lloji i të dhënave që do të mblidhen.
- Si do të zgjidhen pjesëmarrësit dhe sa do të marrin pjesë.

Për sa më sipër u shpjegua në një mënyrë joteknike, dhe që shpjegimi të ishte i plotë dhe "në nivelin intelektual të klientit" (Van der Wal, 2005). Parimi i vërtetësisë u la në fuqi, nëse e gjithë e vërteta dhe vetëm e vërteta ishte thënë për kërkimin (Van der Wal, 2005).

Autonomia do të thotë e drejta për vetëvendosje. Për këtë studim, autonomia është siguruar duke informuar pjesëmarrësit se ata kishin të drejtë në vijim:

- të tërhiqen nga studimi në çdo moment të kohës; dhe
- të refuzojnë për të dhënë ndonjë informacion.

3.10 KONFIDENCIALITETI DHE ANONIMATI

Sipas Burns dhe Grove (2005), konfidencialitet do të thotë "menaxhim nga kërkuesi i informacionit privat që subjekti i jep kërkuesit dhe mosndarjen e këtij informacioni pa autorizimin e subjektit". Konfidencialiteti i informacionit të pacientit është thelbësor për ruajtjen e një lidhje besimi në mes të pacientit, profesionistëve të shëndetit dhe mbrojtjes së të drejtave të pacientëve.

Një pikë e rëndësishme theksohet se mbajtja e konfidencialitetit është shpesh më e vështirë në kërkimin cilësor se në kërkimin sasior (Burns & Grove, 2005). Natyra e hulumtimit cilësor kërkon që "kërkuesi duhet të jetë afër mjaftueshëm për të kuptuar thellësinë e çështjes në studim dhe duhet të paraqesë citate të mjaftueshme të drejtpërdrejta dhe një përshkrim të hollësishëm për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore" (Ramos 1989, siç citohet në Burns & Grove 2005). Studiuesia e kërkimit aktual e përmbush më së miri këtë kriter për vetë eksperiencën 8 -vjeçare në fushën e HIV/AIDS.

Shkelja e fshehtësisë do të mund të dëmtonte interesat e pacientit, si dhe marrëdhëniet mes studiueses dhe pjesëmarrësve. Ajo mund të shihet si një vepër e rëndë etike, dhe mund të merren hapa disiplinore (Strauss, 1992). Në këtë kërkim, shkelje të konfidencialitetit mund ta vënë pacientin në rrezik për t'u stigmatizuar, diskriminuar dhe izoluar. AIDS është ende një sëmundje e stigmatizuar.

Privatësia, siç citohet në De Vos et al. (2005), do të thotë se "nuk ka për qëllim për të vëzhguar ose të analizuar të tjerët". Privatësia është e drejta që një individ ka për të përcaktuar kohën, shkallën dhe rrethanat e përgjithshme, në të cilat informacioni personal do të jetë i përbashkët ose jo me të tjerët (Burns & Grove, 2005). Dështimi për të siguruar jetën private mund të shkaktojë humbjen e dinjitetit, miqësisë apo të punësimit, ose mund të krijojë ndjenjat e ankthit, fajit apo turpit (Burns & Grove, 2005). Në këtë studim, privatësia e pjesëmarrësve ishte e mbrojtur nga pëlqimi informuar. Të drejtat, interesat dhe dëshirat e pjesëmarrësve ishin të siguruar në çdo kohë dhe studiuesia ka mbledhur vetëm informacionin e nevojshëm, që është informacion mbi QOL-në.

Institucionet sipas Van der Wal (2005) është e domosdoshme që të trajtohen si një person nga ana e kërkuesit. Etika që zbatohet për pjesëmarrësit individual të shërbejë edhe për institucionin. Parimet etike të diskutuara më lart në lidhje me pjesëmarrësit individual u siguruan edhe për institucionin.

3.10.1 Integriteti i studiuesit

Para se të ndërmerret një kërkim, kërkuesit duhet të sigurojnë që ata janë kompetent dhe të aftë për të ndërmarrë studimin e propozuar (De Vos et al 2005). Studimi mbi HIV dhe AIDS është temë e ndjeshme. Kështu kompetenca e hulumtuesit është shumë e rëndësishme. Studiuesia në këtë studim është udhëhequr nga parimet shkencore. Sipas Thomas (2002), kur je duke bërë kërkime mbi përvojën e jetuar të një personi që jeton me AIDS, kërkuesit duhet të zotërojnë aftësitë themelore në këshillim mbi HIV dhe AIDS. Si HIV dhe AIDS është një infeksion emotiv, studiuesi duhet të përdorë: ndjeshmërinë, besueshmërinë, ngrohtësinë, pranimin e pakushtëzuar të PJHA-së dhe vërtetësinë për të ndihmuar pjesëmarrësit që të zbulojnë përvojat e tyre.

3.11 SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT

Sipas Rrum dhe Beck (2008), nuk ka studim të plotë derisa rezultatet e tij të ndahen me të tjerët. Rezultatet duhet të bëhen të njohura, sepse ato "kontribuojnë në praktika më të mira", përveç faktit se është përgjegjësi profesionale e një studiuesi të bëjë të ditur rezultatet e një kërkimi (Rrum & Beck, 2008). Për më tepër, vlera e një studimi kërkimor kurrë nuk do të jetë e njohur plotësisht, nëse nuk bëhet i ditur (Streubert, Speziale & Marangoz, 2007). Një kopje e këtij kërkimi do t'i dorëzohet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, QSUT-së dhe grupeve të interesit.

3.12 KUFIZIMET E STUDIMIT

Gjatë procesit të realizimit të këtij kërkimi pati disa kufizime:

Së pari, nga 325persona që vijnë rregullisht në Klinikën Ambulatore, 20 prej tyre refuzuan të bëheshin pjesë e studimit dhe 10 prej pacientëve nuk u paraqitën vetë fizikisht për të marrë mjekimin dhe kontakti me ta qe i pamundur.

Së dyti, niveli arsimor i subjekteve të përfshirë në studim ishte me arsim të ulët. Edhe pse nga ana e studiueses u bë e pamundur për t'u shpjeguar me hollësi çdo pyetje që të ishte sa më e qartë, ata përsëri kishin vështirësi në të kuptuar.

Së treti, përdorimi për herë të parë i këtij instrumenti në Shqipëri, përshtatja në kontekstin gjuhësor dhe kulturor pati sfidat e veta.

Së katërti, studimet cross-sectionale nuk na lejojnë për të nxjerrë konkluzione në lidhje me drejtimin e marrëdhënieve apo shkakësisë midis QOL-së dhe karakteristikave të variablave sociodemografik dhe klinik.

Së pesti, popullsia në studim nuk ishte e rastësishme. Nga mostra e njerëzve të infektuar me HIV që jetojnë në Shqipëri, subjektet e anketuar ishin ata të cilët merrnin aktivisht kujdes mjekësor rutinë. Ata që nuk planifikojnë ose bëjnë vizita të rregullta klinike nuk janë përfshirë dhe për rrjedhojë rezultatet e këtij studimi nuk mund na paraqesin një krahasim domethënës midis subjekteve në terapi dhe atyre që nuk marrin terapi.

Së fundi, studiuesia është e punësuar si punonjëse sociale në Klinikën Ambulatore të QSUT-së. Ajo është e njohur nga gjithë subjektet në studim, kjo mbase ka ndikuar në përgjigjet e disa pyetjeve.

KAPITULLI
4 REZULTATE

4.1 PASTRIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE

Menaxhimi i pyetësorit është realizuar nga vetë studiuesia në të gjitha rastet, duke pasur në konsideratë vazhdimisht ruajtjen nga *bias* e intervistuesit. Pas hedhjes në format elektronike është realizuar rikontrolli i cilësisë së të dhënave dhe rezulton se të gjithë të intervistuarit i janë përgjigjur të gjitha pyetjeve. Meqenëse pas shpjegimit të protokollit të intervistës, ku të gjithë të intervistuarit e pranuan atë dhe ata ishin të lirë t'u përgjigjeshin pyetjeve, kontrolli i cilësisë së të dhënave u realizua pasi u përpunuan në format elektronik.

Përpunimi i bazës së të dhënave iu nënshtrua kontrollit sistemik dhe nominal. Të gjitha pyetjet ishin brenda rangut të lejuar nga standardi i pyetësorit. U vërejtën vetëm dy momente që vlejnë për diskutim, por nuk ndikojnë në rezultatet e studimit. Njëri rast është një pacient që u përgjigjet të gjitha pyetjeve me 3, ndërkohë që nuk mund të konsiderohet gabim, sepse është e drejta e tij dhe mendohet që është i qartë për përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit. Rasti tjetër është ngjashmëria në plotësimin e dy pyetësorëve, ku pacientët janë çift dhe ka mundësi që të kenë të njëjtin perceptim të situatës ku ndodhen. Të dy rastet mund të jenë subjekt studimi në të ardhmen.

4.2 KARAKTERISTIKAT EPIDEMIOLOGJIKE TË HIV/AIDS NË SHQIPËRI

Të dhënat rreth numrit të të sëmurëve me HIV/AIDS dhe shpërndarja e tyre sipas rretheve janë marrë nga ISHP-ja. Numri i përgjithshëm i të sëmurëve me HIV/AIDS në Shqipëri në vitin 2013 ishte 671 persona. Nga harta shikohet që numri më i madh i PJHA-së si në vlera absolute edhe në % gjendet në Tiranë (kjo nuk do të thotë se të gjithë këta persona e kanë vendlindjen në Tiranë, por shumica prej tyre kanë migruar në kryeqytet). Dy hartat e tjera tregojnë shpërndarjen sipas shtrimeve në shërbimet e QSU-së "Nënë Tereza" dhe sipas të dhënave të mbledhura nga studimi ynë. Shihet që tre hartat kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën. Kryeqyteti, Tirana, zona bregdetare perëndimore dhe zona verilindore e Shqipërisë janë zonat me numrin më të madh të të infektuarve me HIV/AIDS.

Dy hartat e tjera tregojnë shpërndarjen sipas shtrimeve në shërbimet e QSU "Nënë Tereza" dhe sipas të dhënave të mbledhura nga studimi ynë. Vihet re që tre hartat kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën.

Grafiku 1.4 Shpërndarja e të sëmurëve me HIV/AIDS sipas rretheve në %.



Grafiku 2.4 Shpërndarja e të sëmurëve me HIV/AIDS sipas shtrimeve në QSUT dhe studimit tonë.



Rreth 50% e rasteve gjenden në Tiranë, megjithëse Tirana (749 365 banorë) përbën 27.8% të popullatës së përgjithshme të Shqipërisë (2 800 138 banorë) sipas të dhënave të Censusit, 2011. Ndër arsyet e mundshme të përqendrimit më të lartë në kryeqytet është edhe mundësia më e madhe e marrjes së virusit si rezultat i numrit më të madh të faktorëve të riskut dhe gjithashtu ekzistenca e shërbimeve më të mira shëndetësore, që sjell edhe migrimin e pacientëve drejt kryeqytetit, ose një kombinim i tyre. Gjithsesi, kjo mbetet për t'u vlerësuar dhe nuk përbën objekt të studimit tonë.

Tabela 6.4 Shpërndarja e të sëmurëve me HIV/AIDS sipas shtrimeve në QSUT dhe studimit tonë.

Nr.	Rrethi	QSUT	QSUT%		Studimi	Studimi%
1	BERAT	5	1.2		2	1.0
2	BULQIZË	2	.5		1	.5
3	DELVINË	4	1.0		1	.5
4	DEVOLL	3	.7		3	1.5
5	DIBËR	3	.7		0	0
6	DURRËS	25	6.1		20	10.1
7	ELBASAN	23	5.6		11	5.5
8	FIER	9	2.2		3	1.5
9	GJIROKASTËR	1	.2		1	.5
10	GRAMSH	2	.5		0	0
11	HAS	2	.5		0	0
12	KAVAJË	2	.5		3	1.5
13	KOLONJË	1	.2		0	0
14	KORÇË	10	2.4		2	1.0
15	KOSOVË	0	.0		1	.5
16	KRUJË	8	1.9		2	1.0
17	KUÇOVË	1	.2		2	1.0
18	KUKËS	5	1.2		2	1.0
19	KURBIN	10	2.4		7	3.5
20	LEZHË	6	1.5		5	2.5
21	LIBRAZHD	2	.5		2	1.0
22	LUSHNJË	15	3.6		9	4.5
23	MALËSI E MADHE	1	.2		0	0
24	MALLAKASTËR	0	0.0		0	0
25	MAT	1	.2		3	1.5
26	MIRDITË	6	1.5		1	.5
27	PEQIN	2	.5		1	.5
28	PËRMET	2	.5		0	0
29	POGRADEC	4	1.0		5	2.5
30	PUKË	0	.0		0	0
31	SARANDË	10	2.4		4	2.0
32	SHKODËR	12	2.9		6	3.0
33	SHTETE TË TJERA	0	.0		1	.5
34	SKRAPAR	0	.0		0	0
35	TEPELENË	0	.0		0	0
36	TIRANË	210	51.1		93	46.7
37	TROPOJË	3	.7		0	0
38	VLORË	21	5.1		8	4.0
	Total	411	100.0		199	100.0

Në lidhje me situatën epidemiologjike dhe shpërndarjen e të sëmurëve me HIV/AIDS është përdorur ndarja administrative me 36 rrethe, meqenëse edhe mënyra e raportimit në strukturat shëndetësore vazhdon të bëhet sipas kësaj ndarje. Tabela 6.4 na njeh me këtë shpërndarje.

4.2.1 Aktiviteti klinik në lidhje me HIV/AIDS

Nga 670 shtrime, gjatë periudhës 2005-2013, duhet konsideruar numri i rishtrimeve. Pas heqjes së rishtrimeve figuron që numri i shtrimeve me HIV/AIDS në QSUT është 411 gjatë një periudhe 9-vjeçare. Vihet re prezenca e diagnozës në moshat pediatrike dhe se grup-mosha më e prekur është 35-44 vjeç. Raporti meshkuj-femra ruhet si në popullatën e shtrimeve dhe në studimin tonë. DQM është 13.6 ditë dhe konfirmon shtrimet për arsye të komplikacioneve.

Tabela 7.4 Shtrimet e të sëmurëve me HIV/AIDS, QSUT, 2005-2013.

Diagnoza	Nr_i_Nom.	Seksi	Gjithsej	0_1_vjeç	1_4_vjeç	5_14_vjeç	15_24_vjeç	25_34_vjeç	35_44_vjeç	45_54_vjeç	55_64_vjeç	65_e_larte_vjeç	Dite_qendrimi_total	Numri_i_vdekjeve	Dite_Qendrimi_Mesatar
Infeksione H.I.V. (SIDA)	042	M	479	3	8	10	20	104	165	113	38	18	6627	20	13.8
		F	191	3	5	3	23	47	51	29	24	6	2507	9	13.1
		T	**670**	**6**	**13**	**13**	**43**	**151**	**216**	**142**	**62**	**24**	**9134**	**29**	**13.6**

Grafiku 3.4 Shtrimet e të sëmurëve me HIV/AIDS, QSUT, 2005-2013.



4.2.2 Të dhëna të përgjithshme të mostrës në studim

Në studim kanë marrë pjesë 199 pacientë: 71 femra (36.7%) dhe 128 meshkuj (64.3%) të paraqitur në mënyrë konsekutive pranë Klinikës Ambulatore, Spitali Sëmundjeve Infektive.

Mosha mesatare e pacientëve të paraqitur është 39.9 ± 10.7 vjeç. Mosha e pacienteve të paraqitura femra është 36.9 ± 9.0 vjeç. Mosha e pacientëve të paraqitur meshkuj është 41.5 ± 11.3 vjeç.

Grafiku 4.4 na tregon se fenomeni tek femrat haset në moshë më të re se tek meshkujt.

Grafiku 4.4 Shpërndarja e moshës sipas gjinisë.



Grafiku 5.4 tregon se mosha e popullatës së femrave në studim është më e mbledhur krahasuar me meshkujt, ku mosha e tyre është më e shpërndarë. Vihet re se në popullatën e meshkujve mosha varion nga më e hershme 14 vjeç deri në 80 vjeç.

Grafiku 5.4 Piramida e popullatës së studimit sipas moshës dhe gjinisë.



4.2. 3 Karakteristikat individuale të kampionimit

Subjektet e përfshira në kampionin e studimit kanë karkteristika të ndryshme sociodemografike. Në tabelën 8.4 është paraqitur një përmbledhje e karakteristikave individuale të pjesëmarrësve. Pjesa më e madhe e subjekteve janë midis 35-44 vjeç (34.2%) me një moshë mesatare 39.8 (DS=10.7) dhe 63.8 % e pjsëmarrësve janë të martuar dhe jetojnë bashkë. Më shumë se gjysma e subjekteve kanë arsim 8-vjeçar (50.3%) dhe vetëm 13.6% e tyre kanë arsim të lartë. Rreth 72.4% e tyre janë jo çift në studim. Nga subjektet në studim, 88.9% e tyre i përkasin etnisë shqiptare, 59.3% e tyre nuk kanë qenë asnjëherë emigrantë dhe 43.2% e tyre janë të papunë. Afërsisht 47.6 % e subjekteve jetojnë në Tiranë, por nuk kanë lindur në Tiranë.

Tabela 8.4 Karakteristikat individuale të të intervistuarve.

Variabli	N	%	M	DS
Mosha			**39.8**	**10.7**
16-24 vjeç	9	4.5		
25-34 vjeç	59	29.6		
35-44 vjeç	68	34.2		
45-54 vjeç	46	23.1		
55-64 vjeç	13	6.5		
> 65 vjeç	4	2		
Gjendja civile				
Beqar	50	25.1		
I divorcuar	7	3.5		
I martuar	127	63.8		
I ve	11	5.5		
Jeton si i martuar	4	2		
Arsimi				
8-vjeçare	100	50.3		
I lartë	27	13.6		
I mesëm	64	32.2		
Fillor	8	4		
Çift				
Jo	144	72.4		
Po	55	27.6		
Etnia				
Shqiptarë	177	88.9		
Romë	22	11.1		
Emigracioni				
> se 1	4	2		
Angli	2	1		
Greqi	52	26.1		
Itali	21	10.6		
Jo	118	59.3		
Maqedoni	1	0.5		
USA	1	0.5		
Punon				
Po	113	56.8		
Jo	86	43.2		

4.2.4 Paraqitja grafike e karakteristikave të përgjithshme

Grafiku 6.4 Shpërndarja sipas gjinisë

Grafiku 7.4 Shpërndarja sipas etnisë



Grafiku 8.4 Pacientë çift brenda studimit

Grafiku 9.4 Statusi emigrimit gjatë jetës

Grafiku 10.4 Shpërndarja sipas arsimit



Grafiku 11.4 Shteti ku ka emigruar



Grafiku 12.4 Shpërndarja sipas gjendjes civile.



Grafikët më sipër tregojnë në mënyrë të përmbledhur gjetjet e studimit, duke u bazuar në karakteristikat individuale të kampionimit.

4.2.5 Karakteristikat klinike të të intervistuarve

Në tabelën 9.4 paraqitet një përmbledhje e karakteristikave klinike të pjesëmarrësve. Rreth 37.7% e tyre e perceptojnë shëndetin si të mirë. Më shumë se gjysma e subjekteve e konsiderojnë veten e tyre të sëmurë (59.8%). Tetëdhjetë e katër pikë gjashtë për qind e subjekteve (84.6%) shprehen se nuk e dinë statusin e tyre HIV. Rreth 39.7% e tyre deklarojnë se janë testuar midis vitit 2005-2009 me një mesatare 2009.78 (DS 3.31) dhe 60.3% midis viteve 2010-2015. Shtatëdhjetë e një pikë nëntë për qind (71.9%) e subjekteve deklaruan se nuk e dinin se kur ishin infektuar dhe 12.6% e tyre pohuan se ishin infektuar midis viteve 2007-2012 me një mesatare 2004,98 (DS 5.2). Rruga e infektimit mbizotëron ajo seksuale, 73 (36.7%) janë meshkuj të infektuar nga femrat dhe 64 (32.2%) femra të infektuara nga meshkujt. Nga këta, 52 (26.1%) deklarojnë se nuk janë të sigurt për rrugën e infektimit. Rreth 88.9% e subjekteve në studim marrin terapi dhe kanë mesatarisht mbi 1.5 vite nën TAR.

Tabela 9.4 Karakteristika klinike të të intervistuarve.

Si është shëndeti juaj?	N	%	M	DS
Shumë keq	11	5.5		
Keq	9	4.5		
As mirë, as keq	64	32.2		
Mirë	75	37.7		
Shumë mirë	40	20.1		
A e konsideron veten të sëmurë?				
Jo	80	40.2		
Po	119	59.8		
Serostatus				
Asimptomatik	6	3.0		
I konvertuar në AIDS	19	9.5		
Nuk e di	172	86.4		
Simptomatik	2	1.0		
Viti i testimit			2009.78	3.31
1997-2004	15	7.5		
2005-2009	79	39.7		
2010-2015	120	60.3		
Viti i infektimit			2004.98	5.2
1995-2000	14	7		
2001-2006	17	8.5		
2007-2012	25	12.6		
Nuk e di	143	71.9		
Rruga e infektimit				
Përdorim i drogës	2	1.0		
Produkte gjaku	8	4.0		
Seks me burrë	73	36.7		
Seks me grua	64	32.2		
Tjetër	52	26.1		
Merr TAR				
Jo	22	11.1		
Po	177	88.9		

4.3 PARAQITJA GRAFIKE DHE TABELARE E VARIABLAVE SOCIODEMOGRAFIK MIDIS DY GJINIVE NË STUDIM

Në tabelën 10.4 dhe grafikun 13.4 pasqyrohen të dhënat se brenda studimit, 15.5% e femrave dhe 12.5% e meshkujve janë me arsim të lartë dhë në të dyja gjinitë (49.3% f, 50.8% m) mbizotëron arsimi 8-vjeçar. Referuar INSTAT që, pas vitit 2005, numri i femrave me arsim të lartë ka një rritje të ndjeshme në popullatën Shqiptare.

Tabela 10.4 Shpërndarja e arsimit sipas gjinisë.

			Arsimi				Totali
			8-vjeçare	i lartë	i mesëm	fillor	
Gjinia	F		35	11	20	5	71
		% brenda Gjinia	49.3%	15.5%	28.2%	7.0%	100.0%
	M		65	16	44	3	128
		% brenda Gjinia	50.8%	12.5%	34.4%	2.3%	100.0%
Totali			100	27	64	8	199
		% brenda Gjinia	50.3%	13.6%	32.2%	4.0%	100.0%

Grafiku 13.4 Shpërndarja e arsimit sipas gjinisë.



Tabela 11.4 dhe grafiku 14.4 pasqyrojnë se 43.7% e femrave në studim janë çift, vlerë që vërteton se meshkujt janë vektor i përhapjes së virusit HIV e lidhur kjo me 81.3% e meshkujve që në studim nuk kanë marrë pjesë çift, por kjo nuk përjashton faktin se jashtë studimit ata mund të mos jenë çift. Përqindja në rritje e femrave HIV-pozitive, si dhe investigimi epidemiologjik i rasteve të reja të

diagnostikuar me HIV (ISHP), japin të dhëna për transmetimin e infeksionit HIV në vend. Kjo përfaqëson një moment që meriton vëmendje po t'i kthehemi analizës se, deri para pak viteve është folur për një epidemi të "importuar" (OBSH, Shqipëri, 2004) (shpjegim më i gjerë në kapitullin 5).

Tabela 11.4 Shpërndarja çift brenda studimit sipas gjinisë.

			Çift		Totali
			Jo	Po	
Gjinia	F		40	31	71
		% brenda Gjinia	56.3%	43.7%	100.0%
	M		104	24	128
		% brenda Gjinia	81.3%	18.8%	100.0%
Totali			144	55	199
		% brenda Gjinia	72.4%	27.6%	100.0%

Grafiku 14.4 Shpërndarja çift brenda studimit sipas gjinisë.

Në tabelën 12.4 dhe grafikun 15.4 pasqyrohet shpërndarja e grup-moshave sipas gjinisë. Për femrat, grup-mosha 25-34 përbën 39.4%, ndërsa për meshkujt mbizotëron grup-mosha 35-34 vjeç me 33.8%.

Tabela 12.4 Shpërndarja e grup-moshave sipas gjinisë.

			Grup-mosha						Totali
			16-24 vjeç	25-34 vjeç	35-44 vjeç	45-54 vjeç	55-64 vjeç	> 65 vjeç	
Gjinia	F		3	28	24	15	0	1	71
		% brenda Gjinia	4.2%	39.4%	33.8%	21.1%	0.0%	1.4%	100.0%
	M		6	31	44	31	13	3	128
		% brenda Gjinia	4.7%	24.2%	34.4%	24.2%	10.2%	2.3%	100.0%
Totali			9	59	68	46	13	4	199
		% brenda Gjinia	4.5%	29.6%	34.2%	23.1%	6.5%	2.0%	100.0%

Grafiku 15.4 Shpërndarja e grup-moshave sipas gjinisë.



Në tabelën 13.4 dhe grafikun 16.4 paraqiten rezultatet për sa i përket emigracionit sipas gjinisë, 59.4% e meshkujve kanë qenë emigrantë dhe vetëm 8.5% e femrave kanë qenë të tillë. Edhe sipas INSTAT, meshkujt kanë emigruar më shumë se femrat në popullatën e përgjithshme shqiptare (52.6% m/47.4%f). Kjo e dhënë justifikon dhe gjetjet më sipër në tabelën 11.4.

Tabela 13.4 Statusi i emigracionit sipas gjinisë.

			Emigrant		Totali
			Jo	Po	
Gjinia	F		65	6	71
		% brenda Gjinia	91.5%	8.5%	100.0%
	M		52	76	128
		% brenda Gjinia	40.6%	59.4%	100.0%
Totali			117	82	199
		% brenda Gjinia	58.8%	41.2%	100.0%

Grafiku 16.4 Statusi i emigracionit sipas gjinisë.



Në tabelën 14.4 dhe grafikun 17.4 pasqyrohet se sa nga çiftet (m/f) në studim i kanë partnerët respektiv HIV pozitiv ose HIV negativ. Rezulton se 70.4% e femrave i kanë partnerët HIV pozitiv dhe vetëm 8.5% e tyre janë vetë HIV pozitiv, ndërsa partnerët janë HIV negativ. Për sa u përket meshkujve, vlera e gjetur si në rastin kur partnerja është HIV pozitiv dhe kur është HIV negativ është 29.7%. Këto gjetje vërtetojnë se, në popullatën shqiptare janë meshkujt ata që përhapin infeksionin HIV, e lidhur kjo dhe me emigracionin (tabela 8, grafiku 16).

Tabela 14.4 Partneri HIV pozitiv sipas gjinisë.

		Partneri hiv +				Totali
		Jo	Nuk ka	Pa testuar	Po	
F		6	10	5	50	71
	% brenda Gjinia	8.5%	14.1%	7.0%	70.4%	100.0%
M		38	32	20	38	128
	% brenda Gjinia	29.7%	25.0%	15.6%	29.7%	100.0%
		44	42	25	88	199
	% brenda Gjinia	22.1%	21.1%	12.6%	44.2%	100.0%

Grafiku 17.4 Partneri HIV pozitiv sipas gjinisë.



Më poshtë, në tabelën 15.4 dhe grafikun 18.4 pasqyrohet se sa prej subjekteve trajtohen me terapi antiretrovirale. Sipas statusit gjinor, 88.7% janë femra dhe 89.1% janë meshkuj. Nuk vihen re dallime gjinore në trajtimin e PJHA-së me TAR.

Tabela 15.4 Merr TAR sipas gjinisë.

			TAR		Totali
			Jo	Po	
Gjinia	F		8	63	71
		% brenda Gjinia	11.3%	88.7%	100.0%
	M		14	114	128
		% brenda Gjinia	10.9%	89.1%	100.0%
Totali			22	177	199
		% brenda Gjinia	11.1%	88.9%	100.0%

Grafiku 18.4 Merr TAR sipas gjinisë.



Tabela 16.4 dhe grafiku 19.4 tregojnë se 8.5 % e femrave e kanë ndërprerë një herë terapinë për arsye subjektive (mungesa e tolerancës ndaj mjekimit, frika e identifikimit si HIV+ nga të tjerët, presioni i bashkëshortëve për të shmangur ekspozimin në spital) dhe 10.2% e meshkujve (refuzimi i mjekimit, mospranimi i statusit si i sëmurë, mostolerimi i efekteve të ilaçeve).

Tabela 16.4 Ka ndërprerë TAR-in sipas gjinisë.

			A ka ndërprerë TAR?			Totali
				Jo	Po	
Gjinia	F		8	57	6	71
		% brenda Gjinia	11.3%	80.3%	8.5%	100.0%
	M		14	101	13	128
		% brenda Gjinia	10.9%	78.9%	10.2%	100.0%
Totali			22	158	19	199
		% brenda Gjinia	11.1%	79.4%	9.5%	100.0%

Grafiku 19.4 Ka ndërprerë TAR-in sipas gjinisë.



Tabela 17.4 dhe grafiku 20.4 tregojnë se 2.8% e femrave dhe 3.9% e meshkujve e kanë ndarë këtë informacion me njerëz të besuar jashtë familjes (mik, i afërm) kjo sepse ata kanë frikë nga stigma dhe qëndrimi që do të mbajnë të tjerët ndaj tyre. Ndërsa në total 96.5% e tyre nuk e kanë bërë të ditur statusin HIV pozitiv.

Tabela 17.4 Ka treguar statusin sipas gjinisë.

		A e ka treguar ose jo statusin HIV+(përveç burrit/gruas apo prindërve)		Totali
		Jo	po	
Gjinia	F	69	2	71
	% brenda Gjinia	97.2%	2.8%	100.0%
	M	123	5	128
	% brenda Gjinia	96.1%	3.9%	100.0%
Totali		192	7	199
	% brenda Gjinia	96.5%	3.5%	100.0%

Grafiku 20.4 Ka treguar statusin sipas gjinisë.



Tabela 18.4 dhe grafiku 21.4 na tregojnë se 63.8% (66.2% f/62.5%) e subjekteve në total, meshkuj dhe femra në studim, janë të martuar dhe janë HIV pozitiv. Ky rezultat tregon se sa e rrezikuar është shoqëria shqiptare nga rritja e numrit të familjeve që jetojnë me HIV/AIDS dhe problemet e shumta me të cilat ajo do ballafaqohet në të ardhmen.

Tabela 18.4 Gjendja civile sipas gjinisë.

			Gj.Civile					Totali
			Beqar	I divorcuar	I martuar	I ve	Jeton si i martuar	
Gjinia	F		14	1	47	7	2	71
		% brenda Gjinia	19.7%	1.4%	66.2%	9.9%	2.8%	100.0%
	M		36	6	80	4	2	128
		% brenda Gjinia	28.1%	4.7%	62.5%	3.1%	1.6%	100.0%
Totali			50	7	127	11	4	199
		% brenda Gjinia	25.1%	3.5%	63.8%	5.5%	2.0%	100.0%

Grafiku 21.4 Gjendja civile sipas gjinisë.



Ashtu siç dhe pritej, numri i femrave që punojnë është 46.5% krahasuar me meshkujt 62.5% në studimin aktual. Këto gjetje përkojnë edhe me të dhënat e INSTAT (2013) në popullatën e përgjithshme, ku 63.2% e meshkujve dhe 49.5% e femrave punojnë. Këto të dhëna paraqiten në tabelën 19.4 dhe grafikun 22.4.

Tabela 19.4 Statusi i punësimit sipas gjinisë.

			Punon		Totali
			Jo	Po	
Gjinia	F		38	33	71
		% brenda Gjinia	53.5%	46.5%	100.0%
	M		48	80	128
		% brenda Gjinia	37.5%	62.5%	100.0%
Totali			86	113	199
		% brenda Gjinia	43.2%	56.8%	100.0%

Grafiku 22.4 Statusi i punësimit sipas gjinisë.



Në tabelën 20.4 dhe grafikun 23.4 jepen rezultatet mbi perceptimin e shëndetit nga vetë subjektet në studim. Në total, 75 (37.7%) e perceptojnë shëndetin si të mirë, ku 27 (38.0%) janë femra dhe 48 (37.5%) janë meshkuj, por e konsiderojnë veten të sëmurë.

Tabela 20.4 Statusi i gjendjes shëndetësore sipas gjinisë.

		Si eshte Shëndeti juaj?						Totali
			1	2	3	4	5	
Gjinia	F		3	4	24	27	13	71
		% brenda Gjinia	4.2%	5.6%	33.8%	38.0%	18.3%	100.0%
	M		8	5	40	48	27	128
		% brenda Gjinia	6.3%	3.9%	31.3%	37.5%	21.1%	100.0%
Totali			11	9	64	75	40	199
		% brenda Gjinia	5.5%	4.5%	32.2%	37.7%	20.1%	100.0%

Grafiku 23.4 Statusi i gjendjes shëndetësore sipas gjinisë.



Pasqyrimi i rezultateve në tabelën 21.4 dhe grafikun 24.4 na tregon ndryshimet në nivel arsimor, sipas etnisë në subjektet në studim. Këto ndryshime janë të pritshme midis dy etnive. Pjesëmarrësit që i përkasin etnisë Shqiptare përbëjnë 14.7% të kampionit me arsim të lartë dhe 1.7% me arsim fillor, ndërsa në etninë Rome 4.5% janë me arsim të lartë dhe 22.7 % me arsim fillor. Sipas censusit (INSTAT, 2011), vetëm 7% e romëve kanë arritur të arsimohen dhe 51% e tyre mbi 18 vjeç deklarohen analfabet.

Tabela 21.4 Arsimi sipas etnisë.

			Arsimi				Totali
			8-vjeçare	I lartë	I mesëm	Fillor	
Etnia	Shqiptare		88	26	60	3	177
		% brenda Etnia	49.7%	14.7%	33.9%	1.7%	100.0%
	Rome		12	1	4	5	22
		% brenda Etnia	54.5%	4.5%	18.2%	22.7%	100.0%
Totali			100	27	64	8	199
		% brenda Etnia	50.3%	13.6%	32.2%	4.0%	100.0%

Grafiku 24. Arsimi sipas etnisë.



Tabela 22.4 dhe grafiku 25.4 na tregojnë se kemi të njëjtin problem me familjen, ashtu si etnia Shqiptare. Rezultatet na tregojnë 31.8% e etnisë Rome ka qenë çift në studim krahasuar me 27.1% e etnisë shqiptare. Në kulturën Rome, vajzat martohen në moshën 13-15 vjeç, ndërsa meshkujt 16-17 vjeç (INSTAT, Census, 2011).

Tabela 22.4 Çift sipas etnisë.

			Çift		Totali
			Jo	Po	
Etnia	Shqiptare		129	48	177
		% brenda Etnia	72.9%	27.1%	100.0%
	Rome		15	7	22
		% brenda Etnia	68.2%	31.8%	100.0%
Totali			144	55	199
		% brenda Etnia	72.4%	27.6%	100.0%

Grafiku 25.4 Çift sipas etnisë.



Në tabelën 23.4 dhe grafikun 26.4 pasqyrohet ndarja e gjinisë sipas etnisë. Etnisë Shqiptare në studim i përkasin 35.6% femra dhe 64.4% meshkuj, ndërsa etnisë Rome 36.4% femra dhe 63.6% meshkuj.

Tabela 23.4 Gjinia sipas etnisë.

			Gjinia		Totali
			F	M	
Etnia	Shqiptare		63	114	177
		% brenda Etnia	35.6%	64.4%	100.0%
	Rome		8	14	22
		% brenda Etnia	36.4%	63.6%	100.0%
Totali			71	128	199
		% brenda Etnia	35.7%	64.3%	100.0%

Grafiku 26.4 Gjinia sipas etnisë.



Në tabelën 24.4, në subjektet me etni Shqiptare kemi një përfaqësi të gup-moshës 16-24 vjeç (5.1%), që përbën popullatën me HIV/AIDS, ndërsa etnia Rome përbën 0.0% të kësaj popullate. Kjo gjetje bie në kundërshtim me pritshmëritë e fillimit të studimit, duke menduar se Romët e fillojnë aktivitetin seksual në moshë më të hershme dhe do ishin më të përfaqësuar në këtë gup. Por, kjo e dhënë për këtë grup-moshë është e ngjashme me rezultatin e studimit të realizuar nga ISOP-ja (2008). Në etninë Rome, grup-mosha 35-44 vjeç përbën 45.5%, ndërsa në etninë Shqiptare përbën 32.8% të popullatës në studim.

Tabela 24.4 Grup-mosha sipas etnisë.

		Grup-mosha							Totali
			16-24 vjeç	25-34 vjeç	35-44 vjeç	45-54 vjeç	55-64 vjeç	> 65 vjeç	
Etnia	Shqiptare		9	52	58	43	12	3	177
		% brenda Etnia	5.1%	29.4%	32.8%	24.3%	6.8%	1.7%	100.0%
	Rome		0	7	10	3	1	1	22
		% brenda Etnia	0.0%	31.8%	45.5%	13.6%	4.5%	4.5%	100.0%
Totali			9	59	68	46	13	4	199
		% brenda Etnia	4.5%	29.6%	34.2%	23.1%	6.5%	2.0%	100.0%

Grafiku 27.4 Grup-mosha sipas etnisë.



Në tabelën 25.4 dhe grafikun 28.4 pasqyrohet statusi i emigracionit sipas etnisë, 72 ose 40.7% e pjesëmarrësve që i përkasin etnisë Shqiptare dhe 10 ose 45.5% e pjesëmarrësve që i përkasin etnisë Rome kanë qenë emigrantë.

Tabela 25. Statusi i emigracionit sipas etnisë.

		Emigrant		Totali
		Jo	Po	
Etnia	Shqiptare	105	72	177
	% brenda Etnia	59.3%	40.7%	100.0%
	Rome	12	10	22
	% brenda Etnia	54.5%	45.5%	100.0%
Totali		117	82	199
	% brenda Etnia	58.8%	41.2%	100.0%

Grafiku 28.4 Statusi i emigracionit sipas etnisë.



Tabela 26.4 dhe grafiku 29.4 pasqyrojnë shpërndarjen e partnerëve HIV pozitiv sipas dy etnive në studim. Në etninë Shqiptare 78 (44.1%) e subjekteve në studim kanë partnerin/en HIV pozitiv dhe në etninë Rome 10 (45.5%) kanë partnerin/en HIV pozitiv.

Tabela 26.4 Partneri HIV + sipas etnisë.

		Partneri HIV +				Totali
		Jo	nuk ka	pa testuar	Po	
Etnia	Shqiptare	40	37	22	78	177
	% brenda Etnia	22.6%	20.9%	12.4%	44.1%	100.0%
	Rome	4	5	3	10	22
	% brenda Etnia	18.2%	22.7%	13.6%	45.5%	100.0%
Totali		44	42	25	88	199
	% brenda Etnia	22.1%	21.1%	12.6%	44.2%	100.0%

Grafiku 29.4 Partneri HIV + sipas etnisë.



Në tabelën 27.4 dhe grafikun 30.4 pasqyrohet aksesi ndaj terapisë me ARV sipas etnisë në studim. Në studim, 156 (88.1%) e pjesëmarrësve që i përkasin etnisë Shqiptare marrin TAR dhe 21(95.5%) e subjekteve që i përkasin etnisë Rome marrin TAR.

Tabela 27.4 Merr TAR sipas etnisë.

			Merr TAR		Totali
			Jo	Po	
Etnia	Shqiptare		21	156	177
		% brenda Etnia	11.9%	88.1%	100.0%
	Rome		1	21	22
		% brenda Etnia	4.5%	95.5%	100.0%
Totali			22	177	199
		% brenda Etnia	11.1%	88.9%	100.0%

Grafiku 30.4 Merr TAR sipas etnisë.



Tabela 28.4 dhe grafiku 31.4 pasqyrojnë sa prej subjekteve në studim, sipas etnive përkatëse, kanë ndërprerë TAR-in. Subjektet që i përkasin etnisë Shqiptare 142 (80.2%) e kanë ndërprerë TAR-in të paktën një herë, ndërsa subjektet që i përkasin etnisë Rome 16 (72.2%) e kanë ndërprerë të paktën një herë terapinë.

Tabela 28.4 Ka ndërprerë TAR-in të paktën një herë sipas etnisë.

			A ka ndërprerë TAR?		Totali	
			Jo	Po		
Etnia	Shqiptare		21	142	14	177
		% brenda Etnia	11.9%	80.2%	7.9%	100.0%
	Rome		1	16	5	22
		% brenda Etnia	4.5%	72.7%	22.7%	100.0%
Totali			22	158	19	199
		% brenda Etnia	11.1%	79.4%	9.5%	100.0%

Grafiku 31.4 Ka ndërprerë TAR-in sipas etnisë.



Tabela 29.4 dhe grafiku 32.4 pasqyrojnë sa prej subjekteve në studim, që i përkasin dy etnive, e kanë treguar statusin HIV pozitiv jashtë familjes. Në subjektet që i përkasin etnisë Shqiptare, 174 (98.3%) dhe 18 (81.8%) nuk e kanë ndarë këtë informacion me të tjerët.

Tabela 29.4 Ka treguar statusin sipas etnisë.

		A e ka treguar ose jo statusin HIV+ (jashtë familjes)		
		Jo	Po	
Etnia	Shqiptare	174	3	177
	% brenda Etnia	98.3%	1.7%	100.0%
	Rome	18	4	22
	% brenda Etnia	81.8%	18.2%	100.0%
Totali		192	7	199
	% brenda Etnia	96.5%	3.5%	100.0%

Grafiku 32.4 Ka treguar statusin sipas etnisë.



Tabela 30.4 dhe grafiku 33.4, ashtu siç dhe pritej në raport me punësimin, përqindja e subjekteve që i përkasin etnisë Shqiptare që punon është 57.6% krahasuar me atë Rome, që është 50.0%. Kjo gjetje mbështetet dhe nga të dhënat e censusit (INSTAT, 2011), ku 74% e romëve deklarohen të papunë. Kjo lidhet me shumë faktorë socialë, ekonomikë, politikë e kulturorë.

Tabela 30.4 Statusi i punësimi sipas etnisë.

			Punon		Totali
			Jo	Po	
Etnia	Shqiptare		75	102	177
		% brenda Etnia	42.4%	57.6%	100.0%
	Rome		11	11	22
		% brenda Etnia	50.0%	50.0%	100.0%
Totali			86	113	199
		% brenda Etnia	43.2%	56.8%	100.0%

Grafiku 33.4 Statusi i punësimi sipas etnisë.



Tabela 31.4 dhe grafiku 34.4 pasqyrojnë gjendjen civile të subjekteve në studim sipas etnisë. Të martuarit përbëjnë 114 (64.4%) të etnisë shqiptare dhe 13 (59.1%) të etnisë rome, ndërsa subjektet me status beqar përbëjnë 44 (24.9%) të etnisë shqiptare dhe 6 (27.3%) të etnisë rome.

Tabela 31.4 Gjendja civile sipas etnisë.

		Gj. civile					Totali
		Beqar	I divorcuar	I martuar	I ve	Jeton si i martuar	
Etnia	Shqiptare	44	6	114	10	3	177
	% brenda Etnia	24.9%	3.4%	64.4%	5.6%	1.7%	100.0%
	Rome	6	1	13	1	1	22
	% brenda Etnia	27.3%	4.5%	59.1%	4.5%	4.5%	100.0%
Totali		50	7	127	11	4	199
	% brenda Etnia	25.1%	3.5%	63.8%	5.5%	2.0%	100.0%

Grafiku 34.4 Gjendja civile sipas etnisë.



Tabela 32.4 dhe grafiku 35.4 pasqyrojnë perceptimin e shëndetit të subjekteve sipas etnisë në studim. Shëndeti perceptohet si "mirë" nga 66 (37.3%) e pjesëmarrësve të etnisë shqiptare dhe 9 (40.9%) e pjesëmarrësve të etnisë rome.

Tabela 32.4 Gjendja shëndetësore sipas etnisë.

		Si është shëndeti juaj?				Totali	
		1	2	3	4	5	
Etnia	Shqiptare	10	7	58	66	36	177
	% brenda Etnia	5.6%	4.0%	32.8%	37.3%	20.3%	100.0%
	Rome	1	2	6	9	4	22
	% brenda Etnia	4.5%	9.1%	27.3%	40.9%	18.2%	100.0%
Totali		11	9	64	75	40	199
	% brenda Etnia	5.5%	4.5%	32.2%	37.7%	20.1%	100.0%

Grafiku 35.4 Gjendja shëndetësore sipas etnisë.



Në tabelën 33.4 tregohen vlerat mbi përgjigjet subjektive për perceptimin e shëndetit sipas femrave dhe meshkujve në studim, ku 1 është vlera minimale dhe 5 është vlera maksimale. Rezulton se 52.8% e femra dhe meshkujve janë përgjigjur me 3 (as mirë, as keq), 7.00% e femrave dhe 9.40% e meshkujve janë përgjigjur me 1 (shumë keq), 8.50% e femrave dhe 8.60% e meshkujve janë përgjigjur me 5(shumë mirë).

Tabela 33.4 Perceptimi i shëndetit sipas gjinisë.

			Gjinia		Totali
			F	M	
P1	1		5	12	17
		% gjinia	7.00%	9.40%	8.50%
	2		4	16	20
		% gjinia	5.60%	12.50%	10.10%
	3		41	64	105
		% gjinia	57.70%	50.00%	52.80%
	4		15	25	40
		% gjinia	21.10%	19.50%	20.10%
	5		6	11	17
		% gjinia	8.50%	8.60%	8.50%
Total			71	128	199
		% gjinia	100.00%	100.00%	100.00%

4.4 REZULTATET E PYETJEVE

Të gjitha pyetjet e pyetësorit janë analizuar duke vlerësuar mesataren, deviacionin standard dhe vlerat maksimale e minimale. Për të gjitha pyetjet, rangu i vlerave të përgjigjeve është 4. Janë veçuar pyetjet, ku mesatarja është konsideruar e zhvendosur në raport me pyetjet e tjera, ose > 4 ose < 2.5. P.3 (4.1), P.4 (3.9), P.5 (4.5), P.8 (4.3), P.9 (4.2), P.10 (4.3), P.18 (2.3), P.19 (2.1).

Duhet të kemi parasysh gjatë analizimit të tyre që, për pyetjet P.3, P.4, P.5, P.8, P.9 dhe P.10 vlerat e larta kanë konotacione negative meqenëse janë të kodifikuara në mënyrë të tillë. Pyetjet nuk janë vlerësuar sipas gjinisë apo variablave të tjerë në studim. Një gjë e tillë është bërë në rastin e studimit të domeneve meqenëse konsiderohen si përfaqësuese të vërteta të vlerësimit të cilësisë së jetës të pacientëve.

Tabela 34.4 Përmbledhje e përgjigjeve të pyetësorit.

	Të vlefsheme	Humbur	Mesatare	Dev. STD	Minimum	Maximum
1.Si mund ta vlerësoni cilësinë tuaj të jetës?	199	0	3.1	1.0	1	5
2.Sa të kënaqur jeni me shëndetin tuaj?	199	0	3.2	1.0	1	5
3. Në çfarë niveli mendoni që dhimbjet fizike ju privojnë të kryeni detyra që duhet t'i kryeni?	199	0	**4.1**	1.2	1	5
4. Sa shumë ju bezdis fakti që keni probleme fizike që janë të lidhura drejtpërdrejt me infeksionin HIV?	199	0	**3.9**	1.3	1	5
5. Sa shumë keni nevojë për të përdorur ilaçe që të funksiononi më mirë në jetën tuaj të përditshme?	199	0	**4.5**	1.0	1	5
6. Sa shumë i gëzoheni jetës?	199	0	3.0	1.1	1	5
7. Sa kuptim ka jeta juaj?	199	0	3.1	1.2	1	5
8. Sa mërziteni me njerëzit që ju fajësojnë ju që jeni me HIV?	199	0	**4.3**	1.2	1	5
9. Sa shumë ju frikëson e ardhmja?	199	0	**4.2**	1.2	1	5
10. Sa shumë i trembeni vdekjes?	199	0	**4.3**	1.2	1	5
11. Sa mirë jeni në gjendje për t'u përqendruar?	199	0	3.0	1.0	1	5
13. Sa i shëndetshëm është ambienti juaj fizik (lagjja ku jetoni)?	199	0	3.1	0.9	1	5
14. Keni energji të mjaftueshme në jetën tuaj të përditshme?	199	0	3.3	1.1	1	5
15. E pëlqeni pamjen tuaj fizike?	199	0	3.2	1.0	1	5
16. Keni mjaftueshëm para për të plotësuar nevojat tuaja?	199	0	2.4	1.2	1	5
17. Deri në çfarë mase ndiheni të pranuar nga njerëzit që njihni?	199	0	3.7	1.3	1	5
18. Sa të disponueshëm e keni informacionin e nevojshëm në të përditshmen tuaj?	199	0	**2.3**	1.4	1	5
19. Sa mundësi keni për të bërë aktivitete në kohën e lirë?	199	0	**2.1**	1.2	1	5
20. Keni energji të mjaftueshme për të ardhur vërdallë nga një vend në tjetrin?	199	0	2.9	1.2	1	5
21.Sa i kënaqur jeni me gjumin?	199	0	3.2	1.1	1	5
22. Sa i kënaqur jeni me performancën e akitiviteteve që ju bëni gjatë ditës?	199	0	2.9	1.1	1	5
23. Sa i kënaqur jeni me kapacitetin tuaj për të punuar?	199	0	3.0	1.2	1	5
24. Sa i kënaqur jeni me veten tuaj?	199	0	3.0	1.1	1	5
25. Sa i kënaqur jeni në marrëdhënien tuaj personale?	199	0	2.9	1.2	1	5
26. Sa i kënaqur jeni në jetën tuaj seksuale?	199	0	2.5	1.3	1	5
27. Sa i kënaqur jeni me mbështetjen që merrni nga miqtë tuaj?	199	0	3.4	1.1	1	5
28. Sa i kënaqur jeni me kushtet e shtëpisë ku jetoni?	199	0	3.4	1.0	1	5

29. Sa i kënaqur jeni me aksesin (shërbimin) që keni në qendrat shëndetësore?	199	0	3.5	0.9	1	5
30. Sa i kënaqur jeni me transportin tuaj?	199	0	2.9	1.1	1	5
31. Sa shpesh përjetoni ndjenja negative, rënie humori, dëshpërim, ankth, depresion?	199	0	2.8	1.0	1	5

Grafiku 36.4 na tregon se ka shumë variacion midis mesatareve të përgjigjeve, por nuk ka përgjigje nën 2.5. Së dyti, na tregon se popullata në studim nuk tregon vlera mesatare ekstreme të përgjigjeve.

Grafiku 36.4 Vlerat mesatare të përgjigjeve.



4.4.1 Analiza e pyetjeve me përgjigje që kanë tendencë pozitive dhe atyre me tendencë negative.

Pyetësori ka 31 pyetje, nga të cilat 3, 4, 5, 8, 9, 10, 31 janë kodifikuar duke e përmbysur rezultatin, prandaj duhen rikodifikuar edhe një herë, meqenëse vlera më e madhe, konkretisht 5, tregon realisht vlerën më të ulët në raport me cilësinë e jetës, në ndryshim me pyetjet e tjera, ku vlera më e lartë tregon edhe gjendjen më të mirë. Ky kodifikim dhe rikodifikimi është realizuar si kërkesë e pyetësorit standard dhe mënyrës së përpunimit të tij të ofruar nga OBSH-ja.

Pyetjet janë vlerësuar si perceptime negative apo pozitive të aspekteve të veçanta të pyetjeve në lidhje me cilësinë e jetës. Vlerat 3, 4 dhe 5 janë grupuar së bashku duke u paraqitur si perceptim i mirë (shumë i mirë) apo i kënaqur (shumë i kënaqur) dhe vlerat 1, 2 i korrespondojnë qëndrimeve keq dhe i pakënaqur.

Në tabelat në vazhdim janë paraqitur dy nëngrupet e pyetjeve sipas këtij klasifikimi në % dhe vlera absolute, ku të gjitha pyetjet kanë marrë përgjigje nga të gjithë të intervistuarit (n = 199).

Tabela 35.4 Shpërndarja e pyetjeve të WHOQOL-HIV-BREF me predominim pozitiv.

P	Pyetja	n	%
P1	Si do ta vlerësoni cilësinë tuaj të jetës?	162	81.4%
P2	Sa i kënaqur jeni me shëndetin tuaj?	159	79.9%
P6	Sa shumë i gëzoheni jetës?	143	71.9%
P7	Sa kuptim ka jeta juaj?	148	74.4%
P11	Sa i mirë është niveli juaj i përqendrimit?	152	76.4%
P12	Sa i sigurt ndiheni në jetën tuaj?	135	67.8%
P13	Sa i shëndetshëm është mjedisi juaj fizik?	161	80.9%
P14	Keni energji të mjaftueshme në jetën tuaj të përditshme?	158	79.4%
P15	A e pranoni imazhin tuaj trupor?	159	79.9%
P17	Sa i pranuar ndiheni nga njerëzit që ju njohin ju?	164	82.4%
P20	Keni energji të mjaftueshme për t'u vërdallisur nga një vend në tjetrin?	126	63.3%
P21	Sa i kënaqur jeni me gjumin tuaj?	155	77.9%
P22	Sa i kënaqur jeni me performancën e aktiviteteve tuaja gjatë ditës?	139	69.8%
P23	Sa i kënaqur jeni me kapacitetin për të punuar?	131	65.8%
P24	Sa i kënaqur jeni me veten tuaj?	146	73.4%
P25	Sa i kënaqur jeni në marrëdhënien tuaj personale?	133	66.8%
P26	Sa i kënaqur jeni me jetën tuaj seksuale?	100	50.3%
P27	Sa i kënaqur jeni me mbështetjen e miqve tuaj?	165	82.9%
P28	Sa i kënaqur jeni me kushtet e shtëpisë ku jetoni?	167	83.9%
P29	Sa i kënaqur jeni me aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore?	175	87.9%
P30	Sa i kënaqur jeni me transportin?	132	66.3%
P31	Sa shpesh përjetoni ndjenja të tilla, si: rënie humori, depresion, ankth?	156	78.39%

Tabela 36.4 Shpërndarja e pyetjeve të WHOQOL-HIV-BREF me predominim negativ.

P	Pyetja	n	%
P3	Në çfarë mase mendoni se dhimbjet fizike ju ndalojnë të bëni atë që doni të bëni?	141	70.9%
P4	Sa i mërzitur jeni me problemet fizike të lidhur me HIV/AIDS?	128	64.32%
P5	Sa shumë keni nevojë për medikamente për të funksionuar në jetën tuaj të përditshme?	166	83.42%
P8	Në çfarë mase jeni i mërzitur nga njerëzit që ju fajësojnë për statusin tuaj HIV?	156	78.39%
P9	Sa shumë i trembeni të ardhmes?	144	72.36%
P10	Sa shumë shqetësoheni për vdekjen?	149	74.87%
P16	A keni para të mjaftueshme për të plotësuar nevojat tuaja?	102	51.3%
P18	Sa i disponueshëm është informacioni për ju nga dita në ditë?	120	60.3%
P19	Sa mundësi keni për aktivitet gjatë kohës së lirë?	135	67.8%

4.5 REZULTATET E DOMENEVE

Tabela më poshtë tregon se çfarë ndodh me Alfa të Cronbach nëse një nga domenet fshihet (hiqet). Vlerat rezultojnë në rangun prej **0.77–0.83** dhe mbeten të larta dhe të kënaqshme ashtu si në rastin e llogaritjes së koeficientit për të gjithë studimin.

Tabela 37.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve.

	Scale Mean if Item Deleted	Scale Variance if Item Deleted	Corrected Item-Total Correlation	Squared Multiple Correlation	Cronbach's Alpha if Item Deleted
Fizik	65.0	122.8	0.6	0.5	**0.80**
Psikologjik	67.6	123.9	0.8	0.6	**0.77**
Niveli i autonomisë	66.3	123.0	0.7	0.5	**0.79**
Marrëdhëniet sociale	66.9	129.0	0.6	0.4	**0.81**
Mjedisi	68.3	133.6	0.6	0.5	**0.80**
Shpirtëror, fetar, besimet	63.7	138.7	0.4	0.3	**0.83**

Tabela 38.4 tregon matriksin e korrelacioneve ndërmjet domeneve. Të gjitha korrelacionet janë sinjifikante, $p < 0.001$. Siç shikohet në tabelë dhe gjithashtu në paraqitjen grafike më poshtë mund të vihet re që të gjithë domenet kanë lidhje korrelative pozitive. Vlera më të larta dhe që meritojnë interpretim të mëtejshëm janë domenet:

Psikologjik–Fizik	(0.6)
Niveli i autonomisë–Fizik	(0.6)
Niveli i autonomisë–Psikologjik	(0.6)
Marrëdhëniet sociale–Psikologjik	(0.5)
Mjedisi–Psikologjik	(0.6)
Mjedisi–Niveli i autonomisë	(0.6)
Mjedisi–Marrëdhëniet sociale	(0.5)

Tabela 38.4 Inter-Item Correlation Matrix.

	Fizik	Psikologjik	Niveli i autonomisë	Marrëdhëniet sociale	Mjedisi	shpirtëror, fetar, besimet
Fizik	1.0	0.6	0.6	0.3	0.4	0.4
Psikologjik	**0.6**	1.0	0.6	0.5	0.6	0.4
Niveli i autonomisë	**0.6**	**0.6**	1.0	0.4	0.6	0.3
Marrëdhëniet sociale	0.3	**0.5**	0.4	1.0	0.5	0.4
Mjedisi	0.4	**0.6**	**0.6**	**0.5**	1.0	0.2
Shpirtëror, fetar, besimet	0.4	0.4	0.3	0.4	0.2	1.0

Grafiku 37.4 tregon paraqitjen grafike të lidhjeve korrelative ndërmjet domeneve. Secili kuadrat tregon pozicionimin e një domeni ndaj të tjerëve nëpërmjet paraqitjes grafike të quajtur *"scatterplot"*. Në secilin nga boshtet është projektuar nga një variabël, domen në rastin tonë dhe pikat tregojnë elementet e studiuar. Në mes shikojmë disa kuadrate bosh që i korrespondojnë korrelimit të variablit me veten e tij. Pjesa e grafikëve sipër tyre është simetrike me pjesën e poshtme dhe tregon të njëjtat *"scaterplot"*, por domenet ndryshojnë pozicionimet në akse. P.sh., grafiku majtas poshtë vendos domenin 1 në boshtin X dhe domenin 6 në boshtin Y. I njëjti grafik ndodhet në pjesën më të sipërme djathta, por tashmë boshtet janë shkëmbyer, në boshtin X është domeni 6 dhe në atë Y është domeni 1. Prandaj, për interpretim na mjaftojnë grafikët e pjesës së poshtme.

Forma e pikave në *"scatterplot"* tregon edhe forcën e lidhjes korrelative. Sa më tepër ti afrohen shpërndarjet një vije, ose topi rregbije, aq më e fortë është lidhja korrelative, pozitive apo negative. Nga ana tjetër, sa më të shpërndara të jenë pikat në grafik, aq më pak të korreluar janë variablat, domenet, ku vlera i afrohet 0-s.

Grafik 37.4 Paraqitje grafike e lidhjeve korrelative midis domeneve.



* *

* Domeni 1 Fizik
* Domeni 2 Psikologjik
* Domeni 3 Niveli i autonomisë
* Domeni 4 Marrëdhëniet sociale
* Domeni 5 Mjedisi
* Domeni 6 Shpirtëror, fetar, besimet

Tabela 39.4 përshkruan vlerat e gjetura për secilin domen, duke filluar që nga mesatarja deri në minimumin dhe maksimumin për çdo domen. Mesatarja për çdo domen është më e madhe se 4 (vlera minimale sipas WHOQOL) dhe më e vogël se 20 (vlera maksimale sipas WHOQOL). Domeni fizik ka vlerën 14.5, psikologjik 12.0, i autonomisë 13.3, social 12.6, i mjedisi 11.3 dhe besimeve personale/shpirtërore/fetare 15.9. Domeni BPSHF ka vlerën më të lartë krahasuar me gjithë domenet e tjerë në popullatën e studiuar.

Tabela 39.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve.

	Fizik	Psikologjik	Niveli i autonomisë	Marrëdhëniet sociale	Mjedisi	Besimet/ Personale/ Shpirtërore/ Fetare	Totali
Mesatarja	14.5	12.0	13.3	12.6	11.3	15.9	63.7
Mediana	15.0	12.0	13.0	13.0	11.0	16.0	63.0
Moda	17	12.0	13[a]	14	11.0	19	63.5
Dev. stand.	3.3	2.8	3.1	3.2	2.7	3.0	11.8
Rangu	15	15.2	15	16	16.0	13	63.9
Minimum	5	4.8	5	4	4.0	7	28.4
Maksimum	20	20.0	20	20	20.0	20	92.3

a. Më shumë se një modë ekziston. Është treguar vlera më e vogël.

Grafik 38.4 Paraqitje grafike e parametrave të domeneve.



Në tabelën 40.4 paraqiten pikët për çdo domen sipas gjinisë. Ashtu siç dhe vihet re, dallimet mes dy gjinive nuk janë të konsiderueshme. Pra, sëmundja HIV/AIDS prek po njësoj cilësinë e jetës së PJHA-së në Shqipëri, pavarësisht gjinisë së tyre. Gjetjet në literaturë shprehin pikëpamje të ndryshme. I vetmi ndryshim i konsiderueshëm në studimin tonë ndodh në domenin e besimeve personale/shpirtërore/fetare, për meshkujt domeni ka vlerën 16.5 dhe për femrat 14.9.

Tabela 40.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve sipas gjinisë.

Emrat e domeneve	F	M
Fizik	15.1	14.3
Psikologjik	11.8	12.1
Niveli i autonomisë	13.2	13.3
Marrëdhëniet sociale	12.2	12.9
Mjedisi	10.7	11.6
Besimet Personale, Shpirtërore, Fetare	14.9	16.5
Totali	**62.9**	**64.1**

Tabela 41.4 tregon se nuk ka ndryshime në cilësinë e jetës midis subjekteve që janë në terapi me TAR dhe atyre që nuk janë nën terapi. Por, duke patur parasysh se në këtë studim pjesëmarrje më të madhe kanë patur subjektet që janë nën TAR, sepse ata vijnë rregullisht në spital, ndërsa pjesa më e madhe e atyre që nuk janë në TAR është e vështirë të bëhet objekt studimi.

Tabela 41.4 Përmbledhje deskriptive e parametrave të domeneve, merr apo jo TAR.

Emrat e domeneve	Jo	Po
Fizik	15.36	14.45
Psikologjik	11.600	12.032
Autonomia	13.86	13.18
Marr. sociale	12.09	12.69
Mjedisi	11.364	11.237
Shpirtëror	15.32	15.97
Totali	**64.282**	**63.591**

Tabela 42.4 përshkruan cilësinë e jetës në të gjashtë domenet lidhur me karakteristikat demografike dhe klinike të subjekteve në studim. Vihet re se mosha nuk ndikon në asnjë nga domenet që masin cilësinë e jetës tek pjesëmarrësit. Ndryshimet midis femrave dhe meshkujve ndodhin në domenin e mjedisit, ku sinjifikanca është p *<0.05 dhe atë shpirtëror me p**<0.001, ku vlerat e cilësisë së jetës janë më të larta tek meshkujt. Niveli arsimor ndikon dukshëm në cilësinë e jetës në katër domene: psikologjik, niveli autonomisë, marrëdhëniet sociale dhe atë shpirtëror. Por më shumë në nivelin e autonomisë me një vlerë p**<0.001. Statusi civil ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së subjekteve të martuar, specifikisht në domenin e marrëdhënive sociale me një vlerë p*<0.05. Etnia ndikon në cilësinë e jetës në pesë nga gjashtë domenet tek subjektet që i përkasin etnisë Rome. Ajo që vihet re është se domeni i marrëdhënieve sociale ka një vlerë p**<0.001, ndërsa në domenin fizik etnia është një faktor që nuk ndikon. Subjektet në marrëdhënie pune kanë një cilësi më të mirë jete në domenin e autonomisë dhe marrëdhënieve sociale me një vlerë p**<0.001. Perceptimi subjektiv mbi gjendjen shëndetësore ndikon në cilësinë e jetës së subjekteve në të gjashtë domenet. Në domenet fizik, psikologjik, autonomisë dhe mjedisit vlera është p**<0.001. Të konsideruarit e vetes së sëmurë ndikon në një cilësi jete të ulët, ndërsa të konsideruarit të vetes si jo i sëmurë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës në pjesëmarrësit në studim. Ky variabël ka një sinjifikancë shumë domethënëse (p**<0.001) në domenet fizik, psikologjik, autonomisë dhe mjedisit, por domeni i marrëdhënieve sociale ndikohet më pak (p*<0.05). Statusi HIV ndikon në cilësinë e jetës në domenin e mjedisit (p*<0.05), por kjo mund të lidhet me faktin se 86% e subjekteve në studim nuk kishin informacion mbi stadin e sëmundjes AIDS.

Tabela 42.4 Krahasimi i vlerave mesatare të matjeve të cilësisë së jetës sipas karakteristikave demografike dhe klinike (N = 199)

Variabla		Fizik	Psikologjik	Niveli i autono-misë	Marrë-dhëniet sociale	Mjedisi	Besimet personale/ shpirtëror/ fetar,
Mosha	16-24 vjeç	15.67	12.800	13.22	14.00	11.889	16.22
	25-34 vjeç	14.49	11.525	13.22	12.12	11.398	15.29
	35-44 vjeç	14.81	12.247	13.63	12.66	11.500	15.76
	45-54 vjeç	13.89	11.704	13.28	12.87	10.815	16.46
	55-64 vjeç	14.85	12.985	12.62	12.69	10.885	17.15
	>65 vjeç	15.00	12.400	9.25	13.50	9.625	16.00
	F	F=0.68	F=1.02	F =1.65	F=0.75	F=0.82	F=1.33
Gjinia	M	14.26	12.094	13.29	12.87	11.559	16.48
	F	15.07	11.786	13.2	12.2	10.697	14.86
	T	t=1.66	t=-0.74	t=-0.20	t=-1.43	t=-2.17*	t=-3.77**
Edukimi	8 -vjeçar	13.75	10.600	11.75	10.88	8.688	13.88
	Fillor	14.13	11.376	12.35	12.36	10.470	15.61
	I mesëm	14.72	12.613	14.02	12.77	11.977	16.22
	I lartë	15.93	13.156	15.26	13.81	13.185	16.81
	F	F=2.34	F=5.13*	F=9.45**	F=2.38	F=13.35**	F=2.68*
Statusi civil	Beqar	14.62	12.192	13.52	12.08	12.170	15.62
	I divorcuar	14.14	11.657	14.29	12.14	12.071	16.29
	I martuar	14.55	11.931	13.10	13.08	10.894	16.20
	I ve	14.91	11.855	13.73	10.18	10.591	13.82
	Jeton si i martuar	13.25	12.000	11.75	12.75	11.500	15.00
	F	F=0.22	F=0.11	F=0.65	F=2.77*	F=2.38	F=1.9
Gjendja shëndetësore	1	9.55	9.818	9.27	11.82	10.727	15.27
	2	12.22	8.711	10.33	11.33	8.833	13.78
	3	13.61	10.988	12.53	12.20	10.383	15.50
	4	15.01	12.235	13.57	12.57	11.293	16.00
	5	17.08	14.440	15.58	13.93	13.250	17.00
	F	F=20.76**	F=19.99**	F=17.26**	F=2.58*	F=10.73**	F=3.3*
Aktualisht i sëmurë	Jo	15.91	13.320	14.69	13.01	12.175	16.65
	Po	13.63	11.086	12.29	12.37	10.630	15.39
	T	t =-5.05**	t =-5.95**	t =-5.7**	t =-1.4	t =-4.09**	t= -2.95*
HIV status	Asimp-tomatik	15.83	12.667	15.67	13.00	11.250	16.67
	I konvertuar në AIDS	14.11	13.179	13.47	13.79	12.895	16.42

	Nuk e di	14.55	11.819	13.15	12.52	11.047	15.81
	Simp-tomatik	15.00	12.800	13.50	10.00	13.250	16.50
	F	F=0.42	F=1.53	F=1.3	F=1.4	F=3.11*	F=0.4
Etnia	Shqiptare	14.71	12.14	13.47	12.93	11.48	16.08
	Rome	13.27	10.73	11.50	10.18	9.41	14.45
	T	t=1.93	t=2.24*	t=2.84*	t=3.96**	t=3.47*	t=2.43*
Punon	Po	14.95	12.297	13.98	12.90	11.942	15.89
	Jo	14.02	11.572	12.30	12.27	10.343	15.91
	T	t=1.96	t=1.81	t=3.89**	t=1.4	t=4.3**	t=-0.31

a. P *<0.05 , P**<0.001

4.6 GJETJE TË TJERA

4.6.1 Teknika e Binary Logistic Regression

Në studimin aktual u përdor Teknika e *Binary Logistic Regression* (Regresion Logjistik Binar), e cila na tregon se etnia Rome është 2.9 herë më tepër e riskuar se etnia Shqiptare për ta marrë sëmundjen me rrugë homoseksuale (MSM). OR = 2.9; C.I (0.78; 10.45) sig. 0.112. Kur të dhënat axhustohen për statusin e emigracionit dhe grup-moshën, rezultatet janë si në vazhdim: OR = 3.0; C.I (**0.86**; **10.47**) sig. 0.08.

Pas axhustimit për statusin e emigracionit dhe grup-moshën shikojmë që nuk ndryshon risku i marrjes së sëmundjes me rrugë homoseksuale. Kjo gjetje nuk është objekt i studimit aktual, por mund të shërbejë si objekt studimi në të ardhmen, për të kuptuar më shumë rreth orientimit seksual të kësaj popullate.

4.6.2 Analiza e korrespondencës së shumëfishtë

Analiza e korrespondencës së shumëfishtë realizohet duke reduktuar një numër të madh variablash në një numër më të kufizuar faktorësh, me qëllim lehtësimin e leximit të rezultateve, për të lehtësuar gjetjen e lidhjeve të zbuluara ndërmjet variablave.

Kjo analizë kuantifikon të dhënat kategorike duke ju përcaktuar atyre vlera numerike rasteve (objekteve) dhe kategori, kështu që objektet brenda të njëjtës kategori janë afër dhe objektet në kategori që ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra vendosen larg. Secili objekt është aq afër sa është e mundur me pikat e kategorive që aplikohen në këtë objekt. Prandaj, kategoritë i ndajnë objektet në grupe homogjene. Variablat konsiderohen homogjen, kur ata i klasifikojnë

objektet në të njëjtat kategori dhe në të njëjtat nëngrupe. Është një metodë analize multivariate. Metoda përputhet me studimin e variablave në studimin tonë, cilësorë, nominal. Mund të përdoret edhe për variabla ordinalë.

Grafik 41.4 Paraqitje e vendosjes së rasteve sipas faktorëve sociodemografik bazuar në analizën e korrespondencës së shumëfishtë.



Variable Principal Normalization.

Në grafikun më sipër janë kuantifikuar variablat, si: etni, çift, qytet, emigrant, KEMP, partner hiv +, fëmijë, merr TAR?, ka ndërprerë TAR?, a e ka treguar ose jo statusin HIV+ (jashtë familjes)?, punon, gjendja civile. A e konsideron veten të sëmurë?, serostatus, rruga e infektimit. Sipas rasteve vihen re dy gjëra: së pari, formohen dy grupe brenda popullatës dhe së dyti, dy outlier. Nga kjo kuptojmë se në studimin aktual nuk kemi një popullatë homogjene (siç është menduar në fillim të studimit), por johomogjeniteti i referohet variablave në studim, sepse në rastin më poshtë, kur variablat në studim ndryshojnë (variablat në rastin e dytë janë pyetjet, popullata është homogjene). Pra, popullata mund të jetë ose jo homogjene nga këndvështrimi që e shohim dhe reflektohet në këto lloj grafikësh. Kjo gjetje mund të përbëhet objekt studimi për të ardhmen.

Pacientët me numër 146, 65 dhe 104 janë ata që sipas kësaj teknike janë më shumë outlier. Tre subjektet janë femra, me moshë 35, 45 dhe 27 vjeç, të martuara, dy prej tyre kanë fëmijë, bashkëshortët e tyre janë HIV pozitiv, janë me arsim 8-vjeçar, nuk kanë dal në KEMP dhe nuk kanë emigruar asnjëherë. Një prej tyre

i përket etnisë Rome. Vihet re se karakteristikat e tyre sociodemografike janë të ngjashme, gjë që mund ta të justifikojë këtë rezultat.

Grafiku 42.4 Paraqitje e vendosjes së faktorëve sociodemografik ndaj njëri- tjetrit, bazuar në analizën e korrespondencës së shumëfishtë.



Variable Principal Normalization.

Grafiku 42.4 tregon grupimin e variablave të marrë në konsideratë në raport me njëri- tjetrin. Shikojmë se krijohen tre nëngrupe dhe respektivisht:

1) A ka ndërprerë TAR-in, merr TAR-in dhe qyteti; (2) Partneri HIV +, gjendja civile, pozitiv dhe fëmijë; (3) Emigrant, e konsideron ose jo veten të sëmurë, serostatus, rruga e infektimit, etnia, çift.

Interpretimi qëndron në argumentimin e afërisë ndërmjet variablave dhe krijimin e hipotezave të reja. P.sh., variablat KEMP dhe gjendja civile gjenden në grupe të ndryshme (janë larg). Mund të konkludojmë që marrja e KEMP-it nuk ndikohet nga gjendja civile, por më tepër nga rruga e infektimit që e ka më afër, apo gjendja civile që është më afër variablit të paturit fëmijë sesa variablit qytet.

Grafiku 43.4 Paraqitje e vendosjes së rasteve sipas përgjigjeve të pyetjeve bazuar në analizëne korrespondencës së shumëfishtë.



Tabela 43.4 na tregon të gjitha pyetjet nga 1 në 31. Vihet re se subjekti me numër 149 dhe 14 janë shumë të larguar nga popullata e përgjithshme. Nëse analizojmë përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit për subjektin 149 dhe 14 rezulton se: Këto dy subjekte kanë ngjashmëri në dhënien e përgjigjeve dhe në 31 pyetje ata i kanë përdorur të pesta alternativat nga 1-5, duke formuar grupe përgjigjesh me 1, 2, 3, 4 apo 5 sipas shkallës Likert, ndryshe nga pjesa tjetër e popullatës në studim. Karakteristikat e ngjashme dhe të ndryshme midis tyre janë: a) arsimi fillor, etnia Rome, janë me precedent penal, jetojnë në Tiranë; b) i përkasin dy gjinive të ndryshme.

Grafiku 44.4 Paraqitje e vendosjes së përgjigjeve të pyetjeve ndaj njëra-tjetrës, bazuar në analizëne korrespondencës së shumëfishtë.



Tabela 44.4 tregon se vlerësimi është bërë sipas përgjigjeve të dhëna. Pra, shohim si pozicionohen pacientët në raport me njëri-tjetrin, duke vlerësuar të gjitha përgjigjet së bashku. Çdo pikë në grafik është vlerësimi i të gjitha pyetjeve të paraqitura në një pikë të vetme e krahasuar me çdo pacient tjetër.

Në tabelë vihet re që popullata është homogjene, ku gjejmë vetëm pak outliers (14, 149, 133). Nëse analizojmë të dhënat e subjekteve që u korrespondojnë numrat më sipër rezulton se: një prej tyre është me arsim të lartë dhe dy me arsim 8-vjeçar, një prej tyre është gay, numri 149 është përgjigjur me 3 në 80% të pyetjeve, ndërsa tjetri është përdorues droge.

Nga karakteristikat individuale, ky grup mund të përbëjë një kategori sociale të veçantë që nuk është homogjene me popullatën e studiuar dhe prandaj duket që përgjigjet e tyre janë paradoksale, krahasuar me popullatën. Qëllimi është që, pasi identifikohen, të trajtohen në mënyrë më specifike nga grupi.

Interpretimi qëndron në vlerësimin e grupeve të krijuara në grafik dhe afërsinë e variablave me njëri-tjetrin. Sa më afër, aq më të lidhur.

Kjo është përmbledhje e rezultateve të pikëve dhe shikohet që ka vazhdimësi dhe homogjenitet, ka radhë dhe radha ruhet (1, 2, 3 ...), kjo e dhënë na tregon edhe njëherë fortësinë në vlefshmëri dhe besueshmëri të instrumentit WHOQOL-HIV-BREF në popullatën e PJHA-së.

Si përfundim, mund të themi se të gjitha rezultatet e nxjerra më sipër, secila prej tyre përbën një hipotezë më vete dhe ato mund të bëhen objekt kërkimi në të ardhmen.

KAPITULLI
5 DISKUTIME

5.1 HYRJE

HIV/AIDS është bërë një sëmundje kronike dhe cilësia e jetës është shfaqur si një matje e rëndësishme e rezultateve të përparimit të sëmundjes dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Ky kapitull fillon me një përmbledhje të gjetjeve të rëndësishme që lidhen me qëllimet kërkimore dhe diskutimin e rezultateve. Kjo do të pasohet me rëndësinë dhe zonat e ardhshme kërkimore.

5.2 STUDIMI I KAMPIONIMIT NË STUDIM

Për vitin 2013, numri i PJHA-së në Shqipëri ishte 671 persona, nga këta, 469 meshkuj dhe 202 femra (ISHP, 2013). Po sipas ISHP-së, vlerësimet tregojnë se numri i personave të infektuar duhet të jetë më i madh, pasi numri i personave që kryejnë testim vullnetar për HIV mbetet akoma i ulët. Për periudhën janar-nëntor 2013 janë testuar 1% e popullatës. Kjo përqindje e ulët mund të lidhet me disa faktorë: së pari, mungesa e fushatave sensibilizuese për popullatën; së dyti, frika nga stigmatizimi dhe paragykimi; së treti, mungesa e informacionit për qendrat, ku ofrohet ky shërbim etj. Të gjitha studimet e pranojnë unanimisht këtë faktor.

Harta e shpërndarjes së popullatës që jeton me HIV/AIDS, e parë në tre pozicione, sipas ISHP-së, shtrimeve në QSUT-ë dhe kampionit në studim rezulton se nuk ka ndryshime. Në të treja këto harta, Tirana është vendi ku janë të lokalizuara rreth 50% e rasteve me HIV/AIDS. Megjithatë, Tirana (749 365 banorë) përbën 27.8% të popullatës së përgjithshme të Shqipërisë (2 800138 banorë) sipas të dhënave të Censusit, 2011. Përqendrimi në Tiranë lidhet me faktin se 40% e popullatës ka lëvizur drejt Tiranës (Census, 2011, INSTAT). Një faktor tjetër është se kujdesi shëndetësor për PJHA-në është i centralizuar vetëm në QSUT, dhe tendenca është që, pas diagnostikimit, subjektet zhvendosen për të jetuar në Tiranë. Kjo është një mënyrë që ata të shmangin stigmën dhe diskriminimin në vendet e tyre të lindjes. Në gjithë literaturën e shqyrtuar nuk u gjetën të dhëna që vendbanimi të jetë një faktor ndikues në cilësinë e jetës së PJHA-së.

5.2.1 Karakteristikat individuale të kampionimit

Në studim kanë marrë pjesë 199 pacientë: 71 femra (36.7%) dhe 128 meshkuj (64.3%), mosha mesatare e pacientëve të paraqitur është 39.9 ± 10.7 vjeç. Grup-mosha 25-34 (29.6) dhe 35-44 (34.2%) përbën përqindjen më të lartë të PJHA-së në studim, por edhe sipas ISHP-së, grup-mosha 25-45 vjeç përbën 63% të rasteve. Vlen të përmendet se në studim ka pasur pjesëmarrës me moshë mbi 40 vjeç, e cila është pritshmëria mbi jetëgjatësinë që i atribuohet kryesisht pandemisë së HIV/AIDS (UNAIDS/WHO, 2006). Megjithatë, nuk është e qartë, në qoftë se njerëzit kanë filluar të jetojnë më gjatë, apo ata janë duke u infektuar më vonë në jetë.

Gjashtëdhjetë e tetë për qind e pjesëmarrësve ishin të martuar, ndërsa 26.6% e tyre ishin çift në studim. Gjatë procesit të studimit të kartelave mjekësore të subjekteve rezulton se gratë janë testuar në spital pas shtrimit të burrave të tyre në klinikën infektive dhe diagnostikimit të tyre HIV pozitiv, që vërtetohet edhe nga studimi, ku 43.7% e femrave janë çift në studim dhe 81.3% e meshkujve nuk janë çift në studim. Një gjetje e rëndësishme nga studimi ynë është se meshkujt janë vektori i përhapjes së virusit HIV në Shqipëri. Si në etninë Rome dhe atë Shqiptare, sëmundja e HIV/AIDS po "godet" familjen nukleare. Pra, sëmundja HIV/AIDS po bëhet një problem madhor social që po godet strukturën e familjes dhe shoqërisë.

Dyzet e shtatë për qind e meshkujve deklarojnë se kanë qenë emigrant, Greqia me 26.1% dhe Italia me 10.6%. Sipas Censusit të vitit 2011 (INSTAT, IOM, 2011), numri i Shqiptarëve që kanë emigruar në Greqi është 480 824 dhe në Itali 482 627. Këto dy vende kanë numrin më të madh të emigrantëve, të ndjekura nga Gjermania, Anglia, USA etj. Rasti i parë i diagnostikuar me HIV/AIDS në Shqipëri në vitin 1993 ka qenë emigrant në Greqi (ISHP). Numri i lartë i emigrantëve shpjegon se, kemi meshkuj më shumë të infektuar dhe familje të prekuara nga virusi HIV. Gjatë analizës së rekordeve të periudhës midis viteve 1993-2000, 70% e PJHA-së deklarojnë se janë infektuar në vendet ku kanë emigruar (Programi Kombëtar i HIV/AIDS, ISHP). Pas kësaj periudhe kemi shtim të rasteve të infektuar nga virusi HIV, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë emigrant, 58.8% (Programi Kombëtar i HIV/AIDS, ISHP,Xhani.B.,2014). Kjo do të thotë se tashmë virusi po qarkullon brenda territorit shqiptar. Në të gjitha studimet ndërkombëtare, në kuadër të procesit të globalizimit, lidhja midis shëndetit dhe emigracionit është e dokumentuar shumë mirë (Douglas. W. MacPherson., Brian.D.Gushulak., Liane.Macdonald., 2009).

Pesëdhjetë pikë tre për qind e pjesëmarrësve në studim kanë arsim 8-vjeçar dhe 43.2% e tyre deklarojnë se nuk punojnë. Këto të dhëna statistikore mbi

karakteristikat individuale të subjekteve në studim janë të ngjashme me rekordet në vite të popullatës që jeton me HIV/AIDS në Shqipëri (Programi Kombëtar i HIV/AIDS, ISHP). Nëse këto gjetje i krahasojmë me të dhënat e Censusit (INSTAT, 2011) nuk kanë shumë ndryshime, 40.9% e popullatës së përgjithshme kanë arsim 8-vjeçar dhe 59.6% janë deklaruar si inaktiv.

Subjektet e përfshira në studim i përkasin më shumë se një etnie. Tetëdhjetë e tetë pikë nëntë për qind e tyre janë shqiptarë dhe 11.1% i përkasin etnisë Rome. Sipas Censusit, Albania (INSTAT,2011), etnive Rome dhe Egjiptiane i përkasin së bashku 0.42% e popullatës së përgjithshme. Mund të mos jetë e saktë, sepse mospërgjigjja në Census rreth kësaj pyetjeje është rreth 14%. Gjithsesi, numri i të sëmurëve në popullatën me HIV/AIDS nga komuniteti Rom dhe Egjiptian është mjaft më i lartë se përfaqësimi i tyre në popullatën e përgjithshme. Në literaturën e shqyrtuar nuk u gjetën të dhëna mbi ndryshimet në cilësinë e jetës së PJHA-së në bazë të etnisë edhe pse, referuar Piot (2001), infektimi nga HIV/AIDS në minoritetet etnike dhe popullatat e varfëra është më i lartë sesa pjesa tjetër e popullsisë, për shkak të aksesit të ulët në marrjen e shërbimeve dhe vështirësive që ata kanë për të arritur përfitimet e terapisë. Në studimin aktual, aksesin ndaj TAR-it e kanë të gjithë njësoj dhe nuk vihen re përjashtime (do diskutohet më poshtë).

Stigma e ka shoqëruar HIV/AIDS që në vitet e para të shfaqjes së saj (Mann, 1987; Parker. R.,Aggleton.P,2003). AIDS –lidhur me stigmën i referohet "paragjykimit, nënvlerësimit, diskreditimit dhe diskriminimit të drejtuar kundrejt njerëzve që kanë HIV ose AIDS, dhe komuniteteve me të cilat ata janë të lidhur" (Herek, 2005). Kjo është një nga arsyet madhore që PJHA-ja nuk e bën të njohur statusin e tyre HIV pozitiv, nga ndjenja e frikës, përjashtimit social, izolimit, paragjykimit. Në studim është përfshirë një pyetje cilësore: "A keni treguar statusin HIV pozitiv (jashtë familjes)?". Për të marrë një informacion më shumë që ka lidhje me pyetjen numër 9-të në pyetësor (tabela 38.4), e cila ka një mesatare të lartë 4.2. Rreth 96.5% (2.8% f/ 3.9% m) e subjekteve në studim deklaruan se nuk e kanë treguar statusin HIV pozitiv, në këtë mënyrë shpjegohet se pse kjo pyetje ka këtë mesatare të lartë. Nëse krahasojmë gjetjet e kësaj pyetjeje midis dy etnive, rezulton se etnia Rome (18.2%) e pjesëmarrësve në studim e kanë bërë të ditur statusin e tyre kundrejt 1.7% të subjekteve që i përkasin etnisë Shqiptare. Pyetjeve cilësore, subjektet në studim (popullata rome) u janë përgjigjur për arsyet që i kanë shtyrë të tregonin stausin HIV pozitiv: "nuk kisha dëgjuar kurrë për sëmundjen, e ndava me njerëz të besuar, nuk e di se nga e kanë marrë vesh etj", ndërsa për subjektet që i përkasin etnisë Shqiptare: "kam besim tek ata me të cilët e kam ndarë, kisha nevojë ta diskutoja

me miq që të mbroj familjen, do plasja nëse nuk e ndaja me njeri etj.", këto janë disa nga komentet e pjesëmarrësve në studim.

5.2.2 Karakteristikat klinike të kampionimit

Tridhjetë e shtatë për qind e subjekteve në studim deklaruan se shëndeti i tyre ishte i mirë, ndërsa 59.8% e tyre pohuan se e konsideronin veten të sëmurë. Gjetjet e studimit tonë përputhen me ato të studimit kroat (S. Belak Kovacevic et al., 2006) me vlera pothuajse të njëjta. Kjo e dhënë na tregon se HIV/AIDS ende nuk është pranuar si një sëmundje kronike. Në pyetjen cilësore, pjesëmarrësit pohuan se, përderisa kjo është një sëmundje që nuk shërohet, edhe pse ata janë mirë fizikisht, e konsideronin veten të sëmurë. Krahasuar me të njëjtin studim në Zmbavi (WHOQOL, 2011), atje 68.1% e subjekteve në studim nuk e konsideronin veten të sëmurë. Këtë gjetje, ata e justifikonin me faktin se HIV/AIDS ka filluar të pranohet si një sëmundje kronike.

Në këtë studim, 86.4% e subjekteve u shprehën se nuk e dinë statusin e tyre të sëmundjes, pra, nëse janë AIDS, asimptomatik apo simptomatikë. Kjo e dhënë, krahasuar me studime të ngjashme, si në: Itali, Kroaci, Francë, Zimbave, Brazil, Estoni, ku është përdorur i njëjti instrument e metodologji, nuk pasqyrohet në asnjë rresht. Studimi i realizuar nga S.Belak Kovacevic et al (2006) raportoi se gjetjet e studimit në subjektet kroate nuk treguan dallime domethënëse midis QOL-së së domeneve dhe stadeve të infeksionit HIV. Referuar gjetjeve të një studimi të realizuar në Estoni, statusi HIV i sëmundjes ndikonte në QOL-në e PJHA-së (K.Rüütel et al.,2009). Në disa studime përshkruese, cilësia e jetës ndryshon me fazën e sëmundjes HIV. Disa studime gjetën se pacientët asimptomatikë HIV pozitiv shënonin cilësi më të lartë jete sesa homologët e tyre me simptoma klinike (Corless et al., 2005; Ganz et al., 1993; Wu et al., 1997). Megjithatë, në një studim të kryer mbi indianët dygjuhësorë, rezultatet e gjetura ishin të kundërta: që HIV serostatus nuk ishte lidhur me cilësinë e jetës dhe nuk ishte e qartë se çfarë kontributi shton HIV serostatus në cilësinë e jetës (Saxena et al., 2005).

Mungesa e informacionit mbi statusin HIV të sëmundjes tregon se bashkëpunimi mjek-pacient është i udhëhequr nga modeli mjekësor tradicional, i fokusuar në aspektin teknik, instrumental të kujdesit shëndetësor dhe të stërvitur pak në anën interpersonale (Petraq.S., 2008). Vihet re një anashkalim i së drejtës së pacientit për t'u informuar mbi sëmundjen. Kjo është një e drejtë e ratifikuar në Konventën e të Drejtave të Njeriut dhe Ligjin mbi HIV/AIDS-in të miratuar në vitin 2008.

Tetëdhjetë e katër pikë shtatë për qind e subjekteve në studim deklaruan se ishin infektuar në rrugë seksuale (11.4% MSM), ndërsa 10.0% deklaruan se nuk kishin dijeni për rrugën e infektimit. Subjektet, të cilët u përgjigjën se nuk e dinin rrugën e infektimit, ishin meshkuj dhe kjo mund të shpjegohet me frikën nga paragjykimi, për të mbajtur të fshehur orientimin e tyre seksual ose tradhtinë martesore.

Këto gjetje janë konsistente krahasuar me të dhënat akumulative nga ISHP-ja (1996-2013), ku rruga seksuale e transmetimit predominon në vendin tonë, transmetimi në rrugë heteroseksuale është 84% dhe homoseksuale është 9%.

Po të mbështetemi në studimet e kryera deri më tani, në lidhje me rrugën e transmetimit dhe sjelljen, rruga homoseksuale ka mundësi të jetë më e lartë, pasi frika nga stigma dhe diskriminimi pengon testimin vullnetar të meshkujve që bëjnë seks me meshkuj. Referuar raportit "*Albania Behavioral and Biological Surveillance*" (ISOP, 2008) 82% e MSM-ve të intervistuar nuk ishin testuar asnjëherë vullnetarisht, edhe pse 78.3% e tyre kishin informacion për qendrat e testimit vullnetar në Tiranë. Kërkimet mbi aspektin psikosocial të MSM-së në SHBA treguan se statusi HIV pozitiv është i lidhur fort me stresin dhe depresionin në këto subjekte (Turner. H., Coates. TJ., 1992). Në të gjitha studimet mbi QOL-në e PJHA-së, fokusi ka qënë vetëm në dallimet mes femrave dhe meshkujve, ndërsa orientimi seksual nuk është analizuar si faktor në QOL-në e PJHA-së në studim.

Subjektet në këtë studim përfshinë më shumë se një etni. Nga popullata e meshkujve, 114 (11.4% MSM) i përkasin etnisë Shqiptare dhe 14 (28.6%) asaj Rome. Krahasuar me studimin Bio-BSS (ISOP, 2008), vetëm 1.4% e popullates Rome ishte MSM dhe 0% të infektuar me virusin HIV. Në studimin tonë, përdorimi i teknikës së Regresionit Logjistik Binar tregoi se etnia Rome është 2.9 herë më tepër e riskuar se ajo Shqiptare për ta marrë sëmundjen në rrugë homoseksuale (meshkujt).

Terapia antiretrovirale është mjekimi që përdoret në trajtimin e sëmundjes së HIV/AIDS. Udhëzuesit rekomandojnë se terapia ART mund të fillohet kur numri i qelizave CD_4 është 350 ose më pak (WHO, 2010). Shumica e pjesëmarrësve (88,9%,88.7%f/89.1%m) në studimin e tanishëm janë nën terapi me antiretrovirale dhe kjo mund të ketë ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës. Në fakt, nga studimi del se ndryshimet në të gjashtë domenet midis subjekteve në TAR dhe atyre që nuk janë në terapi nuk janë aspak domethënëse. Këto gjetje janë të njëjta me shumë studime të ngjashme të realizuara në vende të ndryshme të botës. Ekziston nevoja për një studim për të shqyrtuar efektin e adherencës së ilaçeve për cilësinë e jetës në mënyrë për të përcaktuar ndikimin e ilaçeve antiretrovirale në cilësinë e jetës.

Në studimin aktual rezulton se nuk ka diskriminim në trajtimin mjekësor midis dy etnive (88.1% etnia Shqiptare, 95.9% Rome) dhe po të dyja janë njësoj të barabarta në aksesin ndaj trajtimit me TAR, pavarëshit etnisë, gjinisë apo statusit shoqëror. Nga studimi i kartelave të pacientëve në Klinikën Ambulatore, rezultoi se të gjithë subjektet në studim janë diagnostikuar në stadin AIDS të sëmundjes. Kjo e dhënë përputhet me numrin e ulët të testimeve vullnetare. Në këtë studim, në mënyrë sipërfaqësore, duke mos qenë qëllim i studimit, është studiuar dhe adherenca që kanë me ilaçet subjektet në studim. Rezultoi se në total, sipas etnisë, 9.5 % e tyre kanë ndërprerë terapinë (7.9% Shqiptare, 22.7% Rome) dhe në total, sipas kampionit në studim, 9.5% (8.5% f/10.2% m) e kanë ndërprerë TARin. Referuar komenteve të pjesëmarrësve rreth arsyeve se pse e kanë ndërprerë mjekimin ishin të ndryshme, si: "nuk kisha shenja të sëmundjes, më vinte turp të vija në spital, burri më pengoi të merrja terapinë, nuk i përballoja dot efektet e ilaçeve, nuk e pranoja që isha i/e sëmurë", këto ishin komentet më të shpeshta midis subjekteve në studim.

5.3 INSTRUMENTI WHOQOL-HIV SHQIPTAR

Instrumenti WHOQOL-HIV është përdorur në shumë vende të botës. Në të gjitha këto vende, ai ka treguar një kosistencë besueshmërie të brendshme dhe të jashtme të lartë dhe ka dhënë prova që mund të përdoret me sukses në kontekste të ndryshme kulturore. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka prodhuar një instrument të përgjithshëm për Cilësinë e Jetës, i cili mund të testohet në gjuhë dhe klinika apo kontekste sociale të ndryshme, i cili bëhet i përshtatshëm për të matur shëndetin sistematik ndërkulturor të ngjashëm me matjen e QOL-së (Skevington S. M., 2002).

Në studimin tonë, koeficienti alfa është llogaritur nga korrelacionet e secilit domen me domenet e tjerë. Alfa α Cronbach për të gjithë domenet së bashku është 0.83. Duhet sqaruar se një vlerë e α-së prej $0.7 \leq \alpha < 0.9$ (Terwee. CB.,Bot.SD.,DeBoer.MR.,Van der Vindt.DA.,Knol. DL., et al., 2007) konsiderohet si tregues shumë i mirë i konsistencës së brendshme të studimit, ku përkojnë edhe vlerat e gjetura të studimit tonë. Nëse e krahasojmë vlerën e studimit tonë me disa studime të ngjashme të realizuara në disa vende të ndryshme, si p.sh.: Greqia, koeficienti α për të gjithë domenet ka vlerën 0.80; Estonia, koeficienti α ka vlerën për të gjitha domenet 0.70; Kroacia, koeficienti α ka vlerën 0.80 për të gjitha domenet; Nigeria, koeficienti α ka vlerën 0.77; Italia, koeficienti α ka vlerën 0.70 për të gjitha domenet etj. Vlera që rezulton në studimin tonë është ndër më të mirat e gjetura edhe në literaturën e botuar. Vlerat e koeficientit alfa të Cronbah mbeten të larta dhe, nëse një nga domenet fshihet, ato rezultojnë

në rangun prej 0.77-0.83 krahasuar me studimin francez, ku vlerat shkojnë nga 0.70-0.95 (Gregory Reychler, Gilles Caty, Anne Vincent, Simon Billo, and Jean-Cyr Yombi) apo studimin brazilian 0.6-08 (Tadeu Lessa da Costa, Denize Kristina de Oliveira,2013). Rezultatet e studimit tregojnë se WHOQOL-HIV-BREF, versioni Shqiptar i këtij instrumenti tregoi vlefshmëri dhe besueshmëri për të matur Cilësinë e Jetës në popullatën jo të shëndetshme dhe në popullatën e shëndetshme.

5.4 CILËSIA E JETËS NË POPULLATËN NË STUDIM

Ky seksion përshkruan cilësinë e jetës së PJHA-së në Shqipëri, duke përdorur instrumentin WHOQOL-HIV. Nga kërkimet mbi literaturën, rezultoi se asnjë studim i këtij lloji nuk është realizuar në Shqipëri.

Cilësia e jetës për mostrën Shqiptare ishte mbi mesatare, me rezultate që variojnë nga më e ulëta prej 11,3 në 15.9 më të lartën, sipas WHOQOL-HIV, në një shkallë vlerësimi nga 4 (cilësia më e ulët e jetës) në 20 (cilësi shumë të mirë të jetës). Asnjë nga pjesëmarrësit nuk raportuan një cilësi shumë të dobët të jetës. Gjetjet e tanishme të studimit janë në përputhje me ato të gjeturat gjatë zhvillimit paraprak të instrumentit të WHOQOL-HIV (WHOQOL-HIV Grup, 2003a). Studimet janë kryer në gjashtë shtete: Australi, Indi (Bangalore dhe Nju Delhi), Brazil, Zimbabve dhe Tajlandë. Një shqyrtim i mjeteve të raportuara të studimit të OBSH-së zbuloi se cilësia e jetës është mbi mesataren për të gjitha fushat me pikë që shkonin 10,7-15,2 në një shkallë prej katër (cilësia e ulët e jetës) për 20 (cilësi shumë të mirë të jetës) (WHOQOL-HIV Group, 2003a). Ekziston nevoja për një studim për të krahasuar cilësinë e jetës së PJHA-së me ata që kanë sëmundje të tjera kronike, si dhe popullatës së shëndetshme për të përcaktuar nëse PJHA kanë cilësi më të ulët të jetës sesa grupet e tjera. Një studim i tillë do të japë interpretimet më të mira për renditjen e cilësisë së jetës për PJHA.

Konstatimet se cilësia e jetës është mbi mesataren në këtë studim aktual është në kontrast me disa studime dhe njësoj për të tjerët. Studimet që raportuan cilësi të mirë të jetës në pacientët me HIV/AIDS, janë studimet e kryera në Tajvan (Yen et al., 2004), Tajlandë (Sakthong et al., 2007) dhe gjithashtu India me një mostër dygjuhësh (Saxena et al., 2005). Nga ana tjetër, ka studime që kanë raportuar cilësi të dobët të jetës në mesin e pacientëve me HIV pozitiv në vende të tilla, si: Suedia (Eriksson et al., 2000), Itali (Starace et al.,2002) dhe në mesin e meshkujve homoseksualë në SHBA (Martin, 1988). Këto studime kanë treguar se sëmundja kronike ndikon në të gjitha dimensionet që lidhen me cilësinë e jetës.

Tre nga katër studimet e sipërcituara e raportonin të dobët cilësinë e jetesës së personave me HIV/AIDS (Bloom & Carliner, 1988; Smith et al., 1997; Martin, 1988) dhe janë kryer në vendet e zhvilluara (mund të jetë një faktor zhvillimi kundrejt vendeve në zhvillim), para se terapia antiretrovirale të bëhej lehtësisht e arritshme. Megjithatë, me futjen e ilaçeve të fuqishme antiretrovirale, HIV/AIDS është bërë një gjendje kronike dhe cilësia e jetës së PJHA-së pritet të jetë më e lartë (UNAIDS/WHO, 2006). Gjetjet e studimeve të realizuara në Estoni (K. Rüüte et al ., 2009**)** dhe Kroaci (S. Belak Kovacevi et al., 2006) përputheshin me QOL-në e subjekteve të studimit tonë, por ato raportuan se PJHA në këto vende kishin një QOL më të ulët krahasuar me vendet e rajonit.

Pikët e përfituara në këtë studim mbi cilësinë e jetës së PJHA në Shqipëri treguan se pjesëmarrësit e perceptonin cilësinë e tyre të jetës midis "as të mirë, as të keqe" dhe "mirë". Ky rezultat nuk është konsistent me përfundimet nga studime të tjera, si p.sh., ai Kroat (S. Belak Kovacevic et al.,2006), në të cilin pjesëmarrësit e perceptonin cilësinë e tyre të jetës nga të "mirë" në "shumë të mirë". Cilësia e jetës së personave që jetojnë me HIV në studimin tonë është më e ulët krahasuar me vende si Kroacia (S.Belak Kovacevi et al.,2006), Greqia (M.Ginieri-Coccossis et al., 2012), Italia (F. Starace et al., 2002) .

5.4.1 Faktori gjini në cilësinë e jetës

Në studimin e tanishëm, gjinia ishte një faktor që nuk ndikonte në cilësinë e jetës. Gjetjet e këtij studimi janë në harmoni me ato të një studimi të kryer mbi 113 pacientë me HIV/AIDS në Kanada, i cili raportoi se, për pjesën më të madhe të gjinisë, nuk ishte e lidhur me cilësinë e jetës (Bourgoyne & Saunders, 2001; Saunders & Bourgoyne, 2002). Një studim i kryer në Indi për pjesëmarrësit dygjuhësor gjeti se, nuk ka pasur dallime gjinore në cilësinë e jetës (Saxena et al., 2005). Studimi kroat raportoi ndryshime të cilësisë së jetës mbi bazë gjinore në PJHA në Kroaci (S. Belak Kovacevic et al.,2006). Gjetjet e këtij studimi nuk janë në përputhje me gjetjet e studimit paraprak të WHOQOL Grup, e cila gjeti se pothuajse në një të tretën e krahasimeve midis femrave dhe meshkujve në analizën e grumbulluar për WHOQOL-100 kishin dukshëm ndryshime në cilësinë e jetës (Saxena, et al., 2005; WHOQOL grup, 1998a). Grupi WHOQOL ka spekuluar se dallimet mund të kenë qenë për shkak të dallimeve aktuale gjinore, apo të aspekteve të ndryshme të cilësisë së jetës që i atribuhoheshin dallimeve gjinore (Saxena, Carlson, Billington, dhe Orley, 2001). Një studim i kryer në Suedi për njerëzit që jetojnë me HIV/AIDS ka gjetur se gratë kishin cilësi jete në mënyrë të konsiderueshme më të ulët të jetës sesa burrat (Eriksson et al., 2000).

Një tjetër gjetje e një studimi të realizuar në Nigeri, raportoi se cilësia e jetës së femrave është më e lartë krahasuar me të burrave, ndërkohë studime të tjera në po këtë vend pohojnë se QOL-ja e femrave është e ulët në domenin psikologjik dhe mjedisin. Rezultatet e vërejtura më sipër për një QOL të lartë në gratë mund të jetë për shkak të vizitave të vazhdueshme dhe bërjen të dukshme të shqetësimeve të femrave në mjedisin e tyre (A.A.Fatiregun et al., 2009**)**. Në vitin 2004, Milimo, et al., i propozuan një raport Bankës Botërore që dallimet gjinore mes Zambavi i atribuhohen mungesës së fuqizimit të grave dhe të qenit të pambrojtur ndaj infektimit me HIV/AIDS.

Disa studime dhe raporte në Zambia (Gausset, 2001; Milimo et al., 2004; United Nations Special Session, 2001: World Bank, 1999; World Bank, 2001a, 2001b, 2003) kanë shpjeguar mënyrën se si gjinia i bën më vulnerabël ndaj infeksionit HIV gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Studimet raportojnë, ndër të tjera, se pabarazitë që lidhen me gjininë janë të lidhura edhe me pabarazitë në fushat sociale, kulturore, ekonomike dhe politike. Në kushtet e ndikimit mbi gratë, studimet pohojnë se përqindja e grave që jetojnë me HIV/AIDS ka qenë në rritje për shumë vite, gratë janë të infektuara shpesh në një moshë më të hershme sesa burrat, dhe se dhuna me bazë gjinore përbën një pjesë të madhe të infeksioneve me HIV te femrat. Gratë në marrëdhënie të qëndrueshme janë shpesh të pambrojtura ndaj infeksionit HIV përmes partnerëve të tyre që përdorin drogë apo kanë shumë partnerë seksual.

Në studimin tonë, femrat janë infektuar nga burrat që ose kanë qenë emigrantë, ose kanë patur marrëdhënie jashtëmartesore me partnere rastësore (vetraportime). Fakti që në të dhënat epidemiologjike kemi më shumë meshkuj të infektuar, për vitin 2013 ishin 30 femra HIV pozitiv, por ky nuk është tregues real i numrit të femrave të infektuara. Shumë studime tregojnë se frika nga dhuna jo vetëm nga partneri, por nga i gjithë komuniteti pengon shumë femra të kenë akses ndaj informacionit mbi HIV, të testohen dhe të kërkojnë trajtim, edhe kur ato besojnë fuqishëm se mund të jenë infektuar (UNAIDS, 2004). Duhet pohuar se në Shqipëri, një femër që është beqare është më e pragjykuar se një mashkull kur rezulton HIV pozititv, si nga familja, ashtu edhe nga komuniteti e shoqëria në përgjithësi (Xhani.B., 2012).

Në Shqipëri, femrat asnjëherë nuk janë përballur me diskriminim, nuk kanë kërkuar kurrë kujdes dhe mbështetje për të trajtuar infeksionin HIV. Gratë dhe vajzat mbajnë barrën e kujdesit për anëtarë të familjes me sëmundje të lidhura me HIV-in.

5.4.2 Faktorët sociodemografik, klinik dhe ndikimi në cilësinë e jetës

Në vlerësimin e cilësisë së jetës së personave që jetojnë me HIV/AIDS, referuar edhe studimeve të ngjashme, u analizuan edhe karakteristikat individuale të pjesëmarrësve si faktor në QOL e PJHA. Është menduar që cilësia e jetës në një grup pacientësh përcaktohet nga mosha, statusi martesor, niveli i edukimit, statusi shëndetësor (E. Malitz et al., 1997), dhe të konsideruarit të vetes të sëmurë ose jo (K.O'connell., S. Skevington., S. Saxena.,2003).

Gjetjet në studimin aktual nuk raportuan ndryshime në cilësinë e jetës midis grup-moshave në studim. Literatura tregon se ka gjetje mikse midis lidhjes së variablit moshë me cilësinë e jetës. Krahasuar me gjetjet e studimit kroat, i cili raporton se ka ndryshime në QOL midis moshave, të rinjtë raportojnë vlera më të larta në domenin psikologjik (S. Belak Kovacevic et al., 2006). Studime të tjera raportojnë një lidhje të fortë mes karakteristikave demografike dhe cilësisë së jetës (Mannheimer. SB., Matts. J., Telzak. E., Chesney. M., Child. C et al., 2005), (Ruiz Perez. I., Rodriguez Baño. J., Lopez Ruz. MA., Del Arco Jimenez. A., Causse Prados. M., Pasquau Liaño. J., et al., 2005), (Swindells. S., Mohr. J., Justis. JC., Berman. S., Squier. C., Wagener. MM et al., 1999).

Disa studime të mëparshme kanë gjetur një numër të kufizuar të dallimeve të rëndësishme në grup-moshën me cilësinë e jetës në mesin e personave me HIV/AIDS (Piette et al.,1995;. Smith, Feldman, Kelly, DeHoovitz, Chirgwin & Minkoff, 1996; Wanchetel, Piette, Mor, Stein, Fleishman & Carpenter, 1992). Ka edhe studime që nuk kanë gjetur ndonjë lidhje midis moshës dhe cilësisë së jetës në personat me HIV/AIDS (Bourgoyne & Saunders, 2001; Ganz, Coscarelli, Kahn, & Peterson, 1993; Murri, Fontoni, Del Borgo, Visona, Barracco, & Zambelli et al., 2003, Swidells, Mohr, Justis et al., 1999).

Statusi martesor është një faktor që ndikon në cilësinë e jetës në PJHA. Gjetjet e studimit aktual janë të ngjashme me studimin kroat (Sanja Belak Kovacevic et al., 2006). Subjektet që janë të martuar ose në marrëdhënie raportuan një nivel më të lartë të QOL-së në domenin e marrëdhënieve shoqërore. Ata që janë në marrëdhënie mund të gëzojnë një mbështetje më të mirë sociale. Për më tepër, numri i individëve të infektuar me HIV, që janë në marrëdhënie afatgjatë me individë HIV të infektuar, nga të cilët ata mund të marrin stabilitet dhe mbështetje shtesë. Ata në një marrëdhënie afatgjatë e kanë më të lehtë të zbulojnë statusin e tyre HIV pozitiv dhe kështu ata ulin nivelin e tyre të ankthit, kur e ndajnë këtë informacion.

Gjetjet në studimin aktual raportuan se ka ndryshime në QOL-në e subjekteve mbi bazën e arsimit. Subjektet me arsim të lartë raportuan QOL-në

më të lartë në të gjashtë domenet. Këto gjetje përputhen pjesërisht me gjetjet e S. Belak Kovacevic et al (2006), që gjeti se subjektet me arsim të lartë raportuan QOL-në më të mirë në domenin e pavarësisë dhe mjedisit. Këto rezultate mbështesin ato të raportuara nga Murriet et al., 2012, që gjeti ndryshime në shëndetin mendor lidhur me nivelin arsimor, dhe me O'Connell et al.,2011, i cili gjeti ndryshime të mëdha midis domenit të mjedisit dhe nivelit arsimor. Një studim i kryer mbi cilësinë e jetës në PJHA në SHBA njoftoi ndryshime në arsim, të ardhura dhe profesion. Pjesëmarrësit me arsim të lartë dhe ata me të ardhura më të larta raportuan cilësi më të mirë të jetës (Cherly, et al., 2006).

Subjektet që kanë raportuar se ata ishin aktualisht të sëmurë, gjithashtu raportuan një QOL më të ulët në të gjitha domenet, një gjetje që përputhet me studimet e mëparshme O'connell et al (2003) dhe S. Belak Kovacevic et al (2006). Ata që janë të sëmurë janë të ngarkuar me simptomat fizike të sëmundjes, e cila nga ana e saj dëmton QOL-në, Bastardo. Y. M et al (2000) , Wachtel.T et al (1992) , Cowdery. J. E et al (2003).

Raportimi i gjendjes shëndetësore në subjektet në studim tregoi se QOL-ja e pacientëve që raportonin përkeqësim të shëndetit të tyre ishte më e ulët se për pacientët që raportonin një status shëndetësor të mirë apo të qëndrueshëm. Ky konstatim është në përputhje me studime të tjera, S. Belak Kovacevic et al (2006), që tregon se ata që gëzojnë shëndet të mirë fizik kanë cilësi jete më të mirë (F. E. Malitz et al., 1997).

Pjesëmarrësit në këtë studim u përkasin dy etnive: asaj Shqiptare dhe Rome. Gjetjet raportojnë një diferencë domethënëse në QOL-në e domeneve sipas etnisë. Ashtu siç dhe pritej, etnia Rome ka një QOL më të ulët në të gjashtë domenet, krahasuar me etninë Shqiptare. Kjo e dhënë lidhet fort dhe me kushtet e vështira social-ekonomike-arsimore, në të cilat jeton komuniteti rom në Shqipëri (UNDPA, 2012). Në studimin e literaturës nuk u gjetën raportime mbi ndryshime në cilësinë e jetës midis etnive të një popullate.

Nga literatura raportohet se punësimi dhe të ardhurat janë një faktor i rëndësishëm që ndikojnë në QOL. Në studimin tonë, statusi i personit si i punësuar ishte një faktor që ndikonte pozitivisht në QOL-në e subjekteve, krahasuar me ata që nuk punonin. Gjetjet tona janë konsistente me disa studime, të cilat tregojnë se punësimi (të ardhurat e larta) është i lidhur me një QOL-ë të mirë midis PJHA-së (Blalock. AC., MacDaniel. JS., Farber. EW., 2002), (Worthington. C., Krentz.HB., 2005), (Kristi Rüütel et al., 2009).

Përveç përfitimeve financiare, punësimi gjithashtu siguron një burim mbështetës për strukturën sociale, identitetit dhe kuptimin e rolit. Përveç kësaj, të ardhurat e qëndrueshme dhe punësimi kanë qenë të lidhura me adherencën

në trajtimin me terapinë antiretrovirale (Carballo. E., Cadarso-Suarez. C., Carrera.I., Fraga.J.,De la Fuente. J., Ocampo. A., Ojea. R., Prieto. A., 2004).

Punësimi gjithashtu mund të ofrojë burime, të cilat tampojnë efektet e stresit të infektimit me virusin HIV, dhe në këtë mënyrë shërben për të ruajtur një ndjenjë të lartë të cilësisë së jetës (Sowell. RL., Seals. BF., Moneyham. L., Demi. A., Cohen.L.,Brake.S.,1997).

5.4.3 Rezultatet e domeneve në studim

Në studimin tonë, korrelacionet midis 6 domeneve janë të forta dhe kanë një vlerë domethënëse, $p < 0.001$. Gjetjet janë të ngjashme me raportimet e studimit grek, ku korrelacionet midis domeneve ishin të forta në total midis domenit fizik, psikologjik dhe social, ndërsa në studimin tonë gjetjet raportuan një lidhje të fortë edhe midis domenit të nivelit të autonomisë dhe mjedisit.

Domeni fizik dhe ai shpirtëror kanë vlerën më të lartë në studim, një gjetje e ngjashme me rezultate e studimit grek (M. Ginieri-Coccossis et al., 2012), nigerian (A. A. Fatiregun et al., 2009), brazilian (Tadeu Lessa da Costa et al., 2013).

Përafërsisht dy të tretat (63.7%) e pjesëmarrësve kishin domenin e BPSHF-së vlerën më të lartë në studim. Shqipëria është një vend laik sipas Kushtetutës Shqiptare, por me katër besime fetare zyrtare. Duke analizuar pyetjet që i përkasin këtij domeni dhe pyetjet cilësore që u janë bërë pjesëmarrësve, është e pritshme të kemi këtë rezultat. Subjektet janë të mendimit se çdo gjë e ka Zoti në dorë, dhe se nuk e kanë ndarë informacionin mbi diagnozën e sëmundjes jashtë familjes nukleare mbi 97.9% e tyre. Këto gjetje janë në përputhje me gjetjet e një studimi që është kryer në Gjeorgji, SHBA, që raportuan se cilësia e jetës në mesin e pacientëve me HIV/AIDS ishte e lidhur në mënyrë të konsiderueshme me spiritualitetin (Pennington, 2006).

Gjetjet në studimin Nigerian janë të ngjashme me studimin tonë. Në përgjithësi, veçanërisht në një vend si Nigeria, njerëzit priren të jenë shpirtëror dhe fetar vetëm kur ballafaqohen me çështje që shkojnë përtej tyre (A. A. Fatiregun et al., 2009). Kjo gjithashtu mund të jetë një intuit për të besuar se domeni BPSHF dhe cilësia e jetës janë të lidhura për shkak të rëndësisë shpirtëror, për të qenë mirë në përballimin me sëmundjen kronike.

Megjithatë, në studimin francez (Gregory Reychler et al., 2013) domeni shpirtëror ka një besueshmëri të ulët dhe sipas tyre është treguar dhe më parë që domeni shpirtëror nuk është aq i rëndësishëm, për PJHA-në, krahasuar me komponentët e tjerë të cilësisë së jetës, edhe kjo gjetje është e ngjashme

me studime të tjera, si portugeze (Canavarro.MC et al., 2011), italiane (Starace. F et al., 2002), braziliane (Zimpel.RR et al.,2007).

Në studimin aktual, domeni i mjedisit ka vlerën më të ulët krahasuar me gjithë domenet e tjerë. Kjo është e ngjashme me studime të tjera, si në studimin brazilian (Tadeu Lessa da Costa, Denize Cristina de Oliveira, 2013), grek (M. Ginieri-Coccossisl,E.Triantafillou,V.Tomaras,C.Soldatos,Mavreas,G. Christodoulou, 2012), nigerian (A. A. Fatiregun, K. C. Mofolorunsho, K. G. Osagbemi, 2009), domeni mjedisit paraqet vlerën më të ulët. Sipas tyre, domeni mjedisit tregon më së mirë fuqinë diskriminuese të subjekteve, e lidhur kjo me mjediset e ndryshme, ku banojnë, me ndryshimet në mirëqenien e mejdisit tjetër, d.m.th. me zonat e ndotura (Grupi WHOQOL,1998).

Kjo pikëpamje është mbështetur nga studimi i versionit të Bangladeshit (Dündar. P., Fidaner. H., Oral. A, Eser. S., Atman. UC., Pala. T., 2002), i cili tregoi se domeni mjedisit, i vlerësuar midis djemve adoleshent, ka raportuar diskriminim të mjaftueshëm midis djemve që jetonin në rezidenca dhe lagje të varfëra. Edhe studimi i realizuar në Nigeri (A. A. Fatiregun, K. C. Mofolorunsho, K. G. Osagbemi, 2009) e lidh cilësinë e ulët në domenin e mjedisit me kushtet e varfëra të jetesës, mjedisit. Studime të tjera treguan një lidhje të nivelit arsimor me domenin e mjedisit, që ishin të ngjashme me studimin aktual. Subjekte me arsim të lartë dhe që ishin në marrëdhënie pune treguan një QOL më të lartë në domenin e mjedisit në studimin tonë. Këto gjetje mbështeten edhe nga O'Conell et al 2012 , S.Belak.Kovacevi et al., 2006 dhe Murri et al., 2011.

Gjetjet në studimin tonë raportuan një vlerë të ulët të domenit psikologjik, krahasuar me studime të ngjashme. Subjektet me arsim të lartë raportuan një QOL më të mirë, e mbështetur kjo gjetje nga studimi kroat i S.Belak.Kovacevic et al., 2006. Pyetjet cilësore që u përdorën me subjektet në studim dhanë një panoramë më të qartë rreth këtij domeni. Sëmundja HIV/AIDS rëndonte shumë psikologjikisht këtë grup subjektesh, e lidhur kjo me frikën nga stigma dhe paragjykimi, nëse do ta ndanin këtë "hall" me të tjerët ose do të zbulohej statusi HIV pozitiv në rrugë të tjera. Ata raportojnë se gjithë kohën ndihen në ankth se mos u shpëton ndonjë detaj që mund të rrezikojë zbulimin e statusit të tyre HIV pozitiv. Studimet tregojnë se personat e infektuar me HIV janë më shumë të rrezikuar se popullata e përgjithshme për të zhvilluar depresion (National Institute of Mental Health, USA, 2011) .

Shoqëria Shqiptare është shumë paragjykuese ndaj kësaj sëmundje (BIO-SS, ISOP, 2008, konstatime nga pacientët e QSUT-së). Megjithatë, sipas K.K.B., (2013, USA), personat që jetojnë me HIV janë specifikisht në risk për shfaqjen e simptomave të lidhura me çrregullimet psikiatrike. Dr.Bea thotë se "Për njerëzit

me HIV, të kontrolluarit e ndikimit të sëmundjes në aspektet psikologjike, sociale dhe fizike të jetës së tyre të përditshme do të thotë që cilësia e jetës të përmirësohet."

Por, duke krahasuar femrat me meshkujt në këtë studim, gjetjet janë të ngjashme me disa studime të tjera, si në Brazil (Elisabete. C., Morandi. Dos Santos., Ivan.FJ.,Fernanda.L.,2007), Usa (McDowell.I.,Newell.C.,1996) që raportuan se femrat kanë QOL më të ulët se meshkujt në domenin psikologjik. Por vlerat e ulëta të domenit psikologjik përputhen edhe me një studim të realizuar në vitin 2009 (Shane D. Morrison et al., 2011) në Shqipëri, i cili raporton se 62.3% e personave HIV pozitiv raportojnë histori ankthi dhe depresioni. "Në njerëzit me HIV, ashtu si në ata në kushte shëndetësore të tjera, depresioni ka tendencë të jetë i padiagnostikuar dhe i patrajtuar", thotë Goodkin.

Në disa studime, domeni i marrëdhënive sociale ka vlerë të lartë si në studimin grek (M.Ginieri-Coccossis et al., 2012) francez (G.Reychler et al., 2013), këto gjetje bien në kundërshtim me studimin tonë, ku vlera e domenit social është midis vlerave më të ulëta midis domeneve. Edhe nga intervista cilësore, ata shprehen se kanë frikë nga stigma dhe qëndrimet e të tjerëve ndaj tyre, prandaj nuk e bëjnë të njohur statusin e tyre HIV pozitiv, në këtë mënyrë ata do të ruajnë imazhin e paprekur në shoqëri. Sipas një studimi të realizuar në New York, stigma lidhet ngushtë me dy elementë: ndjenjën e fajësimit dhe turpin (Rivera. AV, DeCuir. J., Crawford ND., Amesty. S., Harripersaud. K., Lewis.CF., 2015).

Stigma e lidhur AIDS është manifestuar në mënyra të ndryshme, njerëz të infektuar me HIV vazhdojnë të refuzohen nga miqtë dhe të afërmit, shkarkohen nga puna ose detyrohen të japin dorëheqjen nga punët e tyre dhe i nënshtrohen sulmit të dhunshëm (Herrek, 1990). Edhe pse çdo shoqëri ka kritere specifike që përcaktojnë shkallën nga e cila njerëzit me HIV/AIDS janë pranuar dhe përqafuar kundrejt refuzimit dhe shmangies. Stigma e lidhur me HIV/AIDS duhet të jetë pothuajse universale (Tanzima Zohra Habib, Md.Siddiqur Rahman, 2010).

Duhet theksuar se nuk ka ndryshime midis meshkujve dhe femrave. Gjetjet e studimit tonë janë të ngjashme me ato të raportuara në disa studime të tjera, si studimi nigerian (A. A. Fatiregun et al.,2009), brazilian (Tadeu Lessa da Costa et al.,2013), kroat (S. Belak Kovacevic et al.,2006), i cili raportoi se domeni social kishte vlerë më të ulët krahasuar me patologjitë e tjera kronike që nuk stigmatizohen. Por në bazë të statusit civil, subjektet e martuar raportuan një QOL jete më të mirë në domenin social, e mbështetur edhe nga S.Belak.Kovacevic et al., 2006.

Këto rezultate të ulëta në QOL-në e domenit të marrëdhënive sociale mund të reflektojnë diskriminimin dhe stigmatizimin me të cilin janë përballur pjesëmarrësit. Gjithashtu, çështjet, si: marrëdhëniet personale, aktiviteti seksual, dhe mbështetja sociale ndaj PJHA-së mund të ketë një efekt negativ në domenin e marrëdhënieve sociale.

Duke krahasuar gjetjet e studimit aktual me studimin kroat (S. Belak Kovacevic et al., 2006), brazilian (Tadeu Lessa da Costa, Denize Cristina de Oliveira, 2013) për sa i përket domenit të nivelit të autonomisë, QOL-ja e subjekteve është relativisht e ulët në totalin e subjekteve. Ndërsa në subjektet me arsim të lartë dhe ato që ishin në marrëdhënie pune raportonin QOL më të mirë në domenin e autonomisë.

5.4.4 Përshkrimi përgjigjeve të lidhura me WHOQOL-BREF me predominim pozititv

Shumica e subjekteve e konsideruan cilësinë e tyre të jetës si "as të mirë, as të keqe", ose të mirë, dhe ata treguan se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me shëndetin e tyre. Sa për domenin fizik, vihet re se përfaqësohet vetëm me dy përgjigje me pozicion pozitiv midis domeneve të tjerë. Kështu, subjektet kanë shprehur një vlerësim pozitiv për shkak të mungesës së dhimbjeve ose mungesës së simptomave klinike. Shumica e të anketuarve gjithashtu konsiderojnë praninë e energjisë si të mjaftueshme për jetën e përditshme me një vlerë relativisht të lartë (tabela 35.4).

Për domenin psikologjik, shumica e subjekteve raportuan një ndjenjë të mirë për veten e tyre dhe të shijuarit e jetës, duke u përgjigjur me "as shumë, as pak" dhe deri në "shumë". Shumica e tyre raportuan se pranojnë pamjen e tyre fizike dhe kanë përqendrim të mirë në jetën e përditshme.

Në nivelin e domenit të pavarësisë, shumica e tyre kishte një pozicionim më pozitiv. Në këtë mënyrë, kemi marrë perceptim mbizotërues pozitiv në lidhje me lëvizshmërinë, aftësinë për të përmbushur aktivitetet e përditshme jetësore dhe kapaciteteve për të punuar (tabela 35).

Lidhur me aspektet e domenit të marrëdhënieve sociale, pozicionimi i shumicës së pjesëmarrësve gjithashtu tregoi një qasje pozitive. Kjo për shkak se ka pasur një dominim të atyre që e konsideronin veten si të kënaqur me marrëdhëniet shoqërore në tërësi dhe një vlerë relativisht pak mbi mesataren në aktivitetin seksual.

Domeni i mjedisit është pozicionuar pozitivisht nga ana e subjekteve, sepse ata e konsiderojnë në mënyrë pozitive aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, kushteve të banimit, sigurinë e jetës dhe në vlera zbritëse disponueshmërinë e informatave të nevojshme në jetën e përditshme dhe transportin.

Për domenin e besimeve personale, shpirtërore, fetare ne kemi vërejtur se 74,4% e kanë perceptuar me kuptim jetën e tij/saj.

5.4.5 Përshkrimi përgjigjeve të lidhura me WHOQOL-BREF me predominim negativ

Për domenin fizik është vërejtur se vlerësimi i subjeketeve është mbi mesatare ose më shumë negative në lidhje me sikletet për shkak të ndonjë problemi të pakëndshëm fizik që rezulton nga HIV dhe pakënaqësisë me gjumin (tabela 36).

Lidhur me domenin e pavarësisë, pozicionimi më negativ i referohet nevojës për trajtim mjekësor në jetën e përditshme me 84.43% të pjesëmarrësve.

Sa për domenin e mjedisit, është vërejtur se përgjigjet me vlerë negative mbi mesataren kanë të bëjnë me perceptimin mbi paratë dhe aksesin ndaj informacionit.

Në lidhje me domenin e besimeve personale, shpirtërore dhe fenë, tri nga pyetjet treguan vlera të larta për qëndrimin negativ: siklet për shkak të fajësimit nga ana e njerëzve të tjerë për statusin HIV pozitiv (78.39%); frika nga e ardhmja dhe vdekja (72.36%/74.87%). Kjo tregon nëngrupe me perceptime jo-konsensuale në fenomene të tilla.

Këto gjetje, krahasuar me studimin brazilian (Tadeu Lessa da Costa,, Denize Cristina de Oliveira, 2013) janë të ngjashme me pyetjet në predominimin pozitiv, por gjetjet e studimit tonë në pyetjet me predominim negativ nuk përputhem me studimin brazilian, sepse domeni pskologjik, autonomisë, marrëdhënieve sociale nuk përfaqësohet me pyetje negative në popullatën e PJHA-së.

5.4.6 Cilësia e jetës në popullatën e përgjishme në Evropë

Gjatë gjithë këtij studimi është pëmendur shpesh se cilësia e jetës është një koncept multidimensional. Për të analizuar cilësinë e jetës së një individi apo shoqërie duhet të fokusohemi në shumë komponentë që ndikojnë në jetën e një personi në të gjitha dimensionet e tij. Studimi mbi Cilësin e Jetës Evropiane (EQOL) është themeluar si një mjet për dokumentimin dhe analizimin e cilësisë së jetës në BE, për herë të parë është realizuar në vitin 2003, 2008 dhe i fundit në 2011-ën.

Ky studim hulumton çështjet përkatëse në jetën e qytetarëve evropianë, të tilla si: punësimi, të ardhurat, arsimi, strehimi, familja, shëndeti, balanca punë-jetë, kënaqësia e jetës dhe perceptimi mbi cilësinë e shoqërisë. Analiza e shikon marrëdhënien midis faktorëve subjektiv dhe objektiv, qëndrimeve të raportuara dhe preferencave nga njëra anë, burimet dhe kushtet e jetesës nga ana tjetër. Në

tabelën më poshtë pasqyrohen më qartë komponentët që përbëjnë cilësinë e jetës sipas studimit evropian dhe WHOQOL-BREF në studimet reciproke.

Arsyeja e ballafaqimit të këtyre dy studimeve është për të kuptuar se në cilësinë e jetës së një individi nuk është vetëm sëmundja që ndikon, por edhe kushtet e vështira social-ekonomike-politike të shtetit ku jetojmë. Vlerat e larta apo të ulëta të cilësisë së jetës së popullatave që merren në studim ndikohen edhe nga këta faktorë, pavarësisht instrumentit që përdoret. Kjo vihet re edhe nga krahasimi i gjetjeve të studimit aktual me studime të ngjashme të realizuara në Francë, Itali, Kroaci dhe Greqi.

Kushtet objektive dhe subjektive të mirëqenies së jetesë janë dimensionet kyçe të cilësisë së jetës së individëve. Megjithatë, mirëqenia e individit është prekur gjithashtu nga konteksti social në të cilin ai jeton. Vendet ku qytetarët kanë pak besim në cilësinë e institucioneve politike, apo i perceptojnë shoqëritë ku ata jetojnë si konfliktuale, si dhe mungesa e një elementi të rëndësishëm të mirëqenies që ushqejnë pasiguri dhe nxitin shqetësime për qëndrueshmërinë e nivelit ekzistues të mirëqenies personale (FEQOL, 2003).

Shqipëria nuk është vend anëtar me të drejta të plota në BE dhe nuk ka qenë pjesë e këtij studimi, por nga gjetjet e këtij studimi del se vendet me një GDP më të lartë dhe ekonomi më të qëndrueshme kanë një cilësi jete më të mirë krahasuar me vendet e BE-së, që kanë një GDP të ulët dhe destabiltitet ekonomik në të gjithë komponentët e vlerësuar sipas EQOL-së (EQOL, 2012).

Referuar një studimi për të parë trendin e varfërisë në Shqipëri midis viteve 2002-2005-2008-2012 (ushqim, për konsum, joushqimor, për nevoja bazë për arsim, për pajisje afatgjatë) (INSTAT, World Bank, 2013), dalim në dy konkluzione kryesore:

Së pari, për shkak të krizës globale financiare dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike, ka pasur një rritje të përgjithshme të varfërisë.

Së dyti, varfëria nuk është më vetëm një çështje rurale. Ka patur një zhvendosje të varfërisë nga zonat rurale në zonat urbane, ku kjo e fundit ka patur një rritje të madhe të shkallës së varfërisë. Kjo mund të ketë ardhur si pasojë e përpjekjeve më të përqendruara drejt zhvillimit rural, ndërkohë që lëvizjet e popullsisë mund të kenë vazhduar nga zonat rurale në zonat urbane dhe pasojat e krizës kanë ndikuar kryesisht në zonat urbane. Ky studim e bën më të qartë se pse PJHA-ja në Shqipëri ka një cilësi jete më të ulët se PJHA-ja në vendet e BE-së.

Figura 4.5 Indikatorët e cilësisë së jetës sipas EQOL/WHOQOL-HIV-BREF.



5.5 DOMETHËNIA E STUDIMIT

Studimi i tanishëm, së pari, kërkoi të vlerësonte cilësinë e jetës së PJHA-së në Shqipëri; për të parë në kishte ndryshime në cilësinë e jetës midis femrave dhe meshkujve që janë me HIV në Shqipëri; efektet që mund të kishte terapia me antiretrovirale në cilësinë e jetës; së fundi, për të parë ndikimin e sëmundjes HIV/AIDS në QOL.

Studimi ishte i veçantë dhe i rëndësishëm për ofruesit e kujdesit shëndetësor, kërkuesit e interesuar në fushën e cilësisë së jetës e lidhur me problemet klinike, qasjen konceptuale dhe metodologjinë e përdorur.

Së pari, studimi i tanishëm është unik në atë që është bërë për të përcaktuar cilësinë e jetës në mes të një mostre shqiptare të njerëzve që jetojnë me HIV/AIDS, duke përdorur instrumentin e WHOQOL-HIV-BREF. Një kërkim i gjerë i literaturës tregon se nuk ka raporte të publikuara të përdorimit të instrumentit të WHOQOL-HIV në Shqipëri. Studimet kryesisht në Shqipëri janë përqendruar mbi sjelljen seksuale, testimin vullnetar, këshillimin dhe transmetimin nga nëna tek fëmija dhe mbi të drejtat e PJHA-së. Ky studim na ka dhënë një informacion të rëndësishëm mbi cilësinë e përgjithshme të perceptimit të jetës dhe të shëndetit në një mostër shqiptare. Kjo e dhënë mund të përdoret në mënyrë efikase dhe rregullisht gjatë praktikës klinike rutinë, sepse ajo ka një lidhje të fortë me cilësinë e jetës.

Prandaj, ky studim është unik në atë që i përgjigjet objektivit të tretë për të reduktuar vdekshmërinë nga HIV dhe sëmundshmërinë, e cila kërkon të

krijojë kujdes dhe mbështetje për PJHA-në, për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre (WHO dhe UNAIDS, 2002) nga: (a) duke përdorur WHOQOL- instrument HIV, (b) duke zbuluar këtë metodë që mund të përdoret për të kuptuar më mirë cilësinë e jetës, dhe (c) identifikimin se çfarë cilësie jete ka kampioni shqiptar.

